



REPUBLIKA E KOSOVËS
MINISTRIA E ADMINISTRIMIT
TË PUSHTETIT LOKAL



NDIKIMET SOCIO-EKONOMIKE TË COVID-19 NË KOMUNAT E KOSOVËS

Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal në partneritet
me Programin për Zhvillim Gjithëpërfshirës
Implementuar nga **UN-Habitat Kosovë**

dhe financuar nga:





REPUBLIKA E KOSOVËS
MINISTRIA E ADMINISTRIMIT
TË PUSHTETIT LOKAL

NDIKIMET SOCIO-EKONOMIKE TË COVID-19 NË KOMUNAT E KOSOVËS

2022

MOHIM I PËRGJEGJËSISË

Emërtimet e përdorura dhe paraqitja e materialit në këtë botim nuk nënkuptojnë shprehjen e asnjë opinioni nga ana e Sekretariatit të Kombeve të Bashkuara në lidhje me statusin ligjor të ndonjë vendi, territori, qyteti ose zone apo të autoriteteve të tij, ose në lidhje me caktimin e kufijve të tij. Pikëpamjet e shprehura në këtë botim nuk pasqyrojnë domosdoshmërisht pikëpamjet e Programit Vendbanimet Njerëzore të Kombeve të Bashkuara, të Kombeve të Bashkuara ose të Shteteve Anëtare të saj. Fragmentet mund të riprodhohen pa autorizim, me kusht që të ceket burimi.

Të gjitha të drejtat e rezervuara ©2022 Programi i Kombeve të Bashkuara Vendbanimet Njerëzore (UN-Habitat), Ndërtesa e Ministrive- Rilindja, Kati 10, 10000 Prishtinë, Kosovë www.unhabitat.org, www.unhabitat-kosovo.org

Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal, Ndërtesa e Ministrive-Rilindja, Kati 13, 10000 Prishtinë, Kosovë <https://mapl.rks-gov.net/>

FALËNDERIME

Autor i raportit: Atdhe Hetemi, PhD (UN-Habitat Kosovë); **Menaxhere e projektit:** Zana Sokoli (UN-Habitat Kosovë); **Koordinatorë Udhëheqës:** Saranda Stublla (Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal); **Kontribuues:** Besnike Kocani (UN-Habitat Kosovë), Artan Rexhepi, (UN-Habitat Kosovë), Blerina Boshnjaku (UN-Habitat Kosovë), Edina Ibishi (Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal), Fjollë Caka (UN-Habitat Kosovë), Ganimete Salihu (Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal), Erëza Bokshi (UN-Habitat Kosovë), Mirëdita Kosova (UN-Habitat Kosovë), Adem Llabjani (UN-Habitat Kosovë).

Koordinatorët komunalë të anketimit/hulumtimit: Mevlyde Peci Shala (komuna e Mitrovicës Jugore), Sebahate Sadiku (komuna e Ferizajit), Fari Shkreta (komuna e Hanit te Elezit), Afrim Prokshi (komuna e Drenasit), Shemsi Azemi (komuna e Lipjanit), Nuriye Fazliu (komuna e Fushë Kosovës), Aleksandar Nedeljkovic (komuna e Ranillugut), Aleksandar Jovic (komuna e Gracanics), Zlata Savic (komuna e Parteshit), Muhidin Emiri (komuna e Dragashit), Agim Vuthi (komuna e Pejës), Valdete Berisha (komuna e Kamenicës), Qemajl Selmani (komuna e Gjilanit), Igor Savic (komuna e Shterpces), Ejup Babatinca (komuna e Podujevës), Rrustem Pepshi (komuna e Junikut), Islam Latifi (komuna e Vushtrrisë), Berat Mehmeti (komuna e Obiliqit), Dragisa Kojic (komuna e Kllkotit), Driton Raci (komuna e Klinës), Arsim Morina (komuna e Malishevës), Mirsad Gashi (komuna e Skenderajit), Ymer Brisha (komuna e Prizrenit), Besnik Shala (komuna e Shtimes), Biondina Ramaj (komuna e Rahovecit), Habib Qorri (komuna e Prishtinës), Faton Bytyqi (komuna e Istogut), Arbër Gola (komuna e Gjakovës), Enver Cacaj (komuna e Decanit), Vedat Dema (komuna e Kacanikut), Mustaf Mehmeti (komuna e Vitisë), Englin Tac (komuna e Mamushës), Arbenita Llapashtica (komuna e Novobërdës), Fatos Kuqi (komuna e Suharekës), Mursel Ahmeti (komuna e Mitrovicës Veriore), Dragana Milutinovic (komuna e Leposavicit), Sonja Bozovic (komuna e Zubin Potokut), Jelena Sofronijevic (komuna e Zveçanit).

Pjesëmarrësit dhe kontribuesit e punëtorive regionale: Dejan Nikolic ("LioSTEP"), Steffen Felbrich (UNMIK), Arben Qirezi (UNDP), Fatmire Thaci (MZHR), Hysen Beqa (ME), Dragisa Kojic (komuna e Kllkotit), Besnik Shala (komuna e Shtimes), Anita Sutaj (MINT/DT), Habib Qorri (komuna e Prishtinës), Nuriye Fazliu (komuna e Fushë Kosovës), Berat Mehmeti (komuna e Obiliqit), Ejup Babatinca (komuna e Podujevës), Kujtim Gjevori ("SCAMPA"), Sami Vllasaliu (komuna e Novobërdës), Margareta Matic (UNMIK-OCS), Linda Shahini (komuna e Lipjanit), Arian Vrainca (Shoqata e Gastronomëve të Kosovës), Lumnije Ajdini ("Aleanca Kosovare e Bizneseve"), Shehrije Mustafa (komuna e Drenasit), Gazmend Ademi (MINT), Bejtush Kicmari (BQK), Lino Sciarra (UNMIK), Sakibe Jashari (CoE), Biondina Ramaj (komuna e Rahovecit), Vjollca Selimi (MAPL), Agim Bylygbashi (komuna e Suharekës), Lulzim Aliu (komuna e Ferizajit), Arsim Morina (komuna e Malishevës), Mimoza Karamata (MAPL), Ymer Brisha (komuna e Prizrenit), Muhamet Malsiu (MMPHI), Qazim Mehmeti (komuna e Gjakovës), Lon Ibishi (komuna e Gjakovës), Faton Bytyci (komuna e Istogut), Enver Cacaj (komuna e Decanit), Engin Tac (komuna e Mamushës), Samire Krasniqi (komuna e Kamenicës), Burbuqe Leka (komuna e Kamenicës), Bahrie Sadiku ("Oda e Afarizmit të Kosovës"), Januz Hajzeraj (komuna e Pejës), Gëzim Paci (MFPT), Pashk Buzhala (MSH), Shehide Hoxha (komuna e Gjilanit), Florina Ujupi (OJQ "Nisja, Zhvillohu"), Fatos Shala (komuna e Junikut), Fatbardha Haxhiu (OJQ "Mundesia"), Preston Pentony (UNMIK), Islam Latifi (komuna e Vushtrrisë), Zenel Citaku (komuna e Mitrovicës Jugore), Mevlyde Peci Shala (komuna e Mitrovicës Jugore). Ky aktivitet u përkrah financiarisht edhe nga UNMIK-u. Dëshirojmë të falënderojmë edhe përfaqësuesit e komunave si dhe bizneset private për plotësimin e pyetësorit, pjesëmarrjen në grupe punuese dhe për mbështetjen gjatë vlerësimit. Për më tepër, falënderime të veçanta i dedikohen përfaqësuesve të tjerë të Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal si dhe kolegëve të UN-Habitat-it të përfshirë në zbatimin e këtij projekti, për mbështetjen dhe kontributin e tyre të vazhdueshëm në këtë hulumtim.

AKRONIMET DHE SHKURTESAT

AKK	Asociacioni i Komunave të Kosovës
BE	Bashkimi Evropian
EULEX-i	Misioni i Bashkimit Evropian për Sundimin e Ligjit në Kosovë
BPV	Bruto Produkti Vendor
IKSHP	Instituti Kombëtar i Shëndetësisë Publike
ARBK	Agjencia e Regjistrimit të Bizneseve të Kosovës
IKQL	Instituti Kosovar për Qeverisje Lokale
MH	Ministria e Shëndetësisë
MAPL	Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal
ARU	Axhenda e Re Urbane
OZHQ	Objektivat e Zhvillimit të Qëndrueshëm
OKB	Organizata e Kombeve të Bashkuara
UNCDF	Fondi i Kombeve të Bashkuara për Zhvillim të Kapitalit
UN-Habitat	Programi i Kombeve të Bashkuara për Vendbanimet Njerëzore
UNKT	Ekipi i Kombeve të Bashkuara në Kosovë

PËRMBAJTJA

FALËNDERIME	3					
AKRONIMET DHE SHKURTESAT	4					
1. PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE	7					
2. METODOLOGJIA	13					
3. HYRJE	15					
4. GJETJET KYÇE NGA KOMUNA	19					
						
 Komuna e Deçanit 23	 Komuna e Dragashit 26	 Komuna e Drenasit 29	 Komuna e Ferizajit 32	 Komuna e Fushë Kosovës 35	 Komuna e Gjakovës 38	 Komuna e Gjilanit 41
 Komuna e Graçanicës 44	 Komuna e Hanit të Elezit 47	 Komuna e Istogut 52	 Komuna e Junikut 55	 Komuna e Kaçanikut 58	 Komuna e Kamenicës 61	 Komuna e Klinës 64
 Komuna e Kllokotit 67	 Komuna e Leposaviqit 70	 Komuna e Lipjanit 73	 Komuna e Malishevës 76	 Komuna e Mamushës 79	 Komuna e Mitrovicës së J. 84	 Komuna e Mitrovicës së V. 87
 Komuna e Novobërdës 90	 Komuna e Obiliqit 93	 Komuna e Parteshit 96	 Komuna e Pejës 99	 Komuna e Podujevës 102	 Komuna e Prishtinës 105	 Komuna e Prizrenit 108
 Komuna e Rahovecit 111	 Komuna e Ranillugut 116	 Komuna e Shtërpçës 119	 Komuna e Shtimes 122	 Komuna e Skenderajt 125	 Komuna e Suharekës 128	 Komuna e Vitisë 131
		 Komuna e Vushtrrisë 134	 Komuna e Zubin Potokut 137	 Komuna e Zveçanit 140		
5. KONKLuzionET DHE REKOMANDIMET	145					
6. BIBLIOGRAFIA	149					

1

PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE

Ky raport është rezultat i bashkëpunimit mes Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal (MAPL) dhe UN-Habitat në Kosovë¹. Pandemia COVID-19, e shpallur si e tillë më 11 mars 2020, është një fenomen shëndetësor i paprecedentë që prek shumë aspekte të jetës personale dhe shoqërore në nivel global, veçanërisht shëndetin e njeriut dhe ekonominë. Numri i përgjithshëm i vdekjeve të shkaktuara nga virusi është mbi 6.2 milionë, ndërsa më shumë se gjysmë miliardë njerëz janë konfirmuar të infektuar nga virusi². Kjo ka rezultuar në emergjencë shëndetësore dhe kriza ekonomike që kanë shkaktuar ndërprerje të prodhimit dhe tregtisë, duke ndikuar kështu në mënyrë negative në zhvillimin socio-ekonomik në nivel global. Edhe Kosova nuk ka shpëtuar pa u prekur nga kjo situatë pandemike. Rastet e para të infektimit me COVID-19 në Kosovë u raportuan më 13 mars 2020. Menjëherë pas kësaj, pandemia u përhap me shpejtësi dhe, për shkak të masave të qeverisë për tu përballuar me krizën, u ndërpreve veprimet normale të përditshme të personave dhe komuniteteve qoftë ato private ashtu edhe ato publike, duke përfshirë, ndër të tjera, punën, shkollën dhe veprimtaritë ekonomike.

Disa raporte të prodhuara nga organizatat ndërkombëtare, grupet e ekspertëve, OJQ-të vendore, si dhe aktorët rajonalë dhe ndërkombëtarë që veprojnë në Kosovë, analizuan ndikimin e përgjithshëm të pandemisë COVID-19 në Kosovë. Megjithatë, Literatura ekzistuese tregon se pjesa më e madhe e hulumtimeve të kryera deri më tani për ndikimin e COVID-19, është fokusuar kryesisht në pasojat ekonomike dhe afariste, ndikimet socio-ekonomike në ekonomi familjare dhe shumë pak në shërbime komunale. Nga 20 raportet e analizuar të hartuara për situatën e pandemisë COVID-19 në Kosovë³, 14 prej tyre janë kryer në vitin 2020 ndërsa 6 të tjera në vitin 2021. Ndërsa disa prej tyre analizuan situatën (-t) e muajit (-ve) kur u kryen aktivitetet kërkimore (për shembull në mars të vitit 2020), të tjerat mbuluan periudha më të gjata për të parë ndikimin e pandemisë në fusha dhe sektorë të caktuar. Për shembull, hulumtimi i ndërmarrë nga Ekipi i Kombeve të Bashkuara në Kosovë (UNKT) u krye në tre raunde vlerësimi që mundësoi identifikimin e trendeve potenciale gjatë vitit të parë të pandemisë. Gjithashtu, ekziston edhe një raport tjetër i UN-Habitat lidhur me ndikimin e COVID-19 në punën e Drejtorive të Urbanizimit, veçanërisht në fushën e planifikimit, ndërtimit, legalizimit, banimit etj.⁴

1 Të gjitha referimet për Kosovën në këtë dokument duhet të kuptohen se janë në kontekstin e rezolutës 1244 (1999) të Këshillit të Sigurimit.

2 Paneli i OBSH Coronavirus (COVID-19). Në dispozicion në: <https://covid19.who.int/> (qasja e fundit më 21/04/2022).

3 Lista e literaturës së konsultuar do t'i bashkëngjitet draftit përfundimtar të raportit si shtojcë

4 Shihni PASOJAT E COVID-19 NË SEKTORIN E PLANIFIKIMIT HAPËSINOR/URBAN, NDËRTIMIT, LEGALIZIMIT DHE BANIMIT, të qasshme në: https://unhabitat-kosovo.org/wp-content/uploads/2021/10/The-Consequences-of-COVID-19...7057_compressed_compressed.pdf (qasja e fundit më 09/09/2022)



Figura 1. Fushat që janë mbuluar më së shumti nga hulumtimet e kryera në Kosovë rreth COVID-19. Burimi, UN-Habitat Kosova

Rrjedhimisht, raportet ekzistuese të prodhuara nga organizatat ndërkombëtare, grupet e ekspertëve situata(-t) e muajit(-ve), OJQ-të vendore, si dhe organet rajonale dhe ndërkombëtare që veprojnë në Kosovë, mundësojnë një analizë të ndikimit të pandemisë COVID-19 në Kosovë. Ndërsa në vijim është dhënë një pasqyrë e përqendruar veçanërisht në gjetjet që trajtojnë drejtpërdrejt situatën socio-ekonomike dhe çështjet e ndërlidhura me to. Përhapja e pandemisë COVID-19 dhe masat pasuese të qeverisë, si kufizimi i lëvizjes dhe i veprimtarive ekonomike, vendosja e distancës sociale, si dhe masat qeveritare fiskale dhe të rimëkëmbjes për ta trajtuar krizën e shkaktuar, kanë ndikuar në aspekte të ndryshme socio-ekonomike, në sundimin e ligjit dhe në jetën arsimore në Kosovë.

Në muajin gusht të vitit 2020, Kuvendi i Kosovës miratoi “Ligjin për Parandalimin dhe Luftimin e Pandemisë COVID-19 në Territorin e Republikës së Kosovës”, i cili përcakton masat parandaluese kundër COVID-19. Në raportin mbi ndikimin e COVID-19 në sundimin e ligjit në Kosovë, Misioni i Bashkimit Evropian për Sundimin e Ligjit në Kosovë (EULEX) arriti në përfundim se kufizimet e vendosura nga qeveria e Kosovës duke bërë përpjekje për të vendosur një ekuilibër në mes të mbrojtjes së të drejtës për jetë dhe shëndetësi, nga njëra anë, dhe masat e nevojshme kufizuese për të drejtat e njeriut dhe sundimin e ligjit si pjesë e reagimit institucional ndaj kërcënimit të pandemisë, nga ana tjetër, kanë ndikuar në funksionimin e institucioneve të sundimit të ligjit.⁵ Raporti rekomandon që ka nevojë urgjente për të adresuar mungesën e një baze të qartë ligjore për disa nga masat kufizuese të marra si pjesë e ligjit të lartpërmendur duhet të adresohet në mënyrë urgjente.

Kriza e COVID-19 në Kosovë, po ashtu konfirmon ndikimin negativ të pandemisë në disa aspekte të ekonomisë së vendit. Në nëntë muajt e parë të vitit 2020, ekonomia e Kosovës u tkurr për 5.6%.⁶

Ekipi i Kombeve të Bashkuara në Kosovë raportoi gjithashtu për efektet negative të COVID-19 në sektorin e biznesit të Kosovës. Kjo kryesisht për shkak të ndryshimeve të sjelljes së shoqërisë si dhe reduktimit të shpenzimeve të ekonomive familjare në fusha të caktuara të jetës, për të kompensuar humbjen e të ardhurave apo humbjet e mundshme të të ardhurave.⁷

5 EULEX, “Raport special për ndikimin e Covid-19 në sundimin e ligjit në Kosovë”. Mars 2020-Mars 2021. Në dispozicion në: https://www.eulex-kosovo.eu/eul/repository/docs/Covid%20Report_EN.pdf

6 OECD, “Kriza Covid-19 në Kosovë”. 31 janar 2021. Në dispozicion në: <https://www.oecd.org/south-east-europe/COVID-19-Crisis-in-Kosovo.pdf>

7 Ekipi i OKB-së në Kosovë, “Vlerësimi i shpejtë i ndikimit socio-ekonomik të Covid-19 në Kosovë”. maj 2021.

Treguesit ekonomike për ekonominë mbetën të zymtë. Ekonomia e Kosovës është goditur rëndë si nga masat kufizuese të brendshme ashtu edhe nga kufizimet ndërkombëtare të udhëtimit. Bruto Produkti Vendor (BPV) ka rënë në vitin e parë të pandemisë (në 2020), ndërsa deficitin fiskal u rrit si rezultat i rënies së të ardhurave nga tatimet dhe masave të rimëkëmbjes nga qeveria. Zhvillimet politike gjatë vitit të parë të pandemisë nuk ishin inkurajuese, pasi vendi pati tri qeveri të ndryshme gjatë vitit 2020. Vetëkuptohet që paqëndrueshmëria politike gjatë krizës së pandemisë krijoi shumë pengesa për ndihmën e duhur për qytetarët dhe bizneset gjatë pandemisë, një tregues i përmyllur edhe nga disa raporte.⁸

Megjithatë, Kosova ka ndarë afërsisht 570 milionë euro për përpjekjet për rimëkëmbjen ekonomike në vitin 2020 dhe 200 milionë euro të tjera në mbështetje të sektorit privat përmes Programit të Rimëkëmbjes Ekonomike në muajin dhjetor të vitit 2020⁹. Raporti i FMN-së për vendin për vitin 2020 vlerëson se BPV-ja e Kosovës ka rënë për 6% në vitin 2020 dhe deficitin fiskal është rritur në 7.7% të BPV-së së vendit. Gjithashtu, raporti vlerëson se deficitin i llogarisë është rritur në 7.5% të BPV-së, si rezultat i flukseve hyrëse nga diaspora, veçanërisht në fluksin e udhëtimeve, blerjet e pasurive të paluajtshme dhe remitancat.¹⁰ Megjithatë, ndoshta në kundërshtim me pritjet, një trend që ka lehtësuar deri diku ndikimin negativ të pandemisë në ekonominë përndryshe relativisht të varfër të Kosovës, janë remitancat nga diaspora e saj që, sipas një vlerësimi krahasues të ndikimit të COVID-19 në disa vendet perëndimore, është rritur gjatë pandemisë.¹¹

Pandemia e COVID-19 pengoi ndjeshëm funksionimin normal të qeverisjes lokale, pasi komunat u ballafaquan me vështirësi dhe mangësi në përballimin e sfidave të shkaktuara nga pandemia.

Në një raport studimi për nevojat dhe ndikimin social-ekonomik të COVID-19 në qeverisjen lokale që është realizuar me kryetarët e komunave dhe drejtorët e drejtorive komunale, ndër vështirësitë kryesore që janë evidentuar janë buxheti i kufizuar, mungesa e masave mbrojtëse, mungesa e personelit mjekësor, pajisjet për mësim online, kufizime e vendosura për veprimtaritë ekonomike etj.¹² Përkundër nivelit të lartë të bashkëpunimit të komunave me ministrinë qeveritare gjatë periudhës së pandemisë, siç raportohet në këtë studim, është raportuar një nivel më i ulët i kënaqshmërisë me këtë bashkëpunim. Edhe pse niveli i qeverisjes lokale është më i afërt dhe i lidhur më drejtpërdrejt me rrethanat socio-ekonomike të qytetarëve, komunat janë të kufizuara në aftësinë e tyre për t'i adresuar sfidat socio-ekonomike që dalin nga pandemia. Ato varen shumë nga grantet nga qeveria qendrore dhe kanë shumë të kufizuar të buxhetit vendor që mund të shpenzohet në fusha që lidhen me nevojat e veçanta që dalin nga pandemia. Siç vihet në pah nga një analizë e ndikimit të pandemisë në ekonominë e Kosovës në vitin 2020, e realizuar nga Instituti Kosovar për Qeverisje Lokale (KLGJ)¹³, këto kufizime thellohen pasi qeverisja lokale vuan nga një rënie e ndjeshme e tatimit në të ardhura, tatimit mbi shitjet dhe të hyrave të tjera. Nga ana tjetër, analiza arrin në përfundimin se “ndikimi i ndryshimeve në të hyra paraqet shkurtime potenciale dhe negative në infrastrukturë, shëndetësi, arsim dhe investime të tjera të rëndësishme”, të cilat, nga ana tjetër, do të kenë pasoja negative në shërbimet publike në nivel lokal në Kosovë.

-
- (F. 8) Në dispozicion në: <https://kosovoteam.un.org/sites/default/files/2021-06/SEIA%203.pdf>
- 8 Shih për shembull: raportin e Fondacionit për Liri të Friedrich Naumann me titull “Ndikimi i Covid-19 në Ekonominë e Kosovës”. Dhjetor 2020. (F. 8) Në dispozicion në: https://www.freiheit.org/sites/default/files/2021-05/broshura_eng.pdf
- 9 OECD, “Krizë Covid-19 në Kosovë”. 31 janar 2021. (P.2) Në dispozicion në: <https://www.oecd.org/south-east-europe/COVID-19-Crisis-in-Kosovo.pdf>
- 10 Raporti i FMN-së për vendin nr. 21/41, Ndikimi i Covid-19. Shkurt 2021. (Shih faqet 1, 4-5 të Raportit.) E disponueshme në: <https://www.elibrary.imf.org/view/journals/002/2021/041/article-A000-en.xml>
- 11 Instituti Shqiptar i Statistikave (INSTAT), “Ndikimi i Covid-19 në Ballkanin Perëndimor”. Prill 2021. Në dispozicion në: <https://statswiki.unece.org>
- 12 AKK, SDC, “Studim mbi nevojat emergjente dhe ndikimin socio-ekonomik të Covid-19 në pushtetin lokal në Kosovë”, korrik 2020. (Faqa 6). Në dispozicion në: <https://covid-congress-hub.org/en/partner/16-association-of-kosovo-municipalities.html>
- 13 Instituti i Kosovës për Pushtetin Lokal (IKLGI), “Ndikimi i Covid-19 në ekonominë e Kosovës”. 2020. (F.11) Në dispozicion në: <http://library.fes.de/pdf-files/bueros/kosovo/17758.pdf>

Qëllimet dhe objektivat e këtij raporti

Ky raport synon t'i identifikojë sfidat e shkaktuara nga COVID-19 veç e veç për secilën nga 38 komunat e Kosovës dhe në bazë të gjetjeve të tij të ofrojë rekomandime konkrete për rimëkëmbjen socio-ekonomike të komunave. Planifikohet të ndihmohen komunat nga MAPL-ja në atë që quhet 'rimëkëmbja e gjelbër' duke prioritetizuar fondet e reja në agjendat e gjelbra, digjitalizimin, zhvillimin e qëndrueshëm si dhe lëvizshmërinë dhe mobilitetin e qëndrueshëm urban. Pas këtij hulumtimi, projektet me prioritet, zhvillimi dhe rimëkëmbja afatgjate e komunave të Kosovës do të përcaktohen nga:

- Planet e emergjente të komunave për rimëkëmbjen ekonomike;
- Programi Kombëtar për Zhvillimin Ekonomik Lokal 2022 – 2029;
- Bashkëpunime të mëtejshme me donatorë duke u fokusuar në Objektivat e Zhvillimit të Qëndrueshëm të OKB-së dhe plani ekonomik dhe investues i BE-së për Ballkanin Perëndimor.

Titulli i raportit	NDIKIMET SOCIO-EKONOMIKE TË COVID-19 NË KOMUNAT E KOSOVËS
Objektiv	Qëllimi kryesor i këtij raporti është të ofrojë një sintezë të shpejtë se si komunat e Kosovës (sektori i biznesit, institucionet publike) janë prekur nga situata e krijuar nga pandemia globale COVID-19. Gjetjet e këtij raporti synojnë gjithashtu të ofrojnë reagimit ndaj krizës dhe masa afatgjate të rimëkëmbjes për t'i orientuar investimet e ardhshme nga niveli ndërkombëtar dhe qendror drejt ndihmës për komunat e Kosovës në zhvillimin dhe rimëkëmbjen e tyre afatgjate.
Shtrirja gjeografike	Evropa Juglindore, Kosovë
Zona	10 905.25 km ²
Ndarja administrative:	38 komuna
Banoret	1.78 milionë

Tabela 1. Titulli, objektivi dhe vendndodhja e synuar (burimi i të dhënave: ASK, 'Kosova në shifra, 2019')

Rasti i parë i raportuar:	13 mars 2020
Raste të konfirmuara:	161,356
Të shëruar:	158,016
Të vdekur:	2,990

Tabela 2. Përshkrim i shkurtër i COVID-19 në Kosovë (të dhënat e paraqitura janë të datës 28 dhjetor 2021), Burimi i të dhënave: IKSHPK <https://datastudio.google.com/.../2e546d77.../page/MTQqB>

MAPL-ja është themeluar në vitin 2004, me qëllim të avancimit të sistemit të vetëqeverisjes lokale, rritjes së autonomisë lokale dhe forcimit të aftësisë së komunave për të ofruar shërbime me kosto efektive për ta përmirësuar cilësinë e jetës, sigurinë dhe ekonominë lokale. Edhe pse UN-Habitat-i filloi të punojë në Kosovë në vitin 2000, kohë gjatë së cilës është fokusuar në aftësimin e institucioneve shtet formuese dhe mbështetjen e koordinimit dhe bashkëpunimit institucional ndërmjet niveleve të ndryshme vertikale dhe horizontale të qeverisjes.¹⁴ Puna e UN-Habitat-it në Kosovë bazohet në informata nga dy Plane Strategjike të UN-Habitat, përkatësisht ato të viteve 2014-2019 dhe 2020-2023.

Qëllimi i Planit Strategjik 2014-2019 ishte “qytetet dhe vendbanime të tjera njerëzore të planifikuara mirë, të qeverisura mirë dhe efikase, me banim adekuat, infrastrukturë dhe qasje universale në punësim dhe shërbime bazë si uji, energjia dhe kanalizimet.”¹⁵ Plani aktual Strategjik 2020-2023 fokusohet në “angazhimin dhe kontributin e UN-Habitat në zbatimin e atyre agjendave të zhvillimit global, në veçanti zotimin në Agjendën 2030 për Zhvillim të Qëndrueshëm për të mos lënë askënd pas”.¹⁶ Baza e vizionit të ri është “një cilësi më e mirë e jetës për të gjithë në një botë të urbanizuar”¹⁷. Si pjesë e angazhimit të tij për zhvillimin e qëndrueshëm, nëpërmjet këtij raporti, UN-Habitat-i synon gjithashtu të ofrojë ndihmë teknike për qeveritë lokale dhe qendrore drejt arritjes së Objektivave të Zhvillimit të Qëndrueshëm (OZHQ-të), në veçanti, Objektiv 11, Qytete dhe Komunitete të Qëndrueshme. Në vitin 2016, liderët botërorë miratuan Agjendën e Re Urbane (ARU), e cila vendos një standard të ri global për zhvillimin e qëndrueshëm urban.¹⁸

ARU trajton se si qytetet planifikohen, projektohen, menaxhohen, qeverisen dhe financohen për t’i arritur objektivat e zhvillimit të qëndrueshëm; duke u fokusuar në transformimin drejt përfshirjes sociale dhe dhënies fund varfërisë. UN-Habitat ka rritur gjithashtu bashkëpunimin me qeveritë dhe palët e tjera të interesit për zbatimin e ARU dhe urbanizimin e qëndrueshëm.

14 UN-Habitat, Kosova, Puna Jonë, <https://unhabitat-kosovo.org/about-us/un-habitat-kosovo/>

15 UN-Habitat, Rreth nesh, <http://unhabitat.org/about-us/goals-and-strategies-of-un-habitat/>

16 UN-Habitat, Plani Strategjik 2020-2023, https://unhabitat.org/sites/default/files/documents/2019-09/strategic_plan_2020-2023.pdf

17 Po aty.

18 OKB, Agjenda e Re Urbane: Angazhimet kryesore, 20 tetor 2016 <https://www.un.org/sustainabledevelopment/blog/2016/10/newurbanagenda/>



Figura 2. Objektivat Zhvillimore të OKB-së, burimi: UN-Habitat Kosova

2

METODOLOGJIA

Ky raport bazohet në një sërë metodash shumë planëshe, të dizajnuara me përzierje, duke përfshirë qasjet cilësore dhe sasiore të përafërta, të cilat janë përdorur gjatë procesit të mbledhjes së të dhënave. Megjithëse të dhënat e pritshme në këtë draft, nga UN-Habitat dhe palët e tjera të interesit, do të ndihmojnë në përsosjen e mëtejshme të qasjes dhe mjeteve metodologjike, deri më tani, gjatë fazës së shqyrtimit të dokumentacionit janë shqyrtuar matrica përkatëse e literaturës COVID-19, raportet ekzistuese, përfshirë pakon e masave emergjente të nxjerra nga qeveria qendrore dhe materiale nga burime të ndryshme interneti. Duke pasur parasysh se objektivi është të trajtohet ndikimi i COVID-19 në komunat dhe bizneset e Kosovës, më pas MAPL-ja dhe UN-Habitat-i përgatitën së bashku një pyetësor online (ose në kopje fizike për ata që nuk ishin të qasshëm online) me institucionet publike me qëllim mbledhjen e informacioneve specifike për fusha të ndryshme si; socio-ekonomike, arsimore, infrastrukturore etj. Përgjigjet janë mbledhur nga institucionet përkatëse komunale apo departamentet e identifikuar, përgjegjëse për t'iu përgjigjur pyetësorit në të 38 komunat e Kosovës. Për më tepër, një pyetësor online (ose në kopje fizike për ata që nuk ishin të qasshëm online) u krye gjithashtu me sektorin e biznesit, duke synuar bizneset mikro, të vogla dhe të mesme. Bizneset janë identifikuar përmes Agjencisë së Regjistrimit të Bizneseve në Kosovë (ARBK) dhe regjistrave komunalë në komunat përkatëse. Përtej vlerësimit të institucioneve publike dhe bizneseve të komunave përmes pyetësorëve/anketave të caktuara, të dhënat u mblodhën edhe nga punëtoritë e organizuara në shtatë rajonet kryesore të Kosovës, të mbajtura me pjesëmarrjen e përfaqësuesve të institucioneve qendrore dhe lokale si dhe të sektorit privat dhe palët publike të interesit. Një kornizë (e zhvilluar nga UNCDF dhe partnerë të tjerë të OKB-së) e bazuar në pesë dimensionet e mëposhtme përdoret për vlerësimin e institucioneve publike dhe sektorit të biznesit, veçanërisht gjatë dhe pas krizës COVID-19:



MJEDISI I
BIZNESIT



ARANZHIMET
EKONOMIKE
TË QEVERISË



TREGU
I PUNËS



MJEDISI
FINANCIAR



INFRASTRUKTURA,
SHERBIMET BAZIKE
DHE LIDHSHMËRIA

Dy të parat i referohen sistemeve urbane dhe përkrahëse, respektivisht, kushtet për veprimtarinë e biznesit (si publike ashtu edhe private), strukturën e ekonomive lokale, si dhe rregullat dhe rregulloret që rregullojnë aktivitetet e bizneseve, ndërsa dy të tjerat i referohen tregjeve të faktorëve (puna dhe kapitali, përkatësisht). Dimensi i pestë fokusohet në kapacitetin e infrastrukturës bazë dhe sistemeve të lidhshmërisë për të mundësuar dhe lehtësuar funksionimin e vazhdueshëm të katër dimensioneve të tjera të ekonomisë urbane në kushte stresuese.





Figura 3. Dimensionet e ndërtimit të qëndrueshmërisë për ekonomitë urbane. Burimi; UNDA-13- Broshura e Projektit të Qëndrueshmërisë Urbane

Sasia e madhe e materialeve të mbledhura nga burime të ndryshme dhe përdorimi i qasjes kërkimore të përqendruar në përdorim dhe metoda të përziera, duke marrë në konsideratë gjininë dhe përkatësinë etnike, do të sigurojë që gjetjet të nxirren nga një kontribut kolektiv nga një gamë e gjerë e grupeve të synuara, të trekëndëzuara dhe të validuara, dhe se konsiderata gjinore është e integruar në metodat e mbledhjes dhe analizës së të dhënave. Kryesisht, këto metoda do të përfshijnë:



Standardet etike merren parasysh gjatë gjithë procesit të analizës dhe shkrimit të të dhënave për të siguruar që kontributet e të anketuarve në anketë dhe në punëtori (zyrtarët komunalë, përfaqësuesit e bizneseve, pjesëmarrësit në punëtoritë rajonale) të trajtohen me integritet, respekt dhe – kur kërkohet – me konfidencialitet. Ky hulumtim parasheh një sintezë të shpejtë për secilën nga 38 komunat e Kosovës me theks të veçantë në Qeveritë Lokale dhe Sektorin e Biznesit që ndikojnë në kushtet e tregut të punës të ekonomive familjare. Raporti fokusohet gjithashtu në ofrimin e analizave që do të shërbenin për forcimin e kapaciteteve të pushtetit lokal për t'i hartuar, zbatuar dhe monitoruar planet e reagimeve dhe rimëkëmbjes ekonomike të qëndrueshme, rezistente dhe gjithëpërfshirëse ndaj COVID-19.

3

HYRJE

Periodha e pandemisë COVID-19 dhe kufizimet qeveritare të vendosura si pjesë e masave parandaluese patën ndikim negativ në ekonominë edhe ashtu të plogështa të komunave të Kosovës. Ekonomia u tkurr edhe në komunat me veprimtari relativisht të larta ekonomike, siç janë komunat e Prishtinës, Ferizajt dhe Prizrenit. Ndër sektorët e biznesit që janë më të ndikuarat nga kriza janë: gastronomia, hoteleria, ndërtimtaria, transporti, tregtia me pakicë e të ngjashme. Më shumë se 90% e përfaqësuesve të biznesit, të intervistuar për qëllimet e këtij studimi, deklaruan se veprimtaria e tyre afariste është ndikuar negativisht nga pandemia COVID-19, nga të cilët më shumë se 54% janë ndikuar fuqishëm (shih fig.).




Figura 4. Në përgjithësi, a ka ndikuar COVID-19 pozitivisht apo negativisht në aktivitetin tuaj të biznesit?
Në çfarë mase ka ndikuar pozitivisht/negativisht?

Gjetjet tregojnë se funksionimi i bizneseve është prekur në mënyra të ndryshme. Problemet më të shpeshta të raportuara të shkaktuara nga COVID-19 janë: gati 57% e bizneseve deklaruan rënie në shitjet e brendshme për konsumatorët, pothuajse 60% e bizneseve u mbyllën përkohësisht dhe numri i klientëve që nuk paguajnë ose vonojnë pagesat e faturave të tyre u rrit ndjeshëm, mungesat e punonjësve u rritën, ndërsa investimet u zvogëluan, etj. (shih fig. 4.3).




Figura 5. A ka ndikuar COVID-19 në aftësinë e biznesit tuaj për të shitur dhe blerë? (me shumë zgjedhje)

Si rezultat, bizneset u vunë në rrezik mbylljeje. Rreth 38% e përfaqësuesve të bizneseve, deklaruan se bizneset e tyre rrezikojnë të mbyllen për shkak të COVID-19 (shih fig. 4.4). Në të vërtetë, shumë biznese janë mbyllur në disa komuna të vogla që përballen me ekonomi të dobët dhe kapacitete të kufizuara financiare për rimëkëmbje, siç është komuna e Dragashit. Si rezultat, u rrit shkalla e papunësisë, pasi më shumë se 40% e bizneseve të përfshira në këtë studim raportuan se ishin të detyruar të shkurtonin numrin e të punësuarve nga 30 deri në 50%.




Figura 6. A mendoni se biznesi juaj rrezikohet të mbyllet për shkak të COVID-19? Nëse po, kur pritet të ndodhë kjo?

Megjithatë, vlen të theksohet se ka të dhëna të ndryshme për papunësinë, disa që tregojnë rritje të shkallës së papunësisë, ndërsa të tjera ulje të normave të papunësisë si pasojë e pandemisë. Kjo e fundit është rezultat i regjistrimit dhe formalizimit të punonjësve nga bizneset gjatë pandemisë me qëllim përfitimin nga subvencionet. Megjithatë, hendeuku i papunësisë është zgjeruar, pasi 5% e të punësuarve në sektorin publik dhe 35% e punonjësve të sektorit privat kanë humbur vendet e tyre të punës, veçanërisht në sektorët e bujqësisë, përpunimit dhe shitjes me shumicë. Shkalla e papunësisë u rrit tek grupet e veçanta, veçanërisht tek gratë dhe të rinjtë. Kriza financiare që u shfaq pati implikime të mëdha, veçanërisht për grupet e cenueshme të popullsisë dhe ekonomitë familjare, disa prej të cilave tashmë janë në kufi të varfërisë.

Sektori privat dhe bizneset e vogla janë prekur më shumë nga kriza e pandemisë. Ndikimi ekonomik dhe financiar i pandemisë ka ndikuar negativisht edhe në të hyrat vetanake dhe tatimore të komunave, në transferet ndërqeveritare si dhe në fondet komunale të transferuara nga buxheti i shtetit. Zyrtarët komunalë deklaruan se pa mbështetjen e qeverisë, ndihma ekonomike për bizneset lokale është sfidë serioze për komunat.

Megjithatë, kur janë pyetur për masat që kanë marrë komunat e tyre për t'i menaxhuar ndikimet negative të krizës së COVID-19, pjesa më e madhe e tyre (97%) janë deklaruar si një nga masat kryesore është mirëmbajtja dhe dezinfektimi i hapësirave dhe objekteve publike të përdorura për aktivitete biznesore formale dhe joformale. Masat e ndihmës për bizneset (76%) dhe mbështetja e synuar në formën e granteve ose ndihmës teknike për t'i mbështetur inovacionet (51%), dhe rregulloret për të lehtësuar regjistrimin dhe licencimin e biznesit (27%), u deklaruan gjithashtu si masat kryesore të ndërmarra për reagim ndaj COVID-19 dhe rimëkëmbje nga ky i fundit (shih fig. 4.5).




Figura 7. Çfarë masash ka marrë komuna dhe/ose po planifikon të marr për t'i menaxhuar ndikimet e krizës së COVID-19? (Mjedisi i biznesit, aktiviteti ekonomik lokal jashtë komunës)

Siç ilustron në fig. 4.5, mbështetja financiare apo masat lehtësuese në vlerë monetare dhe subvencionimi i linjës së pagave ishin dy format që bizneset përfituan më së shumti si pjesë e masave lehtësuese të qeverisë. Megjithatë, jo të gjitha bizneset e përfshira në studim përfituan, pasi afro 40% raportuan se bizneset e tyre nuk kanë përfituar në asnjë mënyrë nga masat lehtësuese.




Figura 8. A ka përfituar biznesi juaj nga masat lehtësuese të qeverisë qendrore (lokale)? Nëse po, cila nga masat?

Megjithatë, më shumë se gjysma e përfaqësuesve të biznesit të intervistuar për qëllimet e këtij studimi deklaruan se e kishin të vështirë ose shumë të vështirë t'i qasen informacioneve dhe përfitimeve nga programet e ndihmës qeveritare të lidhura me COVID-19.

Qëllimi kryesor i këtij raporti është të ofrojë një sintezë të shpejtë se si komunat e Kosovës (qeveria lokale dhe sektori i biznesit) janë prekur nga situata e krijuar nga pandemia globale COVID-19. Gjetjet e këtij raporti synojnë gjithashtu të ofrojnë reagimin ndaj krizës dhe masat e rimëkëmbjes, për t'i orientuar investimet e ardhshme nga niveli ndërkombëtar dhe qendror drejt ndihmës për komunat e Kosovës në zhvillimin dhe rimëkëmbjen e tyre afatgjatë. Kosova u përball me valë të reja të virusit, duke përjetuar, kështu, një rritje drastike të trendit të rasteve pozitive (dhe vdekjeve) (gusht-shtator 2021) dhe kjo ka ndikuar në zbatimin e masave të reja të rrepta nga ana e qeverisë, të cilat thelluan ndikimin socio-ekonomik. Ky hulumtim është veçanërisht i interesuar për rimëkëmbjen e qëndrueshme dhe gjithëpërfshirëse, e cila bazohet në parimin e “rimëkëmbjes më të mirë” dhe një strategjie të rimëkëmbjes socio-ekonomike me tre shtylla: kohezioni social dhe qëndrueshmëria e komunitetit, projektimi i vendeve të punës dhe rimëkëmbja ekonomike, dhe në fundi reagimi makroekonomik dhe bashkëpunimi shumëpalësh.

4

GJETJET KYÇE NGA KOMUNA

Në këtë kapitull të raportit, janë paraqitur profili(et) e secilës prej 38 komunave të Kosovës, në formatin vijues:



PROFILI I
KOMUNËS



NDIKIMET
KRYESORE
EKONOMIKE DHE
FINANCIARE



REAGIMI NDAJ
KRIZËS DHE
MASAT E
RIMËKËMBJES



NË VEND TË
PËRFUNDIMEVE

Komunat janë renditur sipas rendit alfabetik.




Figura 9. Rastet e COVID-19 sipas komunave në Kosovë. (të dhënat e paraqitura janë të datës 28 dhjetor 2021), Burimi i të dhënave: IKSHPK <https://datastudio.google.com/.../2e546d77.../page/MTOqB>



**PLAYGROUND
CLOSED**

To help limit the spread of COVID-19, this playground has been closed until further notice.

We apologize for any inconvenience.

Please visit calgary.ca/covid19 for more information.
Thank you.

CAUTION



CAUTION

CAUTION

Empire
MADE IN USA

CAUTION

CAUTION

CAUTION

Komuna e Deçanit



Profili i komunës

Ndikimi socio-ekonomik që ka pasur pandemia COVID-19 në Kosovë ka prekur të gjitha komunat e Kosovës, por jo me të njëjtin intensitet. Në Komunën e Deçanit, nga rasti i parë me COVID-19 në muajin mars të vitit 2020 deri në muajin dhjetor të vitit 2021, janë identifikuar 1816 raste me COVID-19, prej të cilave 1767 janë shëruar dhe 49 kanë rezultuar me vdekje. Për t'i koordinuar dhe menaxhuar veprimet për parandalimin e përhapjes së pandemisë COVID-19, Komuna ka ngritur Shtabin Emergjent, i cili ka marrë të gjitha masat mbrojtëse për parandalimin e përhapjes së pandemisë COVID-19 në përputhje me Vendimet e Ministrisë së Shëndetësisë (MSH) dhe Institutit Kombëtar të Shëndetësisë Publike të Kosovës (IKSHPK).



Ndikimet kryesore ekonomike dhe financiare

Edhe para pandemisë, Komuna e Deçanit posedonte një numër të madh të familjeve në nevojë për ndihmë sociale dhe me krizën e pandemisë këto shifra u rritën. Papunësia e cila tashmë ishte e lartë dhe kriza ekonomike me mbylljen e bizneseve të vogla që po ndodhte vazhdimisht për shkak të fillimit të pandemisë ndikuan ndjeshëm në mirëqenien e qytetarëve të kësaj komune.



Mjedisi i biznesit

Sipas zyrtarëve të kësaj komune, gjatë pandemisë në komunën e Deçanit janë prekur pothuajse të gjithë sektorët e fushës së biznesit, konkretisht gastronomia, tekstili, hoteleria, ndërtimtaria, industria e shitjes me pakicë, rrobaqepësia, sallonet e bukurisë etj. Megjithatë, nuk ka të dhëna për numrin e bizneseve të mbyllura si pasojë e pandemisë por sipas zyrtarëve komunalë, pandemia ka ndikuar negativisht në mbylljen e bizneseve deri në -85% dhe ka ndikuar në uljen e veprimtarisë ekonomike deri në -73%. Nga ana tjetër, është vlerësuar se pandemia ka ndikuar pozitivisht deri në 70% në lehtësimin e procedurave për hapjen e bizneseve të reja.



Aranzimet ekonomike të qeverisë

Zyrtarët komunalë të komunës së Deçanit deklaruan se bashkëpunimi i mirë në nivel lokal dhe qendror është lehtësuar edhe nga Asociacioni i Komunave të Kosovës (AKK). Gjatë periudhës së pandemisë, informacionet dhe konsultimet për çështjet ekonomike ofrohen në baza mujore.



Tregu i punës

Ekonomia lokale e komunës së Deçanit kryesisht dominohet nga bizneset individuale dhe mikro-bizneset dhe këto lloj biznesesh janë goditur dukshëm nga situata e pandemisë. Megjithatë, sektorët më të prekur për sa i përket shkallës së punësimit ishin gastronomia, tekstili, hoteleria, ndërtimtaria, industria e shitjes me pakicë, rrobaqepësia, sallonet e bukurisë, etj. Të dhënat zyrtare për numrin e të punësuarve dhe punëkërkuësve gjatë periudhës së pandemisë janë të paspecifikuara, por sipas zyrtarëve të komunës, pandemia ka ndikuar negativisht në shkallën e papunësisë deri në -90%, ndërsa ndikimin më të madh negativ, rreth -70%, e ka sidomos papunësia e grave dhe të rinjve. Nga ana tjetër, ndikimi që ka pasur pandemia në kushtet e punës është vlerësuar pozitivisht si pagat dhe orët e punës dhe pushimet nga puna, që sipas zyrtarëve komunalë ka ndikim pozitiv prej rreth 50% në këto dy elemente.



Mjedisi financiar

Ngjashëm me komunat tjera, edhe në komunën e Deçanit, viti 2020 ka shënuar rënie në të hyrat vetanake dhe tatimore, krahasuar me vitin paraprak. Megjithatë, sipas të dhënave të mbledhura nga zyrtarët komunalë, të hyrat kanë shënuar rritje të lehtë gjatë vitit 2021 përafërsisht 45% nga burimet vetanake dhe 65% nga të hyrat tatimore. Për shkak të situatës së pandemisë, buxheti komunal ka përfituar edhe subvencione dhe donacione nga donatorë të jashtëm.



Infrastruktura, shërbimet bazike dhe lidhshmëria

Për shërbimet e kujdesit shëndetësor, zonat rurale larg objekteve shëndetësore kanë qenë më të prekura gjatë pandemisë pasi shërbimet e transportit publik kanë qenë më të kufizuara gjatë kësaj periudhe. Sipas të dhënave të zyrtarëve komunalë, pandemia ka pasur ndikim negativ që vlerësohet të jetë rreth -50% në qasjen në transport dhe mobilitet. Si pasojë, shumica e qytetarëve u detyruan të përdorin transportin privat. Shërbimet e energjisë elektrike janë deklaruar si në nivelin e duhur të furnizimit. Megjithatë, disa zona rurale të kësaj komune kanë hasur në probleme gjatë periudhave të përkeqësimit të kushteve atmosferike.

Dimensionet	Gjetjet kryesore
Mjedisi i biznesit	Pothuajse të gjithë sektorët e fushës së biznesit u prekën. Kryesisht sektori i gastronomisë, tekstilit, hotelierisë, ndërtimtarisë, industrisë së shitjes me pakicë, rrobaqepësisë, salloneve të bukurisë etj.
Aranzhimet ekonomike të qeverisë	Mekanizmat e bashkëpunimit në nivel lokal dhe qendror janë raportuar si shkëmbim informacioni dhe konsultime të ndërsjella.
Tregu i punës	Sektorët që preken më shumë sa i përket shkallës së punësimit janë gastronomia, tekstili, hoteleria, ndërtimtaria, industria e shitjes me pakicë, rrobaqepësia, sallonet e bukurisë etj.
Mjedisi financiar	Gjatë vitit 2020 ka pasur rënie në të hyrat vetanake dhe tatimore, rritje janë shënuar gjatë vitit 2021
Infrastruktura, shërbimet bazike dhe lidhshmëria	Shërbimet e kujdesit shëndetësor, grumbullimit të mbeturinave, ujit të pijshëm, sanitare dhe transportit janë raportuar të jenë në nivel të kënaqshëm në zonat urbane. Disa vështirësi sa i përket infrastrukturës dhe konektivitetit janë raportuar për zonat rurale.



Reagimi ndaj krizës dhe masat e rimëkëmbjes

Gjatë krizës së pandemisë, Komuna e Deçanit, në kuadër të mundësive buxhetore, ka shfrytëzuar kapacitetet e veta, siç janë përkrahja e bizneseve me lirim nga tatimet komunale, lejimi i shfrytëzimit të objekteve të jashtme, ofrimi i inpleteve falas apo të subvencionuara për bizneset kritike (p.sh., miell për bukë), subvencione ushqimore për familjet në nevojë dhe për ata me COVID-19, mbështetje financiare për ndërmarrjen komunale "HIGJIENA" për qëndrueshmërinë e saj dhe shërbime të tjera të qytetarëve. Komuna e Deçanit ka vlerësuar edhe pasojat ekonomike dhe financiare për këtë komunë në plan afatmesëm dhe afatgjatë si pasojë e krizës së pandemisë të të gjithë sektorëve por aktualisht deklarohet se nuk ka kapacitete financiare për të rimëkëmbjes.

Në vend të përfundimeve



Duke qenë se edhe para pandemisë, kjo komunë përballë me një situatë të vështirë ekonomike, kriza e pandemisë e ka rënduar më shumë atë. Sektori privat dhe bizneset e vogla janë më të prekurat.

Komuna e Dragashit



Profili i komunës

Në komunën e Dragashit, që nga rasti i parë me COVID-19 më 4 prill 2020 deri në muajin dhjetor të vitit 2021, janë identifikuar 704 raste me COVID-19, 656 prej të cilave janë shëruar, ndërsa 48 kanë rezultuar me vdekje. Për të koordinuar dhe menaxhuar veprimet e saj parandaluese nga pandemia COVID-19, Komuna ka ngritur Shtabin e Emergjent, i cili ka marrë të gjitha masat mbrojtëse për parandalimin e përhapjes së situatës së pandemisë. Vlen të theksohet se të gjitha veprimet komunale janë raportuar se janë ndërmarrë në përputhje me vendimet e MSH-së dhe IKSHPK-së.



Ndikimet kryesore ekonomike dhe financiare

Problemet kryesore të deklaruara të kësaj komune janë papunësia, zhvillimi ekonomik dhe mungesa e pronës komunale. Edhe pse disa biznese që operojnë në këtë komunë hapën disa vende pune, numri i të papunëve është ende shumë i lartë.



Mjedisi i biznesit

Sipas zyrtarëve të kësaj komune, gjendja me pandemi në komunën e Dragashit ka prekur pothuajse të gjitha bizneset. Megjithatë, sektorët më të prekur mbeten sektori i gastronomisë, tekstilit, hotelierisë, ndërtimtarisë, industrisë së shitjes me pakicë, rrobaqepësisë, salloneve të bukurisë etj. Nga fillimi i pandemisë deri në fund të vitit 2021, në këtë komunë janë mbyllur 30 biznese, 11 prej tyre, gjatë vitit 2020 dhe 19 gjatë vitit 2021. Për sa i përket ndarjes gjinore të pronarëve, të dhënat tregojnë se nga gjithsej 19 biznese të mbyllura, 18 prej tyre drejtoheshin nga pronarë meshkuj dhe vetëm 1 nga pronarë femër. Sipas zyrtarëve komunalë, pandemia ka ndikuar negativisht në mbylljen e bizneseve me pronësi shumicë femërore deri në -62% dhe ka ndikuar në uljen e veprimtarisë ekonomike deri në -94%.



Aranzhimet ekonomike të qeverisë

Gjatë pandemisë në komunën e Dragashit të gjithë sektorët e fushës së biznesit janë të prekur nga papunësia. Sektorët më të prekur mbeten gastronomia, tekstili, hoteleria, ndërtimtaria, industria e shitjes me pakicë, rrobaqepësia, sallonet e bukurisë etj. Nuk raportohen të dhëna zyrtare për numrin e të punësuarve dhe punëkërkesve për periudhën e pandemisë. Megjithatë, sipas zyrtarëve komunalë, pandemia ka ndikuar negativisht në shkallën e papunësisë deri në -98%, ndërsa ndikimin më të madh negativ, rreth -64%, e ka sidomos papunësia e grave dhe të rinjve.



Tregu i punës

Gjatë pandemisë në komunën e Dragashit të gjithë sektorët e fushës së biznesit janë të prekur nga papunësia. Sektorët më të prekur mbeten gastronomia, tekstili, hoteleria, ndërtimi, industria e shitjes me pakicë, rrobaqepësia, sallonet e bukurisë etj. Nuk raportohen të dhëna zyrtare për numrin e të punësuarve dhe punëkërkesve për periudhën e pandemisë. Megjithatë, sipas zyrtarëve komunalë, pandemia ka ndikuar negativisht në shkallën e papunësisë deri në -98%, ndërsa ndikimin më të madh negativ, rreth -64%, e ka sidomos papunësia e grave dhe të rinjve.



Mjedisi financiar

Ngjashëm me komunat tjera, edhe në komunën e Dragashit gjatë vitit 2020 ka pasur rënie të të hyrave vetanake dhe të të hyrave tatimore në krahasim me vitin paraprak, por këto më pas, sipas të dhënave të hulumtimit janë rritur në vitin 2021 me rreth 74%. Në këtë periudhë të pandemisë është rritur edhe buxheti për subvencione dhe donacione nga donatorët e jashtëm.



Infrastruktura, shërbimet bazike dhe lidhshmëria

Të dhënat tregojnë se rreth 71% e familjeve në këtë komunë kanë qasje në rrjetin e ujësjellësit. Sa i përket shërbimeve sanitare, gjatë pandemisë, komuna e Dragashit ka raportuar se ka dezinfektuar objektet publike, shkollat dhe stacionet, si dhe ka shpërndarë materiale higjienike në të gjitha institucionet publike. Edhe pse disa vështirësi raportohen për zonat rurale për sa i përket shërbimeve të grumbullimit të mbeturinave gjatë situatës së pandemisë, ku sipas zyrtarëve komunalë është vlerësuar se ka pasur një ndikim negativ prej rreth -59%, por me kalimin e kohës situata është përmirësuar. Pengesa dhe vonesa u raportuan edhe në shërbimet e mirëqenies sociale, që prekin më së shumti zonat rurale. Ndërkohë që shërbimet e transportit nuk u përballën me vështirësi edhe gjatë situatës së pandemisë.

Dimensionet	Gjetjet kryesore
Mjedisi i biznesit	Pothuajse të gjithë sektorët e biznesit u prekën. Sektori i gastronomisë, tekstilit, hotelarisë, ndërtimtarisë, industrisë së shitjes me pakicë, rrobaqepësia, sallonet e bukurisë, etj. po përballen me një krizë e madhe. Gjithsej 30 biznese janë mbyllur gjatë 2020/2021.
Aranzimet ekonomike të qeverisë	Mekanizmat e bashkëpunimit në nivel lokal dhe qendror kanë raportuar se janë shkëmbyer informacione dhe konsultime të ndërsjella.
Tregu i punës	Sektorët më të prekur për sa i përket punësimit janë gastronomia, tekstili, hotelaria, ndërtimtaria, industria e shitjes me pakicë, rrobaqepësia, sallonet e bukurisë etj.
Mjedisi financiar	Gjatë vitit 2020 ka pasur rënie të të hyrave vetanake dhe tatimore, por rritje e lehtë e të hyrave është shënuar gjatë vitit 2021.
Infrastruktura, shërbimet bazike dhe lidhshmëria	Komuna e Dragashit ka dezinfektuar të gjitha objektet publike dhe ka shpërndarë materiale higjienike në të gjitha institucionet publike. Shërbimet shëndetësore, grumbullimi i mbeturinave, uji i pijshëm, kanalizimi dhe shërbimet e transportit ishin në nivel të kënaqshëm në një zonë urbane.



Reagimi ndaj krizës dhe masat e rimëkëmbjes

Mungesa e mjeteve financiare të komunës i kufizoi mundësitë për masa të rimëkëmbjes. Komuna, megjithatë, mori disa masa kryesisht duke dhënë grante ose subvencione për t'i ndihmuar bizneset që janë mbyllur përkohësisht. Përveç kësaj, komuna e Dragashit gjithashtu ka mbështetur bizneset me masa lehtësimi (heqje ose shtyrje të tatimeve dhe tarifave komunale, ndalime të dëbimit të bizneseve nga objektet e marra me qira, etj.), grante ose asistencë teknike për t'i mbështetur inovacionet për reagimin dhe rimëkëmbjen nga COVID-19, etj.

Në vend të përfundimeve



Dragashi është një komunë e vogël dhe veprimtaritë ekonomike edhe para pandemisë ishin të pakta. Periudha e COVID-19 e bëri situatën edhe më të vështirë. Shumë biznese janë mbyllur dhe Komuna nuk ka kapacitete të mjaftueshme financiare për masat afatgjate të rimëkëmbjes.

Komuna e Drenasit



Profili i komunës

Në komunën e Drenasit, nga muaji mars i vitit 2020 deri në muajin dhjetor të vitit 2021, janë identifikuar 3440 raste me COVID-19, 3351 prej të cilave janë shëruar dhe 89 kanë rezultuar me vdekje. Për t'i koordinuar dhe menaxhuar veprimet dhe parandalimin e përhapjes së pandemisë COVID-19, Komuna ka ngritur Shtabin e Emergjencave. Të gjitha masat mbrojtëse për parandalimin e përhapjes së pandemisë COVID-19 ndërmerren në përputhje me Vendimet e MSH-së dhe IKSHPK-së.



Ndikimet kryesore ekonomike dhe financiare

Zhvillimi i Drenasit varet në masë të madhe nga rreth 4000 biznese që veprojnë në këtë komunë. Zyrtarët komunalë raportuan se situata e pandemisë ka ndikuar kryesisht në sektorët e hotelarisë dhe mikrobizneseve (turizmi), deri në 65% e këtyre bizneseve kanë shënuar një normë më të ulët recesioni gjatë viteve 2020/21, duke arritur rreth 40% rënie të të hyrave të tyre vjetore.



Mjedisi i biznesit

Të dhënat tregojnë mbylljen ose mosveprim të bizneseve të shumta gjatë periudhës së pandemisë. Sipas zyrtarëve komunalë, pandemia kishte ndikuar në uljen e veprimtarisë ekonomike deri në -65%. Nga ana tjetër, është vlerësuar se pandemia ka ndikuar pozitivisht 100% në lehtësimin e procedurave për hapjen e bizneseve të reja. Për shkak të orarit të kufizuar të punës, vetëm në vitin 2020 janë mbyllur rreth 27 biznese, ndërsa në vitin 2021 janë mbyllur 21 biznese. Nga 27 biznese të mbyllura në vitin 2020, 6 prej tyre drejtoheshin nga gra (ose 22%) ndërsa në vitin 2021, 6 nga bizneset e mbyllura drejtoheshin nga gratë (28.5%). Zyrtarët komunalë të intervistuar për qëllime të këtij studimi kanë përmendur edhe ekonominë joformale si të pranishme, megjithatë ata konsiderojnë se është në parametra më të ulët në krahasim me rajonet tjera të Kosovës.



Aranzhimet ekonomike të qeverisë

Zyrtarët komunalë të Drenasit raportuan bashkëpunim të mirë në mes të nivelit lokal dhe atij qendror gjatë periudhës së pandemisë. AKK-ja po ashtu raportohet si lehtësuese në këtë drejtim, në baza mujore janë ofruar informata dhe konsultime të ndërsjella për qytetarët.



Tregu i punës

Sektorët më të prekur në këtë komunë raportohet të jenë industria e ndërtimtarisë dhe prodhimit, e ndjekur nga gastronomia dhe hoteleria. Normat e punësimit ranë ndjeshëm gjatë pandemisë. Sipas zyrtarëve komunalë, pandemia ka ndikuar negativisht në shkallën e papunësisë deri në -45%. Bazuar në statistikat e marra nga zyra komunale e punësimit, në vitin 2021 ishin të punësuar vetëm 89 persona. Komuna e Drenasit nuk ka raportuar për largime nga puna të punëtorëve në sektorin publik, ndërsa nuk ka pasur informata për sektorin privat.



Mjedisi financiar

Bazuar në gjetjet e këtij studimi, në komunën e Drenasit, të hyrat vetanake janë rritur vazhdimisht duke shënuar një përqindje prej rreth 9.5%. Të hyrat komunale nga tatimi në pronë për vitin 2020 arritën shumën prej 448,947 €, ose një rritje prej 78,8%, ndërsa gjatë vitit 2021 janë mbledhur 685,842 €, duke arritur një rritje prej 138%. Gjithashtu u theksua se kjo komunë ka mbështetje të vazhdueshme financiare nga donatorët e jashtëm.



Infrastruktura, shërbimet bazike dhe lidhshmëria

Gjetjet tregojnë se komuna e Drenasit ofron qasje në shërbimet bazë për sigurimin e ujit të pijshëm për 60.5% të ekonomive familjare dhe kjo nuk ka ndryshuar as gjatë pandemisë. Sipas të dhënave nga zyrtarët komunal, pandemia ka ndikuar negativisht që llogaritet të jetë rreth -40% në sigurimin e ujit të pijshëm. Për sa i përket shërbimeve sanitare, Komuna ka angazhuar inspektorët sanitarë dhe mjedisorë, për ta monitoruar mirëmbajtjen e higjienës në ndërtesat administrative si dhe situatën mjedimore në përgjithësi. Sipas zyrtarëve komunal, të gjitha vendbanimet në komunën e Drenasit janë të përfshira në shërbimin e grumbullimit të mbeturinave por pandemia ka ndikuar negativisht në Kompaninë Rajonale për Grumbullimin e Mbeturinave (KRGM) “Pastrimi”, pasi kjo kompani punonte me një numër më të vogël punonjësish për shkak të masave kundër COVID-19. Si pasojë, ka pasur raste kur shërbimet e pastrimit janë vonuar. Për sa i përket shërbimeve të transportit, zyrtarët komunalë të intervistuar për qëllime të këtij studimi kanë deklaruar se 95.2% e fshatrave të kësaj komune janë të përfshira në sistemin e transportit publik në zonat urbane-periferike. Megjithatë, zyrtarët komunalë kanë raportuar se gjatë periudhës së pandemisë ky shërbim ka hasur në vështirësi në funksionim. Në komunën e Drenasit si dhe në mbarë Kosovën, sistemi arsimor ka funksionuar në tre skenarë.

Dimensionet	Gjetjet kryesore
Mjedisi i biznesit	Në vitin 2020/2021 janë mbyllur rreth 48 biznese. Nga 12 prej tyre drejtoreshin nga gratë.
Aranzhimet ekonomike të qeverisë	Raportohet se ka bashkëpunim të rregullt ndërmjet institucioneve të nivelit lokal dhe atij qendror. Informacionet dhe konsultimet e ndërsjella ofrohen në baza mujore.
Tregu i punës	Sektorët më të prekur në këtë komunë janë industria e ndërtimit dhe e prodhimit, e ndjekur nga sektori i hotelerisë dhe gastronomisë.
Mjedisi financiar	Kjo komunë ka shënuar rritje të të hyrave vetanake dhe të tatimit në pronë gjatë periudhës së pandemisë. Mbështetja e vazhdueshme financiare nga donatorët e jashtëm është theksuar edhe nga zyrtarët komunalë të intervistuar për qëllimet e këtij studimi.
Infrastruktura, shërbimet bazike dhe lidhshmëria	Shërbimet shëndetësore, grumbullimi i mbeturinave, uji i pijshëm, shërbimet sanitare dhe të transportit kanë qenë në nivel të kënaqshëm në zonat urbane, ndërsa disa zona rurale janë prekur pak.



Reagimi ndaj krizës dhe masat e rimëkëmbjes


Sa i përket masave afatmesme të rimëkëmbjes, sipas të anketuarve të intervistuar, komuna ka ndihmuar sektorin e shëndetësisë duke angazhuar staf shtesë dhe duke ndarë hapësira të reja për kryerjen e shërbimeve shëndetësore. Gjithashtu, Komuna shpërndau ndihma emergjente me pako ushqimore për familjet në nevojë për ndihmë sociale dhe mori masa lehtësuese për bizneset si lirimi nga pagesa e tatimeve komunale dhe ofrimi i lëndëve të para pa pagesë ose subvencione për bizneset kritike. Komuna gjithashtu ri-prioritizoi dhe riprogramoi buxhetin ekzistues komunal për të rritur disponueshmërinë e financimit për zonat kritike për reagimin dhe rimëkëmbjen nga COVID-19. Për sa i përket masave të rimëkëmbjes në planin afatgjatë, kjo komunë nuk ka hartuar asnjë plan por funksionon vetëm në bazë të planit të qeverisë për rimëkëmbjen ekonomike që është miratuar në vitin 2021. Megjithatë, ky plan nuk ofron të dhëna për buxhetet e parapara që do të ndahen për komuna.

Në vend të përfundimeve



Përveç përpjekjeve të përgjithshme pozitive, kjo komunë nuk ka kapacitet të ndikojë në rimëkëmbjen afatgjatë. Sipas tyre, kjo është përgjegjësi e pushtetit qendror. Sfidë e vazhdueshme e kësaj komune mbetet çështja e papunësisë, e tillë vazhdon të jetë edhe pas situatës së pandemisë.

Komuna e Ferizajit



Profili i komunës

Që nga data 13 marsi i vitit 2020, kur u raportuan dy rastet e para të infektimit me COVID-19 në Kosovë, kriza e pandemisë u përhap në të gjitha komunat, përfshirë dhe Ferizajn. Nga muaji mars i vitit 2020 deri në muajin dhjetor të vitit 2021, numri i përgjithshëm i rasteve të identifikuar me COVID-19 në komunën e Ferizajt është 9123, prej të cilave 96 raste kanë përfunduar me fatalitet ndërsa 8938 raste janë shëruar. Më parë, Komuna e Ferizajt nuk posedonte plan për menaxhim emergjent në rast të pandemisë, në të vërtetë 'planet' ekzistuese të krizave ishin të fokusuar kryesisht në menaxhimin e vërshimeve të shiut ose daljen e lumit nga shtrati, etj.



Ndikimet kryesore ekonomike dhe financiare

Komuna e Ferizajt është komuna e tretë më e madhe në Kosovë për nga sipërfaqja dhe e dyta pas kryeqytetit të Prishtinës për nga zhvillimi ekonomik. Zyrtarët komunalë të intervistuar për qëllime të këtij studimi kanë deklaruar se përveç vështirësive në menaxhimin e situatës me COVID-19, komuna e Ferizajt është përballur me një numër të madh të problemeve të dala si pasojë e krizës së pandemisë. Rritja e varfërisë ka thelluar pabarazinë mes njerëzve, ndërkohë që ekonomia tashmë e dobët ka pësuar dëme pothuajse të pariparueshme.



Mjedisi i biznesit

Rezultatet e marra nga anketa e kryer me bizneset që operojnë në këtë komunë konfirmuan se pandemia COVID-19 dëmtoi pothuajse të gjitha veprimtaritë ekonomike të bizneseve të ndryshme me rreth 7% ndikim në recesionet ekonomike. Shumica e bizneseve deklaruan se janë të detyruar të shkurtojnë stafin e tyre për shkak të krizës ekonomike. Ndërkohë, disa biznese përmendën mundësinë e mbylljes, për shkak të krizës financiare të shkaktuar nga pandemia. Mbyllja e përkohshme e bizneseve dhe vonesat në kryerjen e pagesave nga klientët janë dy nga problemet më të zakonshme që hasin pronarët e bizneseve të cilat ishin pjesë e hulumtimit. Disa biznese kanë pranuar se kanë marrë ndihmë financiare nga institucionet e nivelit qendror ose lokal, por disa kanë deklaruar edhe se nuk kanë marrë ndihmë financiare nga asnjë institucion. Megjithatë, shumica dërrmuese e pronarëve të bizneseve e konsiderojnë mbështetjen më të mirë të mundshme nga institucionet subvencionimin e një përqindjeje të pagave të punëtorëve për një periudhë të caktuar. Nga ana tjetër, është vlerësuar se pandemia ka ndikuar pozitivisht deri në 20% në lehtësimin e procedurave për hapjen e bizneseve të reja.



Aranzimet ekonomike të qeverisë

Sipas zyrtarëve komunal, mungonte koordinimi ndërkomunal që do të siguronte menaxhim efikas të pandemisë COVID-19. Ndërsa mekanizmat e bashkëpunimit në nivel lokal dhe qendror kanë qenë informimi dhe konsultimi i ndërsjellë.



Tregu i punës

Për sa i përket shkallës së punësimit, gjetjet spikatin sektorin privat, Ndërmarrjet e Vogla dhe të Mesme (NVM), fermerët dhe të vetëpunësuarit si më të prekurit nga kriza e pandemisë në këtë komunë. Ndërsa theks i veçantë vihet tek bizneset tregtare dhe ato të shërbimeve, pasi janë prekur vendet e punës në këto industri. Sipas zyrtarëve komunal, ndikimi i pandemisë në shkallën e papunësisë është deri në 7%, ndërsa ndikimin më të madh negativ, rreth -13%, e ka sidomos papunësia e grave dhe të rinjve.



Mjedisi financiar

Në aspektin financiar, gjatë vitit 2020 ka pasur rënie të të hyrave vetanake dhe tatimore krahasuar me vitin paraprak, por këto më pas, sipas të dhënave të hulumtimit janë rritur në vitin 2021 për afërsisht 58% në të hyrat tatimore. Ata patën vështirësi në përmbushjen e detyrimeve buxhetore të ndjekura nga vendimet gjyqësore dhe përmbaruese, të dala nga kontratat kolektive të punës dhe problemet me zbatimin e projekteve kapitale me theks të veçantë në ato të bashkëfinancuara nga ministritë e linjës etj.



Infrastruktura, shërbimet bazike dhe lidhshmëria

Përveç krizës financiare, kjo komunë u përball me sfida edhe në fushën e arsimit dhe shëndetësisë. Këto kriza ndodhën veçanërisht për shkak të mungesës së stafit që rrjedh nga vendimet e qeverisë për lirim të stafit mbi 60 vjeç, grave shtatzëna, nënave me fëmijë nën moshën 3 vjeç dhe zyrtarëve me sëmundje kronike, ndërsa në të njëjtën kohë u mungojnë mekanizmat për zëvendësimet. Kjo rrit nevojën për mbrojtjen e vetë sistemit shëndetësor dhe ofrimin e arsimit cilësor gjithëpërfshirës dhe të barabartë për të gjithë. Ndërsa zyrtarët komunalë të intervistuar për këtë studim theksuan se përdërisa zonat rurale janë prekur nga transporti dhe shërbimet e mirëqenies sociale, zonat urbane janë prekur më shumë afekcion në aspektin e ujit të pijshëm, shërbimeve sanitare dhe shërbimeve shëndetësore. Nga ana tjetër, të anketuarit gjithashtu deklaruan se nuk kanë probleme në ofrimin e shërbimeve arsimore (mësimi online) dhe të pastrimit dhe as nuk kanë marrë ankesa nga qytetarët për këto fusha.

Dimensionet	Gjetjet kryesore
Mjedisi i biznesit	Shumica e bizneseve deklaruan se janë të detyruar të shkurtojnë stafin e tyre për shkak të krizës ekonomike. Ndërkohë, disa biznese përmendën mundësinë e mbylljes, për shkak të krizës financiare të shkaktuar nga pandemia.
Aranzimet ekonomike të qeverisë	Kishte mungesë të koordinimit ndërkomunal që do të siguronte menaxhim efikas të pandemisë COVID-19.
Tregu i punës	Gjetjet spikatin ndërmarrjet e vogla dhe të mesme, fermerët dhe të vetëpunësuarit si më të prekurit nga kriza e pandemisë në këtë komunë.
Mjedisi financiar	Gjatë vitit 2020 ka pasur rënie të të hyrave vetanake dhe të të hyrave tatimore në krahasim me vitin paraprak, por këto më pas, sipas të dhënave të hulumtimit kanë shënuar rritje në vitin 2021.
Infrastruktura, shërbimet bazike dhe lidhshmëria	Zonat rurale janë prekur sa i përket transportit dhe shërbimeve të mirëqenies sociale, ndërsa zonat urbane janë prekur më shumë sa i përket ujit të pijshëm, shërbimeve sanitare dhe shërbimeve shëndetësore.



Reagimi ndaj krizës dhe masat e rimëkëmbjes

Gjetjet tregojnë se roli i komunës së Ferizajt në menaxhimin e krizës së pandemisë është fokusuar në disa drejtime. Për sa i përket masave afatmesme të rimëkëmbjes, sipas zyrtarëve komunalë, mbështetja bizneseve u ofrohet me mjete financiare (për shembull duke ndihmuar kompanitë e linjave të transportit urban dhe ndërrurban), hapësirë adekuate fiskale, shtyrje të pagesave administrative dhe komunale për qytetarët dhe bizneset, si dhe ofrimi i pandërprerë i shërbimeve kryesore publike. Zyrtarët e komunës së Ferizajt theksuan se kanë mbështetur familjet në nevojë me pako ushqimore, ndihmuan pacientët me COVID-19 duke ofruar kontrolle në shtëpi dhe kanë ngritur një platformë socio-psikologjike përmes televizorit për ligjërata motivuese me psikologët e qytetit etj. Ndërsa sa i përket masave afatgjate të rimëkëmbjes, Qeveria e Kosovës ka miratuar Pakon e Rimëkëmbjes Ekonomike (2021) e cila parashikon disa masa për mbështetjen financiare të ndarë sipas sektorëve. Në mbështetje të rimëkëmbjes ekonomike dhe prodhimit, kjo pako ofron ndihmë financiare prej 108 milionë eurosh, duke përfshirë subvencionet e kredisë për investime, rikuperimin e mbylljes së hoteleve dhe bizneseve, mbështetjen e eksportit, mbështetjen e biznesit për qasje në financa, etj. Në mirëqenien sociale dhe arsimim, Pakoja e rimëkëmbjes së qeverisë ka ofruar ndihma financiare prej 50 milionë eurosh, duke përfshirë mbështetjen për pensionistët dhe familjet me asistencë sociale, mbështetjen për familjet që kanë humbur kryefamiljarin, kuponë ushqimorë për familjet në nevojë, pagesa për nënat e papuna etj., por nuk ka të dhëna se si janë ndarë ato sipas komunave.

Në vend të përfundimeve



Komuna e Ferizajt nuk ka ndonjë masë afatgjate për rimëkëmbje nga pasojat e pandemisë COVID-19 dhe aktualisht nuk është duke punuar në hartimin ndonjë mase. Kriza financiare ka pasur implikime të mëdha për grupet e cënueshme të popullsisë dhe familjet, disa prej të cilave tashmë janë në kufi me varfërinë. Ndhimja e dhënë nuk garanton rimëkëmbje të qëndrueshme, sepse është aplikuar si ndihmë afatshkurtër vetëm për ta korrigjuar përkohësisht situatën.

Komuna e Fushë Kosovës



Profili i komunës

Në komunën e Fushë Kosovës, nga rasti i parë me COVID-19 në muajin mars të vitit 2020 deri në muajin dhjetor të vitit 2021, janë identifikuar 6773 raste me COVID-19, nga të cilat janë shëruar 6684 persona, ndërsa 81 kanë rezultuar me vdekje. Për t'i koordinuar dhe menaxhuar veprimet për parandalimin e përhapjes së pandemisë COVID-19, Komuna ka ngritur Shtabin e Emergjencave, i cili ka marrë të gjitha masat mbrojtëse për parandalimin e përhapjes së pandemisë COVID-19 në përputhje me Vendimet e MSH-së dhe IkSHPK-së.



Ndikimet kryesore ekonomike dhe financiare

Zhvillimi i vullshëm në Komunën e Fushë Kosovës, ndërtime të reja, krijimi i objekteve të shumta nga komuna për zhvillimin e veprimtarive ekonomike, tërheqja e bizneseve dhe hapja e tyre kanë krijuar mundësi të mëdha punësimi dhe një mjedis mjaft të favorshëm për jetesën e qytetarëve. Këto zhvillime nga njëra anë kanë sjellë shumë përfitime, por nga ana tjetër kanë shkaktuar sfida të mëdha për këtë komunë. Për shkak të rritjes së ndjeshme të numrit të banorëve, kërkesat në të gjitha fushat e ofrimit të shërbimeve komunale janë rritur, ndërsa numri i stafit në shëndetësi, arsim, administratë etj., ka mbetur i njëjtë. Për shkak të afërsisë me kryeqytetin e Kosovës, qytetarë të shumtë nga Presheva si dhe nga pjesët tjera të Kosovës janë shpërngulur në Fushë Kosovë. Ky fakt shkaktoi një rritje të ndjeshme të numrit të banorëve, ndërkohë që kapaciteti i komunës për të akomoduar një numër kaq të madh banorësh mbetet i kufizuar.



Mjedisi i biznesit

Të dhënat tregojnë se komuna e Fushë Kosovës ka shënuar rënie prej 50% të aktiviteteve ekonomike gjatë muajve mars, prill dhe maj të vitit 2020, duke filluar me një rritje të vogël gjatë gjithë vitit 2020, ndërsa në vitin 2021 një ngritje dhe stabilitet optimal. Ekonomia lokale në Fushë Kosovë dominohet nga bizneset individuale, dhe mikrobizneset të cilat janë goditur nga situata e pandemisë si pasojë e kufizimeve dhe rekomandimeve të institucioneve kompetente. Sipas zyrtarëve komunalë, pandemia ka ndikuar negativisht në mbylljen e bizneseve deri në -30%. Për periudhën dyvjeçare që nga fillimi i pandemisë, në këtë komunë janë regjistruar 648 biznese të reja dhe janë mbyllur 54 biznese, ndërsa ka tendencë për rritje të numrit të bizneseve të mbyllura.



Aranzhimet ekonomike të qeverisë

Zyrtarët komunalë vlerësojnë se gjatë periudhës së pandemisë ka pasur informim dhe konsultim të ndërsjellë në nivel qendror-lokal, ndonëse nuk ka pasur komisione të formuara ndërmjet zyrtarëve qendrorë dhe lokalë. Sipas të dhënave të nxjerra nga ky hulumtim, për periudhën 2020 - 2021 nuk ka pasur hartim të rregulloreve të reja apo ndryshim të rregulloreve ekzistuese.



Tregu i punës

Të dhënat tregojnë se si në shumicën e komunave të tjera të vogla në Kosovë, edhe këtu sektori privat ka qenë më i prekur nga kriza e pandemisë. Gastronomia, ndërtimtaria, transporti dhe kopshtet private mbeten disa nga sektorët më të dëmtuar. Sipas zyrtarëve komunalë, pandemia ka ndikuar negativisht në shkallën e papunësisë deri në -30%, ndërsa ndikimin më të madh negativ, rreth -30%, e ka sidomos papunësia e grave dhe të rinjve. Sipas të dhënave në bizneset individuale dhe të vogla nuk ka largime nga puna, pasi mbizotëron punësimi familjar, por në bizneset e tjera, ka largime nga puna në një shkallë të ulët prej 20% dhe padyshim që mbyllja e bizneseve ka ndikuar në rënien e numri i të të punsuarve.



Mjedisi financiar

Bazuar në të dhënat e hulumtimit, komuna e Fushë Kosovës gjatë vitit të parë të pandemisë ka shënuar rënie të të hyrave vetanake. Krahasuar me vitin 2019, në vitin 2020 vërehet një rënie prej -11.7%. Ndërsa në vitin 2021 shënohet një rritje prej 50.4%. Ngjashëm ka qenë edhe me të hyrat tatimore, ku në vitin 2020 krahasuar me vitin 2019 ka pasur rënie në -20.2%, ndërsa në vitin 2021 ka një rritje prej 59.2%.



Infrastruktura, shërbimet bazike dhe lidhshmëria

Sipas zyrtarëve komunalë, Shtabi Emergjent Komunal ka trajtuar dhe ndihmuar të gjitha familjet në nevojë (duke i dhënë përparësi komuniteteve pakicë dhe familjeve me ndihmë sociale), si dhe ka ofruar kujdes shëndetësor dhe social për të gjithë individët e prekur nga COVID-19. Përveç kësaj, komuna ka siguruar furnizimin e QKMF-së me pajisje mbrojtëse (maska, doreza, dezinfektues, veshje mbrojtëse etj.), dezinfektimin e objekteve publike-institucioneve, objekteve kolektive, hyrjeve të banesave, objekteve afariste, dezinfektimin e rrugëve dhe pastrimin e rrugëve, furnizimin dhe shpërndarjen e pakove ushqimore, mjeteve higjieno-sanitare dhe miellit për të gjithë të prekurit dhe familjet me gjendje të rëndë ekonomike dhe sociale. Në komunën e Fushë Kosovës si dhe në mbarë Kosovën, sistemi arsimor ka funksionuar në tre skenarë, varësisht nga situata e pandemisë.

Dimensionet	Gjetjet kryesore
Mjedisi i biznesit	Shënoi një rënie prej 50% të aktiviteteve ekonomike gjatë muajve të parë mars-prill-maj të vitit 2020, duke filluar me një rritje të vogël gjatë gjithë vitit 2020, ndërsa në vitin 2021 një ngritje dhe stabilitet optimal. Për periudhën dyvjeçare që nga fillimi i pandemisë janë mbyllur 54 biznese.
Aranzhimet ekonomike të qeverisë	Mekanizmat e bashkëpunimit në nivel lokal dhe qendror kanë qenë informimi dhe konsultimi i ndërsjellë.
Tregu i punës	Sektori privat është prekur më së shumti nga kriza pandemike. Sektorët e gastronomisë, ndërtimitarisë, transportit dhe kopshteve private mbeten sektorët më të dëmtuar gjatë kësaj periudhe.
Mjedisi financiar	Gjatë vitit 2020 ka pasur rënie në të hyrat vetanake dhe tatimore krahasuar me vitin paraprak, por këto janë rritur në vitin 2021.
Infrastruktura, shërbimet bazike dhe lidhshmëria	Shërbimet shëndetësore, grumbullimi i mbetjeve, uji i pijshëm, sanitar dhe transporti kanë qenë në nivel të kënaqshëm, ndërkohë që sistemi arsimor ka funksionuar në tre skenarë në varësi të situatës pandemike.



Reagimi ndaj krizës dhe masat e rimëkëmbjes

Sa i përket masave afatmesme të rimëkëmbjes, sipas zyrtarëve komunalë, Qeveria e Kosovës ka mbështetur Komunën e Fushë Kosovës me shumën e mjeteve prej 1.103.114 euro. Këto fonde u ndanë për të parandaluar shpërndarjen e pandemisë Covid-19. Përveç shëndetit publik, këto fonde i dedikohen edhe fushave të arsimit, mirëqenies sociale dhe higjienës publike. Për ndihmën ekonomike dhe zhvillimin e bizneseve që kanë pësuar humbje gjatë kësaj kohe, komuna ndau shumën prej 308 mijë eurosh, duke ndihmuar me mjete financiare 598 biznese të ndryshme, si rrobaqepësi, parukeri, sallone të bukurisë, çerdhe-kopshte etj. Komuna e Fushë Kosovës nuk ka zhvilluar asnjë plan për masat e rimëkëmbjes afatgjatë dhe është e varur vetëm nga plani i qeverisë për rimëkëmbjen ekonomike i cili është miratuar në vitin 2021.

Në vend të përfundimeve



Komuna e Fushë Kosovës nuk ka një masë afatgjatë për rimëkëmbje nga pasojat e pandemisë COVID-19. Si sfida është theksuar mungesa e një plani paraprak për menaxhimin e pandemisë Covid-19. Sipas zyrtarëve të komunalë, pasojat e situatës do të ndihen edhe për disa vite në vijim. Pa ndihmën e qeverisë, ndihma ekonomike për bizneset vendase është një sfida serioze për Komunën.

Komuna e Gjakovës



Profili i komunës

Në komunën e Gjakovës rastet e para të infektuara me COVID-19 janë shfaqur në muajin mars të vitit 2020. Ndërsa për shifrat e sakta të të identifikuarve, të shëruarve dhe atyre që kanë rezultuar me vdekje deri në muajin dhjetor të vitit 2021, zyrtarët e kësaj komune kanë këshilluar t'i referohen të dhënave të IKSHPK-së. Me fillimin e pandemisë u aktivizua "Shtabi i Emergjencave Komunale", në të cilin përveç përfaqësuesve të sigurisë, u përfshinë edhe akterët kryesorë shëndetësorë për të menaxhuar sa më mirë situatën me COVID 19.



Ndikimet kryesore ekonomike dhe financiare

Komuna e Gjakovës edhe para krizës pandemike u përball me një situatë të vështirë ekonomike dhe sociale. Disa nga sfidat më të mëdha të kësaj komune janë numri i madh i të papunëve, buxheti i kufizuar i komunës për investime të nevojshme, infrastruktura e amortizuar etj.



Mjedisi i biznesit

Bazuar në të dhënat e hulumtimit nga kjo komunë, ekonomia lokale dominohet nga bizneset individuale dhe mikro të cilat janë goditur nga situata e pandemisë. Sipas zyrtarëve komunalë, pandemia ka ndikuar negativisht në mbylljen e bizneseve deri në -5%, por kjo nuk ka ndikuar në uljen e veprimtarisë ekonomike. Që nga fillimi i periudhës së pandemisë, në këtë komunë janë mbyllur gjithsej 152 biznese (68 prej tyre janë mbyllur në vitin 2020 dhe 84 biznese në vitin 2021). Megjithatë, shifra të përafërta ishin të pranishme për mbylljen e bizneseve edhe para situatës së pandemisë (98 biznese të mbyllura në vitin 2019).



Aranzimet ekonomike të qeverisë

Zyrtarët komunal raportuan për mungesë komunikimi ndërmjet nivelit lokal dhe atij qendror. Ndonjëherë masat e marra nga niveli qendror nuk ishin të koordinuara me situatën 'de-facto' në nivel lokal. Në shumë raste janë futur masa parandaluese/kufizuese ndërkohë që Komuna nuk ka qenë e përgatitur për t'i zbatuar apo monitoruar.



Tregu i punës

Nga të dhënat për këtë komunë, vlerësohet se ndikimi negativ në punësim është i theksuar kryesisht në sektorin e gastronomisë, veçanërisht për shkak të pandemisë. Sipas zyrtarëve komunalë, pandemia ka ndikuar negativisht në shkallën e papunësisë deri në -5%. Ndërsa sektorët e prodhimit si përpunimi i tekstitit, metalit, drurit, si dhe sektori i ndërtimtarisë, kanë rezultuar me ecuri pozitive për shkak të hapjes së disa kompanive të reja private. Përveç sektorit publik (përkatësisht sektorit të arsimit dhe shëndetësisë), të gjithë sektorët e tjerë të ekonomisë lokale rezultojnë me pjesëmarrje të pabarabartë në punësim për sa i përket gjinisë, ndërkohë që kanë një ekuilibër në nivelin e pagave. Sektori i TIsë është vendi ku theksohet hendeku më i lartë gjinor, ku gratë përfaqësohen 5.5 herë më pak. Nga ana tjetër, ndikimi që ka pasur pandemia në kushtet e punës është vlerësuar pozitivisht si pagat dhe orët e punës rreth 10%.



Mjedisi financiar

Të dhënat e mbledhura për qëllime të këtij studimi tregojnë se në komunën e Gjakovës, gjatë vitit 2020, të hyrat vetanake dhe tati-more janë zvogëluar në krahasim me vitin paraprak. Megjithatë, mbledhja e këtyre të hyrave është rritur në vitin 2021. Gjatë periudhës së pandemisë zyrtarët komunalë kanë raportuar rritje të buxhetit për subvencione dhe donacione nga donatorët e jashtëm.



Infrastruktura, shërbimet bazike dhe lidhshmëria

Gjatë periudhës së pandemisë, ka pasur një rritje të shërbimeve apo mbështetjes për familjet në nevojë. Kjo u arrit në bashkëpunim të ngushtë me organizatat humanitare të cilat ofruan pako ushqimore dhe strehim për familjet në nevojë. Përmes bashkë-financimit me Ndërmarrjen Rajonale të Ujësjellësit “Gjakova”, është siguruar qasja në ujë të pijshëm për fshatrat e Komunës së Gjakovës. Megjithatë, ka ende një numër fshatrash që nuk përfshihen në sistem. Gjatë dy viteve të fundit, mbulimi me shërbimin e grumbullimit të mbeturinave në këtë bashki është rritur nga 60% në 100% të territorit të komunës.

Dimensionet	Gjetjet kryesore
Mjedisi i biznesit	Që nga viti 2020, në këtë komunë janë mbyllur gjithsej 152 biznese, por pothuajse e njëjta gjë vlen edhe para periudhës së pandemisë (98 biznese të mbyllura në vitin 2019).
Aranzimet ekonomike të qeverisë	Ka pasur mungesë komunikimi në nivel lokal dhe qendror, masat e marra nga niveli qendror nuk ishin të koordinuara me autoritetet lokale.
Tregu i punës	Ndikimi negativ në punësim është theksuar kryesisht në sektorin e gastronomisë, ndërsa sektorët prodhues si përpunimi i tekstilit, metalit, drurit, si dhe sektori i ndërtimeve, kanë rezultuar me ecure pozitive për shkak të hapjes së disa kompanive të reja private.
Mjedisi financiar	Gjatë vitit 2020 ka pasur rënie të të hyrave vetanake dhe tatimore në krahasim me vitin paraprak, por më pas është shënuar rritje në vitin 2021.
Infrastruktura, shërbimet bazike dhe lidhshmëria	Shërbimet e kujdesit shëndetësor, grumbullimit të mbeturinave, ujit të pijshëm dhe sanitare ishin përgjithësisht në nivel të kënaqshëm. Megjithatë, disa nga zonat rurale u prekën veçanërisht kur bëhet fjalë për shërbimet e ujit të pijshëm.



Reagimi ndaj krizës dhe masat e rimëkëmbjes


Komuna e Gjakovës nuk ka hartuar masa specifike për rimëkëmbje. Sipas zyrtarëve komunalë, vetëm në vitin 2020 është krijuar një fond i posaçëm prej 200 mijë eurosh për subvencionimin e bizneseve të prekura nga pandemia, masat lehtësuese për bizneset (heqje apo shtyrje të tatimeve dhe tarifave komunale, ndalime të dëbimit të bizneseve nga lokalet me qira, etj.), ngritja dhe zgjerimi i objekteve publike (ndihma financiare dhe teknike) për të siguruar ose lehtësuar qasjen në kapital të lirë për bizneset.

Në vend të përfundimeve



Sipas zyrtarëve komunalë, kjo komunë nuk ka kapacitet të ndikojë në rimëkëmbjen afatgjatë, sipas tyre kjo është përgjegjësi e pushtetit qendror. Sfidat që ka pasur komuna para pandemisë është çështja e papunësisë dhe e njëjta gjë ndiqet edhe në situatën e pandemisë.

Komuna e Gjilanit



Profili i komunës

Në komunën e Gjilanit rastet e para me COVID-19 janë shfaqur në muajin mars të vitit 2020 dhe prej atëherë deri në muajin dhjetor të vitit 2021 janë regjistruar 9878 raste, prej tyre janë shëruar 9673 persona, ndërsa 201 kanë rezultuar me vdekje. Për të koordinuar, menaxhuar dhe parandaluar përhapjen e pandemisë COVID-19, komuna ka ngritur Shtabin Emergjent. Përgjatë këtij mekanizmi janë marrë të gjitha masat mbrojtëse për parandalimin e përhapjes së pandemisë COVID-19 dhe në përputhje me Vendimet e MSH-së dhe IKSHPK-së.



Ndikimet kryesore ekonomike dhe financiare

Në komunën e Gjilanit, ndërprerja e aktiviteteve të përditshme ekonomike, arsimore, kulturore dhe sportive gjatë periudhës së pandemisë ka shkaktuar dëme të mëdha. Sektori ekonomik dhe konkretisht ai privat u përball me vështirësi të mëdha. Buxheti i kufizuar i komunës u përball me vështirësi edhe më të mëdha për shkak të krijimit të shpenzimeve të paplanifikuara për përballimin e pandemisë.



Mjedisi i biznesit

Ekonomia lokale në Gjilan dominohet nga bizneset individuale dhe ato mikro, të cilat janë goditur ndjeshëm për shkak të kufizimeve të urdhëruara nga institucionet kompetente. Sipas zyrarëve komunalë, pandemia ka ndikuar negativisht në mbylljen e bizneseve deri në -30% dhe ka ndikuar në uljen e veprimtarisë ekonomike deri në -50%. Të dhënat e siguruar nga kjo komunë tregojnë se në vitin 2020 janë regjistruar 502 biznese të reja me 798 të punësuar dhe janë mbyllur 81 biznese me 115 të punësuar, ndërkohë që ka tendencë të rritet numri i bizneseve të mbyllura dhe në vitin 2021 janë regjistruar 850 biznese si janë mbyllur të reja dhe 100 biznese me 150 punonjës. Shumica e bizneseve kanë deklaruar humbje të konsiderueshme, veçanërisht sektori i prodhimit, tregtisë dhe hotelerisë, i ndjekur nga ai i ndërtimtarisë.



Aranzhimet ekonomike të qeverisë

U zhvillua bashkëpunimi ndërmjet nivelit lokal dhe atij qendror, kryesisht në drejtim të shkëmbimit të informacionit dhe konsultimeve të ndërsjella. Gjatë pandemisë janë zhvilluar takime apo konsultime të ndërsjella me kryetarët e komunave të këtij rajoni për të informuar për situatën e përgjithshme me COVID-19, por edhe për t'i koordinuar veprimet e mëtejshme në mbështetje të menaxhimit të situatës dhe ruajtjes së shëndetit publik.



Tregu i punës

Bazuar në të dhënat e hulumtimit, në komunën e Gjilanit, pandemia ka ndikuar në humbjen e 788 vendeve të punës. Sipas të dhënave të marra nga zyrtarët komunalë, pandemia ka ndikuar negativisht në shkallën e papunësisë deri në -32%, ndërsa ndikimin më të madh negativ, rreth -48%, e ka sidomos papunësia e grave dhe të rinjve. Ndërsa, sipas bizneseve që operojnë në këtë komunë, pandemia ka ndikuar në rënien e kërkesës për shërbime/produkte por ka pasur edhe ndërprerje të furnizimit gjatë pandemisë.



Mjedisi financiar

Sipas përgjigjeve të zyrtarëve të komunës së Gjilanit, gjatë vitit të parë pandemik ka pasur rënie të të hyrave vetanake, ndërsa në vitin 2020 ka pasur rënie prej 12.4%, ndërsa në vitin 2021 kjo përqindje është rritur në 46.3%. Situata ka qenë e njejtë edhe me të hyrat tatimore, ku krahasuar me vitin 2019, në vitin 2020 ka pasur rënie deri në 18.8%.



Infrastruktura, shërbimet bazike dhe lidhshmëria

Sigurimi i ujit të pijshëm gjatë viteve 2020 dhe 2021 ka qenë në nivel të kënaqshëm, njëlloj si me menaxhimin e mbeturinave, këto janë shërbimet që nuk janë prekur nga situata pandemike. Zyrtarët komunalë deklaruan se shërbimet sociale i kanë ofruar si para pandemisë, kur ofrohet ndihmë për qytetarët, veçanërisht për ata që jetojnë në gjendje të keqe. Gjithashtu gjatë periudhës së pandemisë janë ofruar shërbime sanitare, duke përfshirë pastrimin dhe dezinfektimin e ndërtesave-institucioneve publike, hyrje-daljet e ndërtesave kolektive, larje të rregullta të rrugëve dhe shesheve etj. Të gjitha familjet dhe individët e prekur nga COVID-19 kanë pasur kujdes shëndetësor dhe social, disa janë pajisur edhe me paketa ushqimore-sanitare. Lidhur me shërbimin e transportit, zyrtarë komunalë deklaruan se ky shërbim gjatë periudhës së pandemisë ka hasur në vështirësi në funksionim për shkak të masave kundër COVID. Ndërsa sistemi arsimor ka funksionuar në tre skenarë në varësi të situatës së pandemisë.

Dimensionet	Gjetjet kryesore
Mjedisi i biznesit	Humbje të konsiderueshme kanë deklaruar shumica e bizneseve, veçanërisht sektori i prodhimit, tregtisë dhe hotelarisë. Në vitin 2020 janë mbyllur 81 biznese, ndërsa tendencë për rritje raportohet edhe gjatë vitit 2021.
Aranzimet ekonomike të qeverisë	Mekanizmat kryesorë të bashkëpunimit ndërmjet nivelit lokal dhe atij qendror janë raportuar se janë shkëmbimi i informacionit dhe konsultimet e ndërsjella.
Tregu i punës	Pandemia ndikoi në humbjen e 788 vendeve të punës në këtë komunë.
Mjedisi financiar	Krahasuar me vitin (-et) paraprak (e), gjatë vitit 2020 ka pasur rënie të të hyrave vetanake dhe tatimore. Megjithatë, të dhënat tregojnë se këto të ardhura janë rritur në vitin 2021.
Infrastruktura, shërbimet bazike dhe lidhshmëria	Shërbimet e kujdesit shëndetësor, grumbullimit të mbeturinave, ujit të pijshëm dhe sanitare kanë qenë në nivel të kënaqshëm, ndërsa sistemi arsimor ka funksionuar në tre skenarë, në varësi të situatës së pandemisë.



Reagimi ndaj krizës dhe masat e rimëkëmbjes

Bazuar në rekomandimet e ekipit për vlerësimin e dëmeve në ekonominë lokale, komuna e Gjilanit ka përgatitur një Program të masave afatgjata për të mbështetur bizneset që operojnë në këtë komunë duke i liruar të gjitha bizneset nga barra tatimore komunale për kryerjen e veprimtarisë dhe operimin në territorin e kësaj komune gjatë vitit 2020. Edhe bizneset janë të përjashtuara nga pagesa e tarifave për shfrytëzimin e parkingjeve të dhëna në përdorim nga komuna për një periudhë 6 mujore, domethënë për ata që nuk kanë ushtruar apo kryer veprimtarinë e tyre të rregullt me kërkesë të MSH-së, janë përjashtuar edhe nga pagesa e qirasë për një periudhë 12 mujore, përfshirë edhe qiramarrësit e tezgave të tregut të lëvizshëm për shitjen e produkteve bujqësore. Kur bëhet fjalë për fermerët, për një periudhë 12 mujore, subvencione janë dhënë edhe me farat e misrit dhe plehrat artificiale. Janë shtyrë për një periudhë 3 mujore pagesat e tarifave për legalizimin e objekteve pa leje për tatimpaguesit që kanë lidhur kontrata me pagesë dinamike me këste (sipas kërkesës). Nga zyrtarët komunalë raportohet se kamatat e borxheve nuk do të ngarkohen as për periudhën e caktuar. Gjatë periudhës së pandemisë, Qeveria e Kosovës e ka mbështetur këtë komunë me mjete financiare për vitin 2020 prej 446,948 € dhe për vitin 2021 në vlerë prej 493,984 €. Këto fonde u ndanë për ta parandaluar përhapjen e pandemisë COVID-19. Përveç fushës së shëndetit publik, këto mjete i dedikohen edhe qëllimeve arsimore, të mirëqenies sociale dhe higjienës publike. Ndërkaq, për zhvillimin e masave afatgjata, kjo komunë nuk planifikon të hartojë një program masash dhe sipas tyre, kjo duhet të jetë detyrë e nivelit qendror.

Në vend të përfundimeve



Periudha dyvjeçare e pandemisë ka shkaktuar dëme të shumta në Komunë, veçanërisht në sektorin privat të ekonomisë. Ndaj, sfida dhe fokus i komunës mbetet ndihma për rimëkëmbjen Ekonomike për bizneset lokale.

Komuna e Graçanicës



Profili i komunës

Komuna e Graçanicës, nuk ka ndarë informacione lidhur me numrin e pacientëve të identifikuar, të shëruar dhe të vdekur gjatë pandemisë COVID-19 në vitin 2020 dhe 2021. Megjithatë, gjetjet tregojnë se për t'i koordinuar dhe menaxhuar veprimet për parandalimin e përhapjes së pandemisë COVID-19, komuna ka ngritur Shtabin e Emergjencave, i cili mori të gjitha masat mbrojtëse për parandalimin e përhapjes së pandemisë COVID-19.



Ndikimet kryesore ekonomike dhe financiare

Komuna e Graçanicës, është një komunë e vogël rurale me rreth 10,000 banorë, me fokus zhvillimor në dy sektorë kryesorë; hotelerinë dhe gastronominë. Gjatë pandemisë, këta dy sektorë u prekën më së shumti, gjë që ndikoi njëkohësisht në rritjen e shkallës së papunësisë në këtë komunë. Po ashtu, kjo komunë është përballur me probleme siç janë investimet e pamjaftueshme në zhvillimin ekonomik lokal.



Mjedisi i biznesit

Të dhënat tregojnë se si në shumicën e komunave tjera të vogla në Kosovë, edhe këtu më së shumti i prekur mbetet sektori privat. Megjithatë, edhe pse zyrtarët e kësaj komune deklaruan se kriza pandemike ka ndikuar negativisht në zhvillimin e bizneseve, nuk kanë të dhëna zyrtare se sa prej tyre janë mbyllur gjatë kësaj periudhe. Por sipas zyrtarëve komunalë, pandemia kishte ndikuar në uljen e veprimtarisë ekonomike deri në -80%. Nga ana tjetër, është vlerësuar se pandemia ka ndikuar pozitivisht 100% në lehtësimin e procedurave për hapjen e bizneseve të reja.



Aranzimet ekonomike të qeverisë

Sipas zyrtarëve të kësaj komune, të gjitha institucionet lokale përgjegjëse për zbatimin e masave kundër COVID-19 në nivel lokal kanë treguar bashkëpunim të lartë. Kjo e lehtësoi procesin e përgjithshëm për operatorët ekonomikë në komunë dhe zhvillimin e tyre ekonomik.



Tregu i punës

Sipas të dhënave të hulumtimit, punësimi në këtë komunë ka rënë ndjeshëm gjatë pandemisë, ndërsa sektorët më të prekur janë sektorët e gastronomisë, hotelarisë dhe industrisë së shitjes me pakicë. Ngjashëm me situatën e bizneseve, komuna nuk ka të dhëna për numrin e punëkërkuësve apo atyre që kanë humbur punën gjatë kësaj periudhe. Sipas zyrtarëve komunalë, pandemia ka ndikuar negativisht në shkallën e papunësisë deri në -50%, ndërsa ndikimin më të madh negativ, rreth -50%, e ka sidomos papunësia e grave dhe të rinjve.



Mjedisi financiar

Sipas përgjigjeve të zyrtarëve të intervistuar të komunës së Graçanicës, pjesa më e madhe e buxhetit të kësaj komune përbëhet nga grantet qeveritare, dhe vetëm një përqindje e vogël e buxhetit komunal përbëhet nga të hyrat komunale. Gjatë vitit të parë të pandemisë, ka pasur një rënie të të hyrave vetanake dhe tatimore krahasuar me një vit më parë, por këto kanë shënuar një rritje të lehtë në vitin 2021 rreth 30%.



Infrastruktura, shërbimet bazike dhe lidhshmëria

Sigurimi i ujit të pijshëm ishte në nivel të kënaqshëm; në të vërtetë, ky u deklarua si një shërbim që nuk është prekur nga situata pandemike. Në mënyrë të ngjashme, menaxhimi i mbeturinave, kujdesi shëndetësor dhe shërbimet e transportit u raportuan gjithashtu si shërbime të ofruara në një nivel(e) të kënaqshëm. Të gjithë qytetarët e kësaj komune patën mundësinë të marrin shërbimet bazë në institucionet arsimore përmes mësimi online.

Dimensionet	Gjetjet kryesore
Mjedisi i biznesit	Më i prekuri është sektori privat, por nuk ka të dhëna zyrtare për numrin e bizneseve të mbyllura gjatë kësaj periudhe.
Aranzimet ekonomike të qeverisë	Komuna ka bashkëpunuar ngushtë me të gjitha institucionet lokale, por raportohet se ka mungesë të komunikimit të duhur me nivelin qendror.
Tregu i punës	Bazuar në shkallën e punësimit, sektorët më të prekur janë sektorët e gastronomisë, hotelarisë dhe industrisë së shitjes me pakicë.
Mjedisi financiar	Gjatë vitit 2020 ka rënie të të hyrave vetanake dhe tati-more, por të dhënat tregojnë rritje të lehta në këtë drejtim gjatë vitit 2021.
Infrastruktura, shërbimet bazike dhe lidhshmëria	Shërbimet shëndetësore, grumbullimi i mbeturinave, uji i pijshëm, shërbimet e sanitarisë dhe shërbimet e transportit raportohen të jenë në nivel të kënaqshëm.



Reagimi ndaj krizës dhe masat e rimëkëmbjes

Mbështetja e komunës është fokusuar kryesisht në dhënien e ndihmës për familjet më të rrezikuara, nëpërmjet sigurimit të mjeteve të nevojshme mjekësore, si dhe ushqimit dhe mjeteve thelbësore të funksionimit gjatë karantinës. Masa dhe lehtësime të ndryshme për sektorin ekonomik janë miratuar për ta stimuluar biznesin gjatë periudhës së krizës. Lirimi nga tatimet, përjashtimet nga qiraja komunale për të gjitha bizneset që operojnë në këtë komunë, mirëmbajtja dhe dezinfektimi i hapësirave dhe objekteve publike që përdoren për veprimtari biznesi formale dhe joformale (si rrugët, sheshet publike, tregjet komunale etj.), rregulloret për lehtësimin e regjistrimit dhe licencimit të bizneseve, etj., ishin disa nga masat e reagimit ndaj krizave të kësaj komune.

Në vend të përfundimeve



Komuna e Graçanicës ka miratuar një plan për menaxhimin e krizave. Sipas zyrtarëve të kësaj komune, në kuadër të planit të rimëkëmbjes, fokusi kryesor duhet të jetë mbështetja për sektorin e gastronomisë, si sektori kryesor që operon në këtë komunë.

Komuna e Hanit të Elezit



Profili i komunës

Në komunën e Hanit të Elezit nga rasti i parë me COVID-19 deri në vitin 2020 janë evidencuar 78 raste me COVID-19, nga të cilët janë shëruar 76 persona, ndërsa kanë regjistruar 2 të vdekur. Për të koordinuar dhe menaxhuar veprimet për parandalimin e përhapjes së pandemisë COVID-19, Komuna ka ngritur Shtabin e Emergjencës, i cili ka marrë të gjitha masat mbrojtëse për parandalimin e përhapjes së pandemisë COVID-19 në përputhje me Vendimet e MSH-së dhe IKSHPK-së.



Ndikimet kryesore ekonomike dhe financiare

Komuna e Hanit të Elezit edhe para pandemisë ballafaqej me shumë probleme ekonomike dhe sociale si papunësia e lartë, numri i madh i rasteve të familjeve me asistencë sociale dhe buxheti i vogël komunal.



Mjedisi i biznesit

Sipas zyrtarëve komunalë, gjatë pandemisë në komunën e Hanit të Elezit janë prekur pothuajse të gjithë sektorët e fushës së biznesit si gastronomia, ndërtimtaria, tregtia me pakicë, rrobaqepësia, sallonet e bukurisë etj. Nga kriza pandemike në këtë komunë janë mbyllur pesë biznese në sektorin e gastronomisë dhe biznese të tjera të vogla etj. Sipas zyrtarëve komunalë, pandemia ka ndikuar negativisht në mbylljen e bizneseve deri në -20% dhe ka ndikuar në uljen e veprimtarisë ekonomike deri në -41%. Nga ana tjetër, është vlerësuar se pandemia ka ndikuar pozitivisht deri në 80% në lehtësimin e procedurave për hapjen e bizneseve të reja.



Aranzhimet ekonomike të qeverisë

Sipas zyrtarëve komunalë të Hanit të Elezit, deri më tani ka pasur një bashkëpunim të mirë në nivel lokal dhe qendror, ndërsa lehtësues në këtë bashkëpunim vlerësohet të jetë AKK-ja. Sipas tyre, gjatë kësaj periudhe të pandemisë ka informacione dhe konsultime në baza mujore.



Tregu i punës

Sipas të dhënave të hulumtimit nga komuna e Hanit të Elezit, pasi që ekonomia lokale dominohet nga bizneset individuale, dhe mikrobizneset që janë goditur nga situata pandemike, sektorët që janë më të prekur në shkallë të punësimit janë gastronomia, ndërtimtaria, industria me pakicë, rrobaqepësitë, sallonet e bukurisë etj. Megjithatë, nuk ka të dhëna zyrtare për numrin e të punësuarve dhe punëkërkuessve gjatë periudhës së pandemisë. Por sipas zyrtarëve komunalë, pandemia ka ndikuar negativisht në pushimet nga puna deri në -30%.



Mjedisi financiar

Ngjashëm me komunat tjera, edhe në komunën e Hanit të Elezit ka pasur rënie të të hyrave vetanake dhe të hyrave tatimore në krahasim me vitin paraprak, deri në -30%, por këto më pas, sipas të dhënave të hulumtimit janë rritur në vitin 2021. Gjatë kësaj periudhe të pandemisë, deri në 40% është rritur edhe buxheti për subvencione dhe donacione nga donatorët e jashtëm.



Infrastruktura, shërbimet bazike dhe lidhshmëria

Për shërbimet e kujdesit shëndetësor, zonat rurale larg objekteve shëndetësore kanë qenë më të prekura gjatë pandemisë pasi shërbimet e transportit publik kanë qenë më të kufizuara gjatë kësaj periudhe dhe në shumicën e rasteve qytetarët janë detyruar ta përdorin transportin privat. Shërbimet e ujit gjatë periudhës së pandemisë janë ofruar për të gjithë banorët, por disa pjesë kryesisht zonat rurale kanë pasur shërbime të reduktuara. Ashtu si shërbimet sanitare, grumbullimi i mbeturinave ka qenë më problematik për banorët që jetojnë në zona të izoluar.

Dimensionet	Gjetjet kryesore
Mjedisi i biznesit	U prekën pothuajse të gjithë sektorët e fushës së biznesit, si gastronomia, ndërtimtaria, industria e shitjes me pakicë, rrobaqepësia, sallonet e bukurisë etj.
Aranzimet ekonomike të qeverisë	Mekanizmat e bashkëpunimit në nivel lokal dhe qendror kanë qenë informimi dhe konsultimi i ndërsjellë
Tregu i punës	Sektorët që preken më shumë për sa i përket shkallës së punësimit janë gastronomia, ndërtimtaria, industria e shitjes me pakicë, rrobaqepësia, sallonet e bukurisë etj.
Mjedisi financiar	Gjatë vitit 2020 ka pasur rënie të të hyrave vetanake dhe të të hyrave tatimore në krahasim me vitin paraprak, por këto më pas, sipas të dhënave të hulumtimit kanë shënuar rritje në vitin 2021.
Infrastruktura, shërbimet bazike dhe lidhshmëria	Shërbimet e kujdesit shëndetësor, grumbullim të mbeturinave, ujit të pijshëm, shërbimet sanitare dhe të transportit kanë qenë në nivel të kënaqshëm në zonat urbane, ndërsa disa zona rurale janë më të prekura.



Reagimi ndaj krizës dhe masat e rimëkëmbjes

Sipas të dhënave të hulumtimit, punësimi në këtë komunë ka rënë ndjeshëm gjatë pandemisë, ndërsa sektorët më të prekur janë sektorët e ndërtimit, përpunimit, industrisë së shitjes me pakicë dhe gastronomisë. Ngjashëm me situatën e bizneseve, komuna nuk ka të dhëna për numrin e punëkërkuarëve apo atyre që kanë humbur punën gjatë kësaj periudhe. Por, sipas zyrtarëve komunalë, pandemia ka ndikuar negativisht në shkallën e papunësisë deri në -60%, ndërsa ndikimin më të madh negativ, rreth -85%, e ka sidomos papunësia e grave dhe të rinjve.



Mjedisi financiar

Sipas përgjigjeve të zyrtarëve të komunës së Malishevës, gjatë vitit të parë të pandemisë ka pasur rënie të të hyrave vetanake dhe të hyrave tatimore në krahasim me vitin paraprak, por këto më pas, sipas të dhënave të hulumtimit, janë rritur në vitin 2021 afërsisht 85% nga burimet vetanake dhe 45% të ardhurat nga tatimet.



Infrastruktura, shërbimet bazike dhe lidhshmëria

Për sa i përket furnizimit me ujë të pijshëm gjatë viteve 2020 dhe 2021, ai ka qenë në nivel të kënaqshëm, shërbim ky që nuk është prekur nga situata e pandemisë, ngjashëm me atë të menaxhim të mbeturinave. Sa i përket shërbimeve të transportit, gjatë krizës së pandemisë ky shërbim ka qenë më i reduktuar për disa fshatra të zonave rurale të komunës. Gjithashtu, gjatë kësaj periudhe ka pasur rritje të numrit të kërkesave për ofrimin e shërbimeve të nevojshme sociale të ofruara nga Sektori i Shërbimeve Sociale. Të gjithë qytetarët e Malishevës kanë pasur mundësi të marrin shërbimet bazë në institucionet arsimore përmes mësimin online.

Dimensionet	Gjetjet kryesore
Mjedisi i biznesit	Sektorët më të prekur janë gastronomia, sektori i ndërtimitarisë, industria e përpunimit, industria e shitjes me pakicë etj.
Aranzimet ekonomike të qeverisë	Mekanizmat e bashkëpunimit në nivel lokal dhe qendror kanë qenë informimi dhe konsultimi i ndërsjellë.
Tregu i punës	Sektorët më të prekur janë sektorët e ndërtimitarisë, prodhimit, shitjes me pakicë dhe gastronomisë.
Mjedisi financiar	Gjatë vitit 2020 ka pasur rënie të të hyrave vetanake dhe të të hyrave tatimore krahasuar me vitin paraprak, por këto më pas, sipas të dhënave të hulumtimit, kanë shënuar rritje në vitin 2021.
Infrastruktura, shërbimet bazike dhe lidhshmëria	Shërbimet e kujdesit shëndetësor, ujit të pijshëm, grumbullimit të mbeturinave dhe s sanitare kanë qenë në nivel të kënaqshëm në zonën urbane, ndërsa sa i përket transportit disa zona rurale janë më të prekura.



Reagimi ndaj krizës dhe masat e rimëkëmbjes

Mbështetja e komunës në aspektin e bizneseve është fokusuar kryesisht në vendimin për lirimin nga tatimet dhe qiraja komunale të bizneseve për të gjitha bizneset që operojnë në këtë komunë, mirëmbajtjen dhe dezinfektimin e hapësirave publike dhe objekteve që përdoren për aktivitete biznesi formale dhe joformale (si p.sh., rrugët, sheshet publike, tregjet komunale, etj.), mbështetje e synuar në formën e granteve ose asistencës teknike për t'i mbështetur inovacionet për reagimin dhe rimëkëmbjen nga COVID-19 etj.

Në vend të përfundimeve



Komuna e Malishevës ka hartuar një plan për rimëkëmbjen ekonomike, por nuk ka mjete të mjaftueshme për zbatim pa ndihmën e nivelit qendror. Sipas zyrtarëve të komunës, në kuadër të planit të rimëkëmbjes synohet të luftohet informaliteti në ekonomi.

Komuna e Mamushës



Profili i komunës

Komuna e Mamushës nuk ka dhënë informacione lidhur me numrin e pacientëve të identifikuar, të shëruar dhe të vdekur nga pandemia COVID-19 gjatë viteve 2020 dhe 2021. Për t'i koordinuar dhe menaxhuar veprimet për parandalimin e përhapjes së pandemisë COVID-19, Komuna ka krijuar Shtabin Emergjent, i cili ka marrë të gjitha masat mbrojtëse për parandalimin e përhapjes së pandemisë COVID-19 në përputhje me Vendimet e MSH-së dhe ISH-PK-së.



Ndikimet kryesore ekonomike dhe financiare

Duke qenë një komunë shumë e vogël si për nga territori ashtu edhe për nga numri i banorëve, në Komunën e Mamushës, veprimtaria ekonomike është kryesisht bujqësor, ku shumica dërrmuese e banorëve janë të punësuar. Edhe para pandemisë kjo komunë kishte një numër shumë të vogël të investimeve për shkak të buxhetit të vogël komunal.



Mjedisi i biznesit

Duke qenë se ekonomia e kësaj komune është kryesisht e varur nga sektori i bujqësisë, kriza e pandemisë dhe masat kundër COVID-19 i kanë penguar fermerët të zhvillojnë punën e tyre bujqësore dhe të shesin prodhimet e tyre bujqësore. Ndonëse zyrtarët e kësaj komune thonë se kriza e pandemisë ka ndikuar negativisht në zhvillimin e bizneseve të tjera, nuk kanë të dhëna zyrtare se sa biznese janë mbyllur gjatë kësaj periudhe. Por bazuar në të dhënat e hulumtimit, pandemia ka ndikuar negativisht në mbylljen e bizneseve deri në -40%.



Aranzhimet ekonomike të qeverisë

Mekanizmat e bashkëpunimit në nivel lokal dhe qendror kanë qenë informimi dhe konsultimi i ndërsjellë. Gjithashtu, sipas zyrtarëve komunalë, kjo komunë ka mbajtur takime me nivelin qendror lidhur me bashkëpunimin e nivelit lokal dhe atij qendror për masat që do të ndërmerren, për të mbështetur menaxhimin e situatës dhe ruajtjen e shëndetit publik.



Tregu i punës

Sipas të dhënave të hulumtimit, punësimi në këtë komunë ka rënë ndjeshëm gjatë pandemisë, ndërsa sektori më i prekur është bujqësia. Ngjashëm me situatën e bizneseve, komuna nuk ka të dhëna për numrin e punëkërkuësve apo atyre që kanë humbur punën gjatë kësaj periudhe por sipas zyrtarëve komunalë, pandemia ka ndikuar negativisht në shkallën e papunësisë deri në -30%, ndërsa ndikimin më të madh negativ, rreth -80%, e ka sidomos papunësia e femrave.



Mjedisi financiar

Sipas përgjigjeve të zyrtarëve të komunës së Mamushës gjatë vitit të parë të pandemisë ka pasur rënie të të hyrave vetanake dhe të hyrave tatimore në krahasim me vitin paraprak, por këto më pas, sipas të dhënave të hulumtimit, janë rritur në vitin 2021. Ashtu si shumica e komunave në Kosovë, buxheti i kësaj komune përbëhet kryesisht nga grantet qeveritare.



Infrastruktura, shërbimet bazike dhe lidhshmëria

Për sa i përket furnizimit me ujë të pijshëm gjatë viteve 2020 dhe 2021 ai ka qenë në nivel të kënaqshëm, shërbim ky që nuk është prekur nga situata e pandemisë, ngjashëm me atë të menaxhimit të mbeturinave. Gjatë kohës së pandemisë, ata kanë pasur ulje të ndjeshme të kohës së udhëtimit, në periudha të tjera nuk ka ndikuar në transportin dhe mobilitetin, e për pasojë nuk ka pasur zona të prekura. Gjithashtu, gjatë kësaj periudhe ka pasur rritje të numrit të kërkesave për ofrimin e shërbimeve të nevojshme sociale të ofruara nga Sektori i Shërbimeve Sociale. Të gjithë qytetarët e Mamushës kanë pasur mundësi t'i marrin shërbimet bazë në institucionet arsimore përmes mësimit online.

Dimensionet	Gjetjet kryesore
Mjedisi i biznesit	Sektori më i prekur është sektori i bujqësisë.
Aranzhimet ekonomike të qeverisë	Mekanizmat e bashkëpunimit në nivel lokal dhe qendror kanë qenë informimi dhe konsultimi i ndërsjellë.
Tregu i punës	Punësimi në këtë komunë ka rënë ndjeshëm gjatë pandemisë, ndërsa sektori më i prekur është bujqësia.
Mjedisi financiar	Gjatë vitit 2020 ka pasur rënie të të hyrave vetanake dhe të të hyrave tatimore krahasuar me vitin paraprak, por këto më pas, sipas të dhënave të hulumtimit, kanë shënuar rritje në vitin 2021.
Infrastruktura, shërbimet bazike dhe lidhshmëria	Shërbimet e kujdesit shëndetësor, ujit të pijshëm, grumbullimit të mbeturinave dhe ato sanitare kanë qenë në nivel të kënaqshëm në zonën urbane, ndërsa sa i përket transportit disa zona rurale janë më të prekura.



Reagimi ndaj krizës dhe masat e rimëkëmbjes

Mbështetja e komunës në aspektin e bizneseve është fokusuar kryesisht në vendimin për lirimin nga tatimet dhe qiraja komunale të bizneseve për të gjitha bizneset që operojnë në këtë komunë, mirëmbajtjen dhe dezinfektimin e hapësirave publike dhe objekteve që përdoren për aktivitete biznesi formale dhe joformale (si p.sh. rrugët, sheshet publike, tregjet komunale, etj.), partneritetet e reja publiko-private në sektorë kritikë ekonomikë etj.

Në vend të përfundimeve




Komuna e Mamushës nuk ka hartuar plan për rimëkëmbjen ekonomike, për shkak të buxhetit të kufizuar që ka si komunë. Kriza e pandemisë ka shkaktuar dëme të mëdha në aktivitetin ekonomik në këtë komunë.





Komuna e Mitrovicës së Jugut



Profili i komunës

Në komunën e Mitrovicës së Jugut, nga rasti i parë me COVID-19 në muajin mars të vitit 2020 deri në muajin dhjetor të vitit 2021, janë identifikuar 7974 raste me COVID-19, prej të cilave 7816 janë shëruar, dhe 158 kanë rezultuar me vdekje. Për t'i koordinuar dhe menaxhuar veprimet për parandalimin e përhapjes së pandemisë COVID-19, komuna ka krijuar Shtabin Emergjent, i cili ka marrë të gjitha masat mbrojtëse për parandalimin e përhapjes së pandemisë COVID-19 në përputhje me vendimet e MSH-së dhe IKSHPK-së.



Ndikimet kryesore ekonomike dhe financiare

Komuna e Mitrovicës së Jugut edhe para krizës së pandemisë u përball me një situatë të vështirë ekonomike dhe sociale. Dy nga sfidat më të mëdha të kësaj komune janë numri i madh i të papunëve dhe numri i madh i përfituesve të skemës sociale që nuk përputhet me kapacitetet financiare të komunës.



Mjedisi i biznesit

Sipas të dhënave të hulumtimit nga komuna e Mitrovicës së Jugut, ekonomia lokale dominohet nga bizneset individuale, dhe mikro-bizneset të cilat janë goditur nga situata e pandemisë. Sektorët më të prekur nga situata pandemike në këtë komunë janë kryesisht ai i gastronomisë, industrisë së shitjes me pakicë, bujqësisë, salloneve të bukurisë etj. Nga të dhënat e marra nga zyrtarët komunalë, pandemia ka ndikuar negativisht në mbylljen e bizneseve deri në -4% dhe ndikoi në uljen e veprimtarisë ekonomike deri në -30%. Nga ana tjetër, është vlerësuar se pandemia ka ndikuar pozitivisht deri në 20% në lehtësimin e procedurave për hapjen e bizneseve të reja.



Aranzhimet ekonomike të qeverisë

Koordinimi ndërmjet nivelit qendror dhe atij lokal është bërë i dukshëm për të siguruar përgjigje efektive gjatë menaxhimit të krizave. Komuna ka luajtur rol vendimtar në zbatimin e masave të shëndetit publik si: zbatimi i politikave të izolimit, kujdesi për popullatën në nevojë, komunikimi në krizë, sigurimi i rendit dhe sigurisë publike. Komuna ka bashkëpunuar ngushtë me nivelin qendror, përkatësisht me Ministrinë e Shëndetësisë për hapat e ndërmarrë.



Tregu i punës

Sipas vlerësimeve të zyrtarëve komunalë, sektorët që janë më të prekur në shkallë të punësimit janë sektori i gastronomisë, industrisë së shitjes me pakicë dhe shërbimeve. Sipas Zyrës së Punësimit në këtë komunë, shkalla e rregullt e punësimit për vitin 2020 ka qenë -53,2% krahasuar me vitin 2019. Sipas kësaj zyre, në shkallën e punësimit për vitin 2020 femrat kanë marrë pjesë me 43,2% ndërsa meshkujt me 56,8%, por sipas zyrtarëve komunal, pandemia ka ndikuar negativisht në shkallën e papunësisë së grave deri në -45%.



Mjedisi financiar

Ngjashëm me komunat tjera, edhe në komunën e Mitrovicës së Jugut gjatë vitit 2020 ka pasur rënie të të hyrave vetanake dhe të hyrave tatimore në krahasim me vitin paraprak, por më pas, sipas të dhënave të hulumtimit, të hyrat vetanake janë rritur deri në 20% në vitin 2021. Gjatë kësaj periudhe të pandemisë është rritur edhe buxheti për subvencione dhe donacione nga donatorë të jashtëm.



Infrastruktura, shërbimet bazike dhe lidhshmëria

Nuk ka pasur probleme me shërbimin e ujit të pijshëm gjatë pandemisë, por ka disa fshatra që nuk kanë qasje në rrjetin rajonal të ujësjellësit "Mitrovica". Gjatë gjithë periudhës së pandemisë, shërbimet sanitare janë rritur edhe më shumë. Në periudhën e pandemisë, komuna është kujdesur për rritjen e shërbimeve shëndetësore në fshatrat më të epërme, për vaksinimin e komunitetit rom etj. Duke qenë se komuna ka numrin më të madh të përfituesve të skemës sociale, komuna është përpjekur t'i ndihmojë këto rastet me pako ushqimore, shërbime sanitare etj. Për sa i përket grumbullimit të mbeturinave, kompania punoi me kapacitet të plotë dhe u përpoq të rriste shërbimin e tyre. Ndërsa në shërbimet e transportit, për shkak të masave kundër COVID-19 disa nga zonat rurale janë prekur më shumë.

Dimensionet	Gjetjet kryesore
Mjedisi i biznesit	Sektorët më të prekur nga situata e pandemisë në këtë komunë janë kryesisht ai i gastronomisë, industrisë së shites me pakicë, bujqësisë, salloneve të bukurisë etj.
Aranzimet ekonomike të qeverisë	Komuna ka bashkëpunuar ngushtë me nivelin qendror, përkatësisht me Ministrinë e Shëndetësisë për hapat e ndërmarrë
Tregu i punës	Shkalla e rregullt e punësimit për vitin 2020 ka qenë -53,2% krahasuar me vitin 2019. Ndërsa, në shkallën e punësimit për vitin 2020 femrat kanë marrë pjesë me 43,2% dhe meshkujt me 56,8%.
Mjedisi financiar	Gjatë vitit 2020 ka pasur rënie të të hyrave vetanake dhe të të hyrave tatimore krahasuar me vitin paraprak, por këto më pas, sipas të dhënave të hulumtimit kanë shënuar rritje në vitin 2021.
Infrastruktura, shërbimet bazike dhe lidhshmëria	Shërbimet e kujdesit shëndetësor, grumbullimit të mbeturinave, ujit të pijshëm dhe ato sanitare kanë qenë në nivel të kënaqshëm, ndërsa për ujin e pijshëm dhe shërbimet e transportit, disa nga zonat rurale kanë qenë më të prekura.



Reagimi ndaj krizës dhe masat e rimëkëmbjes


Nisur nga kapacitetet financiare, komuna ka ndërmarrë disa masa lehtësuese për qytetarët dhe biznesin, si masat lehtësuese për bizneset (heqje apo shtyrje të tatimeve dhe tarifave komunale, ndalimi i dëbimit të bizneseve nga lokalet me qira etj.), rregulloret për lehtësimin e regjistrimit dhe licencimit të biznesit, ndihma ushqimore dhe higjienike për të prekurit nga COVID-19, subvencioni për të gjithë të prekurit nga COVID-19 në shumën 50€, subvencioni për të gjitha nënat që kanë lindur gjatë kësaj periudhe në shumën 100€ etj. Komuna nuk ka hartuar një plan afatgjatë për rimëkëmbje dhe nuk ka informacione nëse ata synojnë të hartojnë një plan të tillë në të ardhmen.

Në vend të përfundimeve



Duke qenë se komuna u përball me një situatë të vështirë ekonomike, kriza e pandemisë e ka rënduar edhe më shumë atë. Sektori privat dhe bizneset e vogla janë më të prekurat.

Komuna e Mitrovicës së Veriut



Profili i komunës

Komuna e Mitrovicës së Veriut nuk ka dhënë informacione lidhur me numrin e pacientëve të identifikuar, të shëruar dhe të vdekur nga pandemia COVID-19 gjatë viteve 2020 dhe 2021. Për t'i koordinuar dhe menaxhuar veprimet për parandalimin e përhapjes së pandemisë COVID-19, komuna ka ngritur Shtabin Emergjent, i cili ka marrë të gjitha masat mbrojtëse për parandalimin e përhapjes së pandemisë COVID-19.



Ndikimet kryesore ekonomike dhe financiare

Si komunë e vogël, Mitrovica e Veriut, edhe para pandemisë, përballej me shkallë të lartë të papunësisë dhe zhvillim të dobët ekonomik. Dy nga sektorët më të zhvilluar të kësaj komune, gastronomia dhe industria e shitjes me pakicë, janë prekur më së shumti gjatë pandemisë, gjë që ka ndikuar edhe në rritjen e shkallës së papunësisë në këtë komunë.



Mjedisi i biznesit

Të dhënat tregojnë se si në shumicën e komunave të tjera të vogla në Kosovë, edhe në këtë komunë më i prekur është sektori privat dhe sektorët si ndërtimtaria, bujqësia, gastronomia dhe industria e shitjes me pakicë. Ndonëse zyrtarët e kësaj komune thonë se kriza e pandemisë ka ndikuar negativisht në zhvillimin e bizneseve të tjera, nuk kanë të dhëna zyrtare se sa biznese janë mbyllur gjatë kësaj periudhe.



Aranzhimet ekonomike të qeverisë

Sipas zyrtarëve të kësaj komune, të gjitha institucionet lokale përgjegjëse për zbatimin e masave kundër COVID-19 në nivel lokal kanë treguar bashkëpunim të lartë. Ky bashkëpunim ka lehtësuar punën për operatorët ekonomikë në komunë dhe zhvillimin e tyre ekonomik.



Tregu i punës

Sipas të dhënave të hulumtimit, punësimi në këtë komunë ka rënë ndjeshëm gjatë pandemisë, ndërsa sektorët më të prekur janë sektorët e ndërtimit, bujqësisë, gastronomisë dhe industrisë së shitjes me pakicë. Ngjashëm me situatën e bizneseve, komuna nuk ka të dhëna për numrin e punëkërkuesve apo atyre që kanë humbur punën gjatë kësaj periudhe.



Mjedisi financiar

Sipas përgjigjeve të zyrtarëve të komunës së Mitrovicës së Veriut, pjesa më e madhe e buxhetit të kësaj komune përbëhet nga grantet qeveritare dhe vetëm një përqindje e vogël e buxhetit komunal përbëhet nga të hyrat komunale.



Infrastruktura, shërbimet bazike dhe lidhshmëria

Për sa i përket ofrimit të ujit të pijshëm, ai ka qenë në nivel të kënaqshëm, shërbim ky që nuk është prekur nga situata e pandemisë, ngjashëm me atë të menaxhimit të mbeturinave. Sa i përket shërbimeve të transportit, zonat rurale janë më të prekura. Gjithashtu, gjatë kësaj periudhe ka pasur rritje të numrit të kërkesave për ofrimin e shërbimeve të nevojshme sociale të ofruara nga Sektori i Shërbimeve Sociale. Të gjithë qytetarët e kësaj komune kanë pasur mundësi t'i marrin shërbimet bazë në institucionet arsimore përmes mësimin online.

Dimensionet	Gjetjet kryesore
Mjedisi i biznesit	Më i prekuri është sektori privat dhe sektorët si ndërtimtaria, bujqësia, gastronomia dhe industria e shitjes me pakicë.
Aranzimet ekonomike të qeverisë	Bashkëpunim me të gjitha komunat e veriut të Kosovës, dhe me të gjitha institucionet lokale, por ka munguar komunikimi me nivelin qendror.
Tregu i punës	Sektorët më të prekur janë sektorët e ndërtimtarisë, bujqësisë, gastronomisë dhe industrisë së shitjes me pakicë.
Mjedisi financiar	Gjatë vitit 2020 ka pasur rënie të të hyrave vetanake dhe të të hyrave tatimore krahasuar me vitin paraprak, por këto më pas, sipas të dhënave të hulumtimit, kanë shënuar rritje në vitin 2021.
Infrastruktura, shërbimet bazike dhe lidhshmëria	Shërbimet e kujdesit shëndetësor, ujit të pijshëm, grumbullimit të mbeturinave dhe ato sanitare kanë qenë në nivel të kënaqshëm në zonën urbane, ndërsa sa i përket transportit disa zona rurale janë më të prekura.



Reagimi ndaj krizës dhe masat e rimëkëmbjes

Mbështetja e komunës është e përqendruar kryesisht në dhënien e ndihmës për shtresat më të rrezikuara të popullsisë përmes ofrimit të mjeteve dhe barnave të nevojshme mjekësore, ushqimit dhe mjeteve thelbësore të funksionimit gjatë karantinës. Janë miratuar masa dhe lehtësime të ndryshme për sektorin ekonomik për të stimuluar biznesin e tij në një periudhë krize si vendimi për lirim nga tatimet dhe qiraja komunale të bizneseve për të gjitha bizneset që operojnë në këtë komunë, mirëmbajtja dhe dezinfektimi i hapësirave publike dhe objekteve që përdoren për aktivitete biznesi formale dhe joformale (si rrugët, sheshet publike, tregjet komunale, etj.).

Në vend të përfundimeve



Komuna e Mitrovicës së Veriut as nuk ka miratuar plan për menaxhimin e krizave dhe as nuk ka hartuar plan afatgjatë për rimëkëmbje. Sipas zyrtarëve të kësaj komune, në kuadër të planit për rimëkëmbje, fokusi kryesor duhet të jetë mbështetja për sektorin e gastronomisë, si sektori kryesor që operon në këtë komunë.

Komuna e Novobërdës



Profili i komunës

Në komunën e Novobërdës, nga rasti i parë me COVID-19 në muajin korrik të vitit 2020 deri në muajin dhjetor të vitit 2021, janë identifikuar 196 raste me COVID-19, prej të cilave 186 janë shëruar, dhe 10 kanë rezultuar me vdekje. Për t'i koordinuar dhe menaxhuar veprimet për parandalimin e përhapjes së pandemisë COVID-19, Komuna ka krijuar Shtabin Emergjent, i cili ka marrë të gjitha masat mbrojtëse për parandalimin e përhapjes së pandemisë COVID-19 në përputhje me Vendimet e MSH-së dhe IKSHPK-së.



Ndikimet kryesore ekonomike dhe financiare

Komuna e Novobërdës, para krizës së pandemisë është ballafaquar me mungesë të buxhetit komunal, duke parë që ka një sipërfaqe të madhe të territorit, pra mangësi në arritjen e synimeve të saj për t'i ndihmuar banorët t'i plotësojnë nevojat e tyre elementare.



Mjedisi i biznesit

Të dhënat tregojnë se si në shumicën e komunave të tjera të vogla në Kosovë, edhe në këtë komunë më i prekur është sektori privat. Ndonëse zyrtarët e kësaj komune thonë se kriza e pandemisë ka ndikuar negativisht në zhvillimin e bizneseve të tjera, nuk kanë të dhëna zyrtare se sa biznese janë mbyllur, por sipas tyre nuk ka biznese të mbyllura nga gratë. Bazuar në të dhënat e hulumtimit, pandemia ka ndikuar negativisht në mbylljen e bizneseve deri në -2%.



Aranzimet ekonomike të qeverisë

Sipas zyrtarëve të kësaj komune, të gjitha institucionet lokale përgjegjëse për zbatimin e masave kundër COVID-19 në nivel lokal kanë treguar bashkëpunim të lartë. Ky bashkëpunim ka lehtësuar punën për operatorët ekonomik në komunë dhe zhvillimin e tyre ekonomik.



Tregu i punës

Sipas të dhënave të hulumtimit, punësimi në këtë komunë ka rënë ndjeshëm gjatë pandemisë, ndërsa sektorët më të prekur janë sektorët e gastronomisë, hotelarisë dhe industrisë së shitjes me pakicë. Ngjashëm me situatën e bizneseve, komuna nuk ka të dhëna për numrin e punëkërkuesve apo atyre që kanë humbur punën gjatë kësaj periudhe.



Mjedisi financiar

Sipas përgjigjeve të zyrtarëve të komunës së Novobërdës, pjesa më e madhe e buxhetit të kësaj komune përbëhet nga grantet qeveritare dhe vetëm një përqindje e vogël e buxhetit komunal përbëhet nga të hyrat komunale. Gjatë vitit të parë të pandemisë ka pasur rënie të të hyrave vetanake dhe të të hyrave tatimore krahasuar me vitin paraprak, por këto më pas, sipas të dhënave të hulumtimit, janë rritur në vitin 2021.



Infrastruktura, shërbimet bazike dhe lidhshmëria

Bazuar në të dhënat e marra, komuna e Novobërdës në kohën para pandemisë është përballur me mungesë të shërbimeve shëndetësore, një numri të vogël të mjekëve dhe infermierëve dhe shërbimit mjekësor 24 orë dhe kjo ka ndikuar negativisht deri në -10% në këtë shërbim. Nuk ka transport publik as brenda komunës dhe as nuk është i lidhur me qendrat tjera p.sh. Prishtinën dhe Gjilanin, sepse operatorët privatë nuk kanë pasur interes pasi nuk ka asnjë përfitim, gjë që vështirëson marrjen e shërbimeve të nevojshme për banorët e kësaj komune, duke përfshirë shërbimet e shëndetësisë, arsimit dhe të punësimit. Sipas të dhënave nga zyrtarët komunalë, pandemia ka ndikuar negativisht që vlerësohet të jetë rreth -70% në qasjen në transport dhe mobilitet.

Dimensionet	Gjetjet kryesore
Mjedisi i biznesit	Më i prekuri është sektori privat, por nuk ka të dhëna zyrtare se sa biznese janë mbyllur gjatë kësaj krize të pandemisë.
Aranzimet ekonomike të qeverisë	Bashkëpunim me të gjitha komunat e veriut të Kosovës, dhe me të gjitha institucionet lokale, por ka munguar komunikimi me nivelin qendror.
Tregu i punës	Sektorët më të prekur janë sektorët e gastronomisë, hotelarisë dhe industrisë së shitjes me pakicë.
Mjedisi financiar	Gjatë vitit 2020 ka pasur rënie të të hyrave vetanake dhe të të hyrave tatimore krahasuar me vitin paraprak, por këto më pas, sipas të dhënave të hulumtimit, kanë shënuar rritje në vitin 2021.
Infrastruktura, shërbimet bazike dhe lidhshmëria	Mungesa e kujdesit shëndetësor dhe shërbimeve të transportit.



Reagimi ndaj krizës dhe masat e rimëkëmbjes

Mbështetja e komunës në aspektin e bizneseve është fokusuar kryesisht në dhënien e ndihmës për shtresat më të rrezikuara të popullsisë përmes ofrimit të mjeteve dhe barnave të nevojshme mjekësore, ushqimeve dhe mjeteve esenciale të funksionimit gjatë karantinës. Janë miratuar masa dhe lehtësime të ndryshme për sektorin ekonomik për të stimuluar biznesin e tij në një periudhë krize si vendimi për lirim nga tatimet dhe qiratë komunale të bizneseve për të gjitha bizneset që operojnë në këtë komunë, mirëmbajtja dhe dezinfektimi i hapësirave publike dhe objektet që përdoren për aktivitete biznesi formale dhe joformale (si rrugët, sheshet publike, tregjet komunale, etj.).

Në vend të përfundimeve



Komuna e Novobërdës nuk ka miratuar plan për menaxhimin e krizave, sepse komuna nuk ka as kapacitete të mjaftueshme për të hartuar një plan zhvillimor komunal. Sipas zyrtarëve të kësaj komune, në kuadër të planit për rimëkëmbje, fokusi kryesor duhet të jetë në mbështetjen e sektorit të gastronomisë dhe hotelarisë, si sektorët kryesorë që operojnë në këtë komunë.

Komuna e Obiliqit



Profili i komunës

Në komunën e Obiliqit, nga rasti i parë me COVID-19 në muajin mars të vitit 2020 deri në muajin dhjetor të vitit 2021, janë identifikuar 2.491 raste me COVID-19, prej të cilave 2.426 janë shëruar dhe 62 kanë rezultuar me vdekje. Për t'i koordinuar dhe menaxhuar veprimet për parandalimin e përhapjes së pandemisë COVID-19, Komuna ka krijuar Shtabin Emergjent, i cili ka marrë të gjitha masat mbrojtëse për parandalimin e përhapjes së pandemisë COVID-19 në përputhje me Vendimet e MSH-së dhe IKSHPK-së.



Ndikimet kryesore ekonomike dhe financiare

Gjendja ekonomike dhe sociale e kësaj komune ishte jashtëzakonisht e rëndë edhe para fillimit të krizës së pandemisë për shkak të numrit të madh të të papunëve, numrit të madh të familjeve me asistencë sociale dhe mjedisit të ndotur, dhe të gjithë këta faktorë kanë ndikuar në mirëqenien e qytetarëve.



Mjedisi i biznesit

Sipas zyrtarëve të kësaj komune, gjatë pandemisë në komunën e Obiliqit janë prekur pothuajse të gjithë sektorët e fushës së biznesit, si gastronomia, tekstili, hoteleria, ndërtimtaria, industria e shitjes me pakicë, rrobaqepësia, sallonet e bukuri etj. Ndërkohë që nuk ka të dhëna për numrin e bizneseve të mbyllura si pasojë e pandemisë.



Aranzhimet ekonomike të qeverisë

Sipas zyrtarëve komunalë të Obiliqit, deri më tani ka pasur bashkëpunim të mirë në nivel lokal dhe qendror, ku si lehtësues në këtë bashkëpunim vlerësohet të jetë AKK-ja. Sipas tyre, gjatë kësaj periudhe të pandemisë ka informacione dhe konsultime në baza mujore.



Tregu i punës

Sipas vlerësimeve të zyrtarëve komunal, sektorët që janë më të prekur në shkallë të punësimit janë gastronomia, tekstili, hoteleria, ndërtimtaria, industria e shitjes me pakicë, rrobaqepësia, sallonet e bukurisë etj. Megjithatë, nuk ka të dhëna zyrtare për numrin e të punësuarve dhe punëkërkuësve gjatë periudhës së pandemisë.



Mjedisi financiar

Ngjashëm me komunat tjera, edhe në komunën e Obiliqit gjatë vitit 2020 ka pasur rënie të të hyrave vetanake dhe të hyrave tatimore në krahasim me vitin paraprak, por këto më pas, sipas të dhënave të hulumtimit, janë rritur në vitin 2021. Gjatë kësaj periudhe të pandemisë, është rritur edhe buxheti për subvencione dhe donacione nga donatorët e jashtëm.



Infrastruktura, shërbimet bazike dhe lidhshmëria

Sa i përket qasjes në arsim, gjatë pandemisë ka pasur probleme për disa nxënës, kryesisht nga komunitetet RAE, të cilëve u mungonin pajisjet teknologjike, por kohë pas kohe, komuna përmes donatorëve ka arritur t'u sigurojë tableta. I njëjti problem me këtë komunitet ka qenë mungesa e qasjes në internet, por në pjesë të tjera të qytetit ka një shtrirje të rrjetit të internetit. Për sa i përket shërbimeve të transportit, itineraret janë reduktuar në zonat me mobilitet më të ulët për shkak të masave kundër COVID-19.

Dimensionet	Gjetjet kryesore
Mjedisi i biznesit	Të gjithë sektorët e fushës së biznesit u prekën, por nuk ka të dhëna zyrtare se sa biznese janë mbyllur gjatë kësaj krize të pandemisë.
Aranzhimet ekonomike të qeverisë	Komuna ka bashkëpunuar ngushtë me nivelin qendror, përkatësisht me Ministrinë e Shëndetësisë për hapat e ndërmarrë.
Tregu i punës	Sektorët më të prekur për sa i përket shkallës së punësimimit janë gastronomia, tekstili, ndërtimtaria, industria e shitjes me pakicë, robaqepësia, sallonet e bukurisë etj.
Mjedisi financiar	Gjatë vitit 2020 ka pasur rënie të të hyrave vetanake dhe të të hyrave tatimore krahasuar me vitin paraprak, por këto më pas, sipas të dhënave të hulumtimit, kanë shënuar rritje në vitin 2021.
Infrastruktura, shërbimet bazike dhe lidhshmëria	Sa i përket arsimit dhe qasjes në internet gjatë pandemisë ka pasur probleme për disa nxënës, kryesisht nga komunitetet RAE. Sa i përket shërbimeve të transportit, zonat rurale janë prekur më së shumti.



Reagimi ndaj krizës dhe masat e rimëkëmbjes


Sa i përket masave të rimëkëmbjes, komuna e Obiliqit ka ofruar ndihmë për bizneset dhe në veçanti për bizneset e drejtuara nga gratë, ku sektori i biznesit është subvencionuar në vlerë prej 241,000.00 €. Ndihmë është ofruar edhe për qytetarët me asistencë sociale, të cilëve u janë ofruar pako ushqimore dhe pajisje mbrojtëse. Në emër të rimëkëmbjes ekonomike është subvencionuar sektori i bujqësisë në vlerë prej 170,150.00 €. Me iniciativë të kryetarit të komunës, kuvendi komunal ka marrë vendim që të subvencionohen qytetarët e prekur nga COVID-19 në shumën prej 100.00 € dhe vdekjet e qytetarëve në shumën prej 300.00 €. Ky vendim është marrë në muajin dhjetor të vitit 2020 dhe do të jetë në fuqi deri në përfundimin e situatës së pandemisë.

Në vend të përfundimeve



Roli i pushtetit lokal ka qenë më shumë zbatimi i vendimeve qendrore dhe mbulimi dhe administrimi i situatave me kapacitetet e veta njerëzore, financiare dhe logjistike. Ndërkohë, nuk ka plan afatgjatë për rimëkëmbjen ekonomike përveç masave të marra deri më tani sipas kompetencave dhe mjeteve vetanake financiare në dispozicion.

Komuna e Parteshit



Profili i komunës

Zyrtarët e komunës së Parteshit deklaruan se nuk kanë të dhëna për rastet e identifikuara, të shëruara apo të rezultuara me vdekje nga COVID-19. Kjo për shkak se – sipas tyre – sistemi i tyre shëndetësor lokal funksionon ‘nën sistemin serb’, dhe të dhëna të tilla nuk mund të sigurohen nga komuna. Për t’i koordinuar dhe menaxhuar veprimet për parandalimin e përhapjes së pandemisë COVID-19, Komuna ka ngritur Shtabin Emergjent, i cili ka marrë të gjitha masat mbrojtëse për parandalimin e përhapjes së pandemisë COVID-19 në përputhje me Vendimet e MSH-së dhe IKSHPK-së.



Ndikimet kryesore ekonomike dhe financiare

Komuna e Parteshit është një komunë e vogël rurale, e cila edhe para pandemisë është përballur me probleme të shumta si papunësia e madhe, siguria ekonomike, kushtet e mira të jetesës, arsimi etj. Banorët e Parteshit kryesisht merren me bujqësi dhe jetojnë duke kultivuar tokën. Meqenëse popullsia e komunës sonë merret më së shumti me bujqësi, ka pasur vërshime të mëdha që kanë shkaktuar dëme të mëdha te prodhuesit bujqësorë.



Mjedisi i biznesit

Të dhënat tregojnë se si në shumicën e komunave të tjera të vogla në Kosovë, edhe në këtë komunë më i prekuri është sektori privat. Ndonëse zyrtarët e kësaj komune thonë se kriza e pandemisë ka ndikuar negativisht në zhvillimin e të gjitha bizneseve, nuk kanë të dhëna zyrtare se sa biznese janë mbyllur gjatë kësaj periudhe.



Aranzimet ekonomike të qeverisë

Sipas zyrtarëve të kësaj komune, ata kanë pasur bashkëpunim të mirë me komunat e zonës së tyre dhe të gjitha institucionet lokale përgjegjëse për zbatimin e masave kundër COVID në nivel lokal kanë treguar bashkëpunim të lartë. Ky bashkëpunim ka lehtësuar punën për operatorët ekonomikë në komunë dhe zhvillimin e tyre ekonomik.



Tregu i punës

Sipas të dhënave të hulumtimit, punësimi në këtë komunë ka rënë ndjeshëm gjatë pandemisë, ndërkohë që janë prekur të gjithë sektorët. Ngjashëm me situatën e bizneseve, komuna nuk ka të dhëna për numrin e punëkërkuesve apo atyre që kanë humbur punën gjatë kësaj periudhe, por sipas zyrtarëve të kësaj komune, shkalla më e lartë e papunësisë është për gratë dhe të rinjtë.



Mjedisi financiar

Sipas përgjigjeve të zyrtarëve të komunës së Parteshit, pjesa më e madhe e buxhetit të kësaj komune përbëhet nga grantet qeveritare dhe vetëm një përqindje e vogël e buxhetit komunal përbëhet nga të hyrat komunale.



Infrastruktura, shërbimet bazike dhe lidhshmëria

Për sa i përket furnizimit me ujë të pijshëm gjatë viteve 2020 dhe 2021, ai ka qenë në nivel të kënaqshëm, shërbim ky që nuk është prekur nga situata e pandemisë, ngjashëm me atë të menaxhimit të mbeturinave. Sa i përket shërbimeve të transportit, Komuna ka pasur probleme në ofrimin e shërbimeve të transportit për të gjithë banorët e saj. Gjithashtu, gjatë kësaj periudhe ka pasur rritje të numrit të kërkesave për ofrimin e shërbimeve të nevojshme sociale të ofruara nga Sektori i Shërbimeve Sociale. Të gjithë qytetarët e kësaj komune kanë pasur mundësi t'i marrin shërbimet bazë në institucionet arsimore përmes mësimin online.

Dimensionet	Gjetjet kryesore
Mjedisi i biznesit	Më i prekuri është sektori privat, por nuk ka të dhëna zyrtare se sa biznese janë mbyllur gjatë kësaj krize të pandemisë.
Aranzimet ekonomike të qeverisë	Bashkëpunim me të gjitha komunat e veriut të Kosovës, dhe me të gjitha institucionet lokale, por ka munguar komunikimi me nivelin qendror.
Tregu i punës	Të gjithë sektorët si gastronomia, hoteleria dhe industria e shitjes me pakicë etj., janë prekur.
Mjedisi financiar	Gjatë vitit 2020 ka pasur rënie të të hyrave vetanake dhe të të hyrave tatimore krahasuar me vitin paraprak, por këto më pas, sipas të dhënave të hulumtimit, kanë shënuar rritje në vitin 2021.
Infrastruktura, shërbimet bazike dhe lidhshmëria	Shërbimet e kujdesit shëndetësor, ujit të pijshëm, grumbullimit të mbeturinave dhe ato sanitare kanë qenë në nivel të kënaqshëm në zonën urbane, ndërsa sa i përket transportit disa zona rurale janë më të prekura.



Reagimi ndaj krizës dhe masat e rimëkëmbjes


Mbështetja e komunës është e përqendruar kryesisht në dhënien e ndihmës për shtresat më të rrezikuara të popullsisë përmes ofrimit të mjeteve dhe barnave të nevojshme mjekësore, ushqimit dhe mjeteve thelbësore të funksionimit gjatë karantinës. Janë miratuar masa dhe lehtësime të ndryshme për sektorin ekonomik për të stimuluar biznesin e tij në një periudhë krize si vendimi për lirim nga tatimet dhe qiratë komunale të bizneseve për të gjitha bizneset që operojnë në këtë komunë, mirëmbajtja dhe dezinfektimi i hapësirave publike dhe objekteve të përdorura për aktivitete biznesi formale dhe joformale (si rrugët, sheshet publike, tregjet komunale, etj.), ofrimi i inputeve falas ose të subvencionuara për bizneset kritike (p.sh., mielli i bukës), mbështetje e synuar në formën e granteve ose asistencës teknike për t'i mbështetur inovacionet për reagimin dhe rimëkëmbjen nga COVID-19, etj.

Në vend të përfundimeve



Komuna e Parteshit nuk ka kapacitete buxhetore dhe njerëzore për të zhvilluar plan afatgjatë për rimëkëmbje. Duke qenë një komunë e vogël që varet kryesisht nga sektori i bujqësisë, subvencionet për bizneset e këtij sektori konsiderohen thelbësore.

Komuna e Pejës



Profili i komunës

Komuna e Pejës nuk ka dhënë informacione lidhur me numrin e pacientëve të identifikuar, të shëruar dhe të vdekur nga pandemia COVID-19 gjatë viteve 2020 dhe 2021. Për t'i koordinuar dhe menaxhuar veprimet për parandalimin e përhapjes së pandemisë COVID-19, Komuna ka krijuar Shtabi Emergjent, i cili ka marrë të gjitha masat mbrojtëse për parandalimin e përhapjes së pandemisë COVID-19 në përputhje me vendimet e MSH-së dhe IKSHPK-së.



Ndikimet kryesore ekonomike dhe financiare

Sipas të dhënave nga komuna e Pejës, ashtu si në shumicën e komunave tjera në Kosovë, sektori privat ka qenë më i prekuri nga kriza e pandemisë. Shkalla e lartë e papunësisë, sidomos tek të rinjtë, është një nga problemet e kësaj komune edhe para pandemisë.



Mjedisi i biznesit

Gjatë pandemisë në komunën e Pejës janë prekur të gjithë sektorët e biznesit si: gastronomia, hoteleria, sektori i ndërtimtarisë, pastaj bizneset e vogla individuale si sallonet e bukurisë etj.



Aranzhimet ekonomike të qeverisë

Koordinimi ndërmjet nivelit qendror dhe atij lokal është bërë i dukshëm për të siguruar përgjigje efektive gjatë menaxhimit të krizave. Komuna ka bashkëpunuar ngushtë me nivelin qendror, përkatësisht me Ministrinë e Shëndetësisë për hapat e ndërmarrë.



Tregu i punës

Sa i përket shkallës së punësimit, sektorët që preken më shumë janë: gastronomia, bizneset e vogla individuale si rrobaqepësia, sallonet e bukurisë etj., ndërsa për sa i përket hendekut gjinor në fushën e punësimit, të dyja gjinitë mbeten kryesisht të prekura.



Mjedisi financiar

Ngjashëm me komunat tjera, edhe në komunën e Pejës gjatë vitit 2020 ka pasur rënie të të hyrave vetanake dhe të të hyrave tatimore në krahasim me vitin paraprak, por këto më pas, sipas të dhënave të hulumtimit, kanë shënuar rritje në vitin 2021.



Infrastruktura, shërbimet bazike dhe lidhshmëria

Sa i përket shërbimeve të ujit, sipas të dhënave nga hulumtimi në komunën e Pejës, nuk ka pasur probleme me furnizimin as gjatë dhe as para pandemisë. Për sa i përket shërbimeve sanitare në këtë periudhë kohore, komuna ka ofruar këtë shërbim për të gjithë qytetarët, duke dezinfektuar sheshet, objektet publike, shkollat, stacionet, ka shpërndarë materialin e nevojshëm higjienik në çdo vend etj. Nuk ka pasur probleme as në qasjen në shërbime as për grumbullimin e mbeturinave, as për shërbimet e transportit. Në komunën e Pejës si dhe në mbarë Kosovën, sistemi arsimor ka funksionuar në tre skenarë varësisht nga situata e pandemisë. Gjithashtu, komuna ka ndërmarrë hapat e nevojshëm që të gjithë qytetarët të kenë qasje në shërbimet bazë të kujdesit shëndetësor.

Dimensionet	Gjetjet kryesore
Mjedisi i biznesit	U prekën të gjithë sektorët e biznesit si: gastronomia, hoteleria, ndërtimtaria, më pas bizneset e vogla individuale si sallonet e bukurisë etj.
Aranzimet ekonomike të qeverisë	Komuna ka bashkëpunuar ngushtë me nivelin qendror, përkatësisht me Ministrinë e Shëndetësisë për hapat e ndërmarrë.
Tregu i punës	Sektorët që preken më shumë janë: gastronomia, bizneset e vogla individuale si rrobaqepësia, sallonet e bukurisë etj., ndërsa për sa i përket hendekut gjinor në fushën e punësimit, të dyja gjinitë mbeten kryesisht të prekura.
Mjedisi financiar	Gjatë vitit 2020 ka pasur rënie të të hyrave vetanake dhe të të hyrave tatimore krahasuar me vitin paraprak, por këto më pas, sipas të dhënave të hulumtimit, kanë shënuar rritje në vitin 2021.
Infrastruktura, shërbimet bazike dhe lidhshmëria	Shërbimet e kujdesit shëndetësor, grumbullimit të mbeturinave, ujit të pijshëm dhe ato sanitare kanë qenë në nivel të kënaqshëm, ndërsa sistemi arsimor ka funksionuar në tre skenarë në varësi të situatës së pandemisë.



Reagimi ndaj krizës dhe masat e rimëkëmbjes

Komuna e Pejës ka ndërmarrë një program të masave lehtësuese për të mbështetur bizneset që kryejnë aktivitetet e tyre afariste në këtë komunë. Disa nga masat e marra përfshijnë: lirim të të gjitha bizneseve nga të gjitha tatimet komunale, si qiratë për tokën, lokalet dhe banesat që janë në pronësi të komunës, subvencionimin e bizneseve, rregulloret për lehtësimin e regjistrimit dhe licencimit të bizneseve etj. Janë ofruar edhe pako emergjente për asistencën e nevojshme dhe pako ushqimore për familjet në nevojë. Ndërsa nuk ka plan afatgjatë për rimëkëmbje përveç pakos për rimëkëmbjes nga niveli qendror për të cilin nuk ka informacione se si është shpërndarë nëpër komuna.

Në vend të përfundimeve



Papunësia mbetet një sfidë e vazhdueshme e komunës para dhe gjatë pandemisë. Sektori privat mbetet më i prekuri nga pandemia dhe gjithashtu mungon një plan afatgjatë komunal për rimëkëmbje.

Komuna e Podujevës



Profili i komunës

Në komunën e Podujevës, nga rasti i parë me COVID-19 më 13 mars 2020 deri në muajin dhjetor të vitit 2021, nga rasti i parë me COVID-19 në mars të vitit 2020 deri në muajin dhjetor të vitit 2021, janë identifikuar 7179 raste me COVID-19, nga të cilat 7105 u shëruan dhe 74 rezultuan me vdekje. Komuna ka themeluar Shtabin Emergjent, i cili ka marrë të gjitha masat mbrojtëse për parandalimin e përhapjes së pandemisë COVID-19 në përputhje me vendimet e MSH-së dhe IKSHPK-së.



Ndikimet kryesore ekonomike dhe financiare

Për shkak të masave kundër përhapjes së pandemisë, ka pasur rënie të veprimtarive ekonomike pasi në këtë komunë, në periudhën e pandemisë, janë prekur më së shumti sektorët që dominojnë kryesisht ekonominë e kësaj komune si gastronomia, sektori i shërbimeve, sektori i prodhimit, ai i tekstilit etj.



Mjedisi i biznesit

Sipas të dhënave të hulumtimit nga komuna e Podujevës, ekonomia lokale dominohet nga bizneset individuale, dhe mikrobizneset të cilat janë goditur nga situata pandemike. Sipas zyrtarëve komunalë, pandemia ka ndikuar negativisht në mbylljen e bizneseve deri në -5% dhe ka ndikuar në uljen e veprimtarisë ekonomike deri në -20%. Statistikat e ofruara nga kjo komunë tregojnë se numri i bizneseve të mbyllura në vitin 2020 ishte 36, ndërsa në vitin 2021 ishin mbyllur 37 biznese. Nëse shikojmë ndarjen gjinore të bizneseve të drejtuara nga gratë, janë gjithsej nëntë biznese të mbyllura në periudhën 2020-2021 kryesisht në sektorët e tekstilit, shërbimeve dhe prodhimit ushqimor. Nga të dhënat e marra nga zyrtarët komunalë, në këtë komunë ka objekte gjatë hapjes së bizneseve dhe ato janë pa pagesë. Ndërkohë që vlerësohet se ekonomia informale është pjesë e jetës së të bërit biznes por është në parametra më të ulët.



Aranzimet ekonomike të qeverisë

Informimi dhe konsultimi i ndërsjellë kanë qenë mekanizmat të bashkëpunimit në nivel lokal dhe qendror. Gjithashtu, sipas zyrtarëve komunalë, kjo komunë ka mbajtur takime me nivelin qendror lidhur me bashkëpunimin e nivelit lokal dhe atij qendror për masat që do të ndërmerren, për të mbështetur menaxhimin e situatës dhe ruajtjen e shëndetit publik.



Tregu i punës

Sipas vlerësimeve të zyrtarëve komunal, sektorët që preken më së shumti sa i përket shkallës së punësimit janë sektori i gastronomisë, tregtisë, ndërtimtarisë dhe shërbimeve. Sipas zyrtarëve komunalë, pandemia ka ndikuar negativisht në shkallën e papunësisë deri në -30%, ndërsa ndikimi më i madh negativ, rreth -33%, bie sidomos mbi papunësinë e grave dhe të rinjve.



Mjedisi financiar

Në bazë të përgjigjeve të zyrtarëve të komunës së Podujevës, gjatë kësaj periudhe pandemike ka pasur rënie të të hyrave vetanake, prej 6%. Situata ka qenë e njëjtë edhe me të hyrat tatimore, ku ka pasur një rënie deri në 8%.



Infrastruktura, shërbimet bazike dhe lidhshmëria

Shërbimet e ujit gjatë periudhës së pandemisë janë ofruar për të gjithë banorët, por në disa pjesë kryesisht në zonat rurale kanë pasur shërbime më të reduktuara. Situata ka qenë e njëjtë edhe me shërbimet sanitare, shëndetësinë, transportin, grumbullimin e mbetjeve të cilat kanë qenë më problematike për banorët që jetojnë në zona të izoluar. Për shkak se kjo komunë ka një territor shumë të shpërndarë, është dashur të angazhohen operatorë privatë shtesë për të ofruar transport për qytetarët. Sipas të dhënave nga zyrtarët komunalë, pandemia ka ndikuar negativisht që llogaritet të jetë rreth -10% në qasjen në transport dhe mobilitet.

Dimensionet	Gjetjet kryesore
Mjedisi i biznesit	Ekonomia lokale dominohet nga bizneset individuale dhe mikrobizneset që janë goditur nga situata e pandemisë.
Aranzhimet ekonomike të qeverisë	Mekanizmat e bashkëpunimit në nivel lokal dhe qendror kanë qenë informimi dhe konsultimi i ndërsjellë.
Tregu i punës	Numri i bizneseve të mbyllura në vitin 2020 ishte 36, ndërsa në vitin 2021 ishin 37 biznese të mbyllura. Nëse shikojmë ndarjen gjinore të bizneseve të drejtuara nga gratë, janë gjithsej nëntë biznese të mbyllura në periudhën 2020-2021 kryesisht në sektorët e tekstit, shërbimeve dhe prodhimit të ushqimit.
Mjedisi financiar	Gjatë vitit 2020 ka pasur rënie të të hyrave vetanake dhe të të hyrave tatimore krahasuar me vitin paraprak, por këto më pas, sipas të dhënave të hulumtimit kanë shënuar rritje në vitin 2021.
Infrastruktura, shërbimet bazike dhe lidhshmëria	Shërbimet e kujdesit shëndetësor, grumbullimit të mbeturinave, ujit të pijshëm, ssanitare dhe të transportit kanë qenë në nivel të kënaqshëm në zonën urbane, ndërsa disa nga zonat rurale janë prekur më shumë.



Reagimi ndaj krizës dhe masat e rimëkëmbjes


Bazuar në të dhënat e hulumtimit, aktualisht kjo komunë është në fazën e identifikimit të efekteve dhe kostove të shkaktuara nga pandemia dhe të masave të rimëkëmbjes në përputhje me mundësitë buxhetore. Lidhur me masat e rimëkëmbjes të ndërmarra nga kjo komunë, pas konsultimeve dhe debateve me komunitetin e biznesit, Komuna me vendim i ka liruar ata nga pagesa e tarifës për ushtrimin e veprimtarive ekonomike dhe i ka falur të gjitha borxhet nga kjo kategori; riprioritizimi dhe riprogramimi i buxheteve ekzistuese komunale për të rritur disponueshmërinë e financave në fushat kritike për reagimin ndaj COVID-19; huamarrja e re dhe/ose ristrukturimi i kredive ekzistuese me kreditorët për të krijuar hapësirë fiskale shtesë; duke kërkuar fonde direkt nga partnerët e zhvillimit dhe donatorët ndërkombëtarë etj.

Në vend të përfundimeve



Pushteti lokal në komunën e Podujevës ka qenë më i fokusuar në zbatimin e vendimeve qendrore dhe mbulimin dhe menaxhimin e situatave me burimet e veta njerëzore dhe financiare, si dhe me kapacitetet e veta logjistike. Komuna nuk kishte një plan paraprak të menaxhimit të emergjencave përveç atë të situatave të përmytjeve. Ndërkohë, nuk ka një plan afatgjatë për rimëkëmbjen ekonomike përveç masave të marra deri më tani sipas kompetencave dhe mjeteve të veta financiare në dispozicion.

Komuna e Prishtinës



Profili i komunës

Në komunën e Prishtinës, nga rasti i parë me COVID-19 në muajin mars të vitit 2020 deri në muajin dhjetor të vitit 2021, janë identifikuar 61.411 raste me COVID-19, prej të cilave 51479 janë shëruar dhe 436 kanë rezultuar me vdekje. Për të koordinuar dhe menaxhuar veprimet për parandalimin e përhapjes së pandemisë COVID-19, komuna ka themeluar Shtabin Emergjent, duke marrë të gjitha masat mbrojtëse për parandalimin e përhapjes së pandemisë COVID-19 në përputhje me Vendimet e MSH-së dhe IKSHPK-së.



Ndikimet kryesore ekonomike dhe financiare

Si kryeqytet dhe qendër ekonomike, financiare, politike dhe tregtare e Kosovës, Prishtina përbën zemrën e ekonomisë së Kosovës. Sektori i shërbimeve është më i rëndësishmi për ekonominë e qytetit dhe punëson më shumë se 75% të fuqisë punëtore të Prishtinës. Komuna ka mundësi më të mëdha buxhetore se komunat tjera, në të njëjtën kohë barrë më të madhe se komunat tjera për shkak të shërbimeve më të mëdha por edhe numrit të banorëve. Po ashtu ka një numër më të madh të bizneseve në krahasim me komunat e tjera. Megjithatë, masat kufizuese, si pasojë e pandemisë, kanë ndikuar edhe në punësimin në nivel lokal.



Mjedisi i biznesit

Konkurrenca në treg në këtë komunë është mjaft e madhe pasi ka një numër të madh biznesesh. Megjithatë, vështirësitë gjatë periudhës së COVID-19 kanë përkeqësuar aktivitetet e biznesit. Shumica e bizneseve kanë deklaruar humbje të konsiderueshme sidomos në sektorin e gastronomisë, hotelevisë dhe ndërtimitarisë, transportit, kopshteve, industrinë e shitjes me pakicë, sallonet e bukuri. Ndonëse zyrtarët e kësaj komune raportuan se kriza pandemike ka ndikuar negativisht në zhvillimin e bizneseve të tjera, nuk kanë të dhëna zyrtare se sa biznese janë mbyllur gjatë kësaj periudhe.



Aranzhimet ekonomike të qeverisë

Mekanizmat e bashkëpunimit në nivel lokal dhe qendror kanë qenë informimi dhe konsultimi i ndërsjellë. Janë zhvilluar takime apo konsultime të ndërsjella me kryetarët e komunave të rajonit gjatë periudhës së pandemisë për t'u informuar rreth situatës së përgjithshme me COVID-19, por edhe për të koordinuar masat dhe veprimet përballë COVID-19. Gjithashtu, sipas zyrtarëve komunalë, komuna ka mbajtur takime me pushtetin qendror për bashkëpunimin e nivelit lokal dhe atij qendror për të koordinuar masat për ruajtjen e shëndetit publik dhe menaxhimin e situatës së përgjithshme të krijuar si pasojë e shpërthimit të pandemisë.



Tregu i punës

Të dhënat tregojnë se në Prishtinë, siç është rasti me të gjitha komunat në mbarë Kosovën, sektori privat ka qenë më i prekur nga kriza e pandemisë. Ndërsa sektorët më të prekur janë gastronomia, hoteleria, ndërtimtaria, transporti, kopshtet, industria e shitjes me pakicë, sallonet e bukurisë etj. Ngjashëm me situatën e bizneseve, komuna nuk ka të dhëna për numrin e punëkërkuësve apo atyre që kanë humbur punën gjatë kësaj periudhe.



Mjedisi financiar

Bazuar në të dhënat e hulumtimit, të hyrat vetanake të komunës kanë pësuar rënie të ndjeshme gjatë vitit 2020. Rënia e të hyrave vetanake është shoqëruar me rënie të shpenzimeve në të gjitha kategoritë buxhetore, veçanërisht investimet kapitale, pasi të hyrat vetanake kryesisht përdoren për investime kapitale. Rënie të ndjeshme kanë pësuar edhe të hyrat e tjera të gjeneruara nga komuna, pasi të gjithë sektorët nga të cilët komuna siguron të ardhura janë ndikuar nga masat kundër përhapjes së pandemisë. Megjithatë, situata ka ndryshuar gjatë vitit 2021, koha kur janë rritur edhe të hyrat vetanake dhe tatimet mbi pronën.



Infrastruktura, shërbimet bazike dhe lidhshmëria

Sipas zyrtarëve komunalë të Prishtinës, Shtabi Emergjent Komunal ka trajtuar dhe ndihmuar të gjitha familjet e cënueshme (duke i dhënë përparësi komuniteteve pakicë, si dhe familjeve në skemën e asistencës sociale), ka ofruar kujdes shëndetësor dhe social për të gjitha familjet dhe individët e prekur nga COVID-19, ka furnizuar dhe shpërndarë pako ushqimore, gjëra të nevojshme higjieno-sanitare dhe miell për të gjithë të prekurit dhe për familjet në kushte të rënda ekonomike dhe sociale. Në komunën e Prishtinës, si dhe në mbarë Kosovën, sistemi arsimor ka funksionuar në tre skenarë në varësi të situatës së pandemisë. Kompania përgjegjëse për grumbullimin e mbeturinave ka punuar me kapacitet të plotë dhe është përpjekur ta intensifikojë shërbimin e tyre. Si shërbim që nuk është prekur nga situata e pandemisë, furnizimi me ujë të pijshëm ka qenë në nivel të kënaqshëm.

Dimensionet	Gjetjet kryesore
Mjedisi i biznesit	Shumica e bizneseve kanë deklaruar humbje të konsiderueshme sidomos në sektorin e gastronomisë, të hotelerisë, në sektorin e ndërtimitarisë, transportit, kopshtarisë, industrinë e shitjes me pakicë, sallonet e bukurisë. Nuk ka të dhëna për numrin e bizneseve të mbyllura.
Aranzimet ekonomike të qeverisë	Mekanizmat e bashkëpunimit në nivel lokal dhe qendror kanë qenë informimi dhe konsultimi i ndërsjellë.
Tregu i punës	Sektori privat është prekur më së shumti nga kriza e pandemisë. Nuk ka të dhëna për numrin e punëkërkuësve apo atyre që kanë humbur punën.
Mjedisi financiar	Të hyrat dhe shpenzimet vetanake komunale në të gjitha kategoritë buxhetore, veçanërisht investimet kapitale kanë shënuar rënie të ndjeshme gjatë vitit 2020. Ka pasur ndryshime pozitive në vitin 2021.
Infrastruktura, shërbimet bazike dhe lidhshmëria	Shërbimet e kujdesit shëndetësor, grumbullimit të mbeturinave, ujit të pijshëm dhe ato sanitare kanë qenë në nivel të kënaqshëm, ndërsa sistemi arsimor ka funksionuar në tre skenarë në varësi të situatës pandemike.



Reagimi ndaj krizës dhe masat e rimëkëmbjes


Mbështetja e komunës është e fokusuar kryesisht në ofrimin e ndihmës për shtresat më të rrezikuara të popullatës përmes sigurimit të mjeteve dhe barnave të nevojshme mjekësore, ushqimeve dhe mjeteve esenciale gjatë periudhës së karantinës. Në këtë drejtim, rreth 1500 familje janë pajisur me pako higjienike dhe produkte ushqimore bazë, si dhe është subvencionuar transporti publik. Për stimulimin e biznesit në periudhë krize janë marrë masa dhe lehtësime të ndryshme për sektorin e ekonomisë, si lirimi nga tatimet dhe qiratë komunale për të gjitha bizneset që operojnë në komunë, ofrimi i artikujve falas ose të subvencionuar për bizneset në krizë. p.sh., buka, mielli), rregulloret për ta lehtësuar regjistrimin dhe licencimin e biznesit, mirëmbajtjen dhe dezinfektimin e hapësirave publike dhe objekteve të përdorura për aktivitete biznesi formale dhe joformale (si rrugët, sheshet publike, tregjet komunale, etj.) dhe mbështetje e synuar në formë grantesh ose asistence teknike për t'i mbështetur inovacionet për reagimin ndaj COVID-19 dhe rimëkëmbjen.

Në vend të përfundimeve



Komuna e Prishtinës nuk ka masa afatgjatë për rimëkëmbje nga pandemia COVID-19, por ka hartuar një plan afatmesëm për rimëkëmbjen e bizneseve të vogla dhe transportit publik. Ndonëse është komuna më e madhe me aktivitetin më të madh ekonomik, masat kufizuese për shkak të pandemisë kanë ndikuar negativisht në shkallën e punësimit. Kjo për shkak të bizneseve të vogla që operojnë në komunë, të cilat janë prekur më shumë nga kriza e pandemisë pavarësisht subvencioneve të dhëna nga komuna.

Komuna e Prizrenit



Profili i komunës

Komuna e Prizrenit nuk ka dhënë informacione lidhur me numrin e pacientëve të identifikuar, të shëruar dhe të vdekur nga pandemia COVID-19 gjatë viteve 2020 dhe 2021. Për t'i koordinuar dhe menaxhuar veprimet për parandalimin e përhapjes së pandemisë COVID-19, komuna ka krijuar Shtabin Emergjent, i cili ka marrë të gjitha masat mbrojtëse për parandalimin e përhapjes së pandemisë COVID-19 në përputhje me vendimet e MSH-së dhe IKSHPK-së.



Ndikimet kryesore ekonomike dhe financiare

Bizneset në komunën e Prizrenit, por edhe në mbarë Kosovën, kanë pasur pasoja të rënda nga situata e krijuar nga COVID-19. Përveç bizneseve formale, u ndikuan shumë edhe ekonomitë familjare që merren me bujqësi dhe tregti informale. Sfidat kryesore kanë qenë menaxhimi i pikës kufitare në Vërmicë, procedurat e prokurimit sidomos ato në procedurën e ankesës, fondet për parandalimin e pandemisë, numri i vogël i stafit sidomos në sektorin shëndetësor dhe inspektoratet, etj.



Mjedisi i biznesit

Konkurrenca e tregut në Komunën e Prizrenit është relativisht e madhe me biznese të shumta që operojnë në komunë. Vështirësitë gjatë periudhës së COVID-19 kanë shtuar më shumë vështirësi në bërjen e biznesit. Sektorët më të prekur nga situata e pandemisë në komunën e Prizrenit janë kryesisht ai i ndërtimit, tregtisë, industrisë së hotelerisë, bujqësisë etj. Përveç humbjes së fitimit, disa biznese kanë pësuar edhe humbje në thelb si: zhvlerësimi i aseteve (autobusëve) në lidhje me kompanitë e transportit, zhvlerësimi i mallrave për shkak të kalimit të sezonit, rastet e tjera tekstile, kryesisht veshje, humbje të produkteve bujqësore, kryesisht në rastet kur produktet e tyre eksportohen në vendet e Bashkimit Evropian (BE). Humbje ka edhe në sektorin e ndërtimit për shkak të pezullimit të aktiviteteve të punës, pasi që disa biznese operojnë jashtë territorit të komunës së Prizrenit. Sipas statistikave të Agjencisë së Regjistrimit të Bizneseve të Kosovës (ARBK), në vitin 2021 janë mbyllur 39 biznese të drejtuara nga gratë, të cilat operojnë në sallone bukurie dhe sallone tekstili etj.



Aranzimet ekonomike të qeverisë

Koordinimi ndërmjet nivelit qendror dhe atij lokal është bërë i dukshëm për të siguruar reaguesim efektiv gjatë menaxhimit të krizave. Komuna ka luajtur një rol vendimtar në zbatimin e masave të shëndetit publik si: zbatimi i politikave të izolimit, kujdesi për popullatën në nevojë, komunikimi në krizë, sigurimi i rendit dhe sigurisë publike. Komuna ka bashkëpunuar ngushtë me nivelin qendror, përkatësisht me Ministrinë e Shëndetësisë për hapat e ndërmarrë.



Tregu i punës

Shkalla e punësimit bazuar në të dhënat e Zyrës së Punësimit në Prizren për vitet 2020 dhe 2021 ka shënuar numrin më të ulët të vendeve të lira të punës në vitet e fundit. Kjo reflekton tkurrjen ekonomike që është shënuar gjatë këtyre viteve, rrjedhimisht kjo lidhet me efektet dhe masat për parandalimin e përhapjes së COVID-19. Viti 2020 në këtë komunë ka shënuar rritje eksponenciale të numrit të të papunëve të regjistruar krahasuar me trendin rënës që është shënuar në vitet e kaluara. Në vitin 2021, 1582 persona janë regjistruar si të papunë. Një përqindje e lartë e numrit të përgjithshëm të të papunëve janë personat e pakualifikuar dhe ata me nivel të ulët arsimor, përkatësisht personat me shkollë fillore dhe të mesme. Sipas statistikave të Zyrës së Punësimit, norma më e lartë e papunësisë vërehet te moshat 25-39 vjeç, rreth 41.15%.



Mjedisi financiar

Gjatë vitit 2020 në komunën e Prizrenit, ngjashëm me komunat tjera, ka pasur rënie të të hyrave vetanake dhe të hyrave tatimore në krahasim me vitin paraprak, por këto më pas, sipas të dhënave të hulumtimit janë rritur në vitin 2021.



Infrastruktura, shërbimet bazike dhe lidhshmëria

Furnizimi me ujë të pijshëm gjatë viteve 2020 dhe 2021 ka qenë në nivel të kënaqshëm, shërbim ky që nuk është prekur nga situata e pandemisë, ngjashëm me këtë ishte edhe menaxhimi i mbeturinave. Zyrtarët komunalë kanë deklaruar se kanë ofruar shërbime sociale si para pandemisë, ku është ofruar ndihmë për qytetarët, veçanërisht për ata me status të ulët social-ekonomik. Shërbimet sanitare janë ofruar edhe gjatë periudhës së pandemisë, ku në vazhdimësi është bërë pastrimi dhe dezinfektimi i objekteve-institucioneve publike, objekteve kolektive, hyrjeve të banesave, objekteve afariste, pastrim-larja e rrugëve dhe shesheve. Të gjitha familjet dhe individët e prekur nga COVID-19 kanë pasur kujdes shëndetësor dhe social, janë pajisur edhe me pako ushqimore-sanitare dhe si rrjedhojë e kësaj kujdesi shëndetësor ka qenë i përhershëm. Të gjithë qytetarët e Prizrenit kanë pasur mundësi t'i marrin shërbimet bazë në institucionet arsimore përmes mësimi online. Në të gjitha vendbanimet, edhe pse në kohë pandemie, grumbullimi i mbeturinave bëhej sipas planit operativ në të gjithë komunën.

Dimensionet	Gjetjet kryesore
Mjedisi i biznesit	U prekën të gjithë sektorët e biznesit si: gastronomia, hoteleria, ndërtimtaria, më pas bizneset e vogla individuale si sallonet e bukurisë etj.
Aranzimet ekonomike të qeverisë	Komuna ka bashkëpunuar ngushtë me nivelin qendror, përkatësisht me Ministrinë e Shëndetësisë për hapat e ndërmarrë.
Tregu i punës	Sektorët që preken më shumë janë: gastronomia, bizneset e vogla individuale si rrobaqepësia, sallonet e bukurisë etj., ndërsa për sa i përket hendekut gjinor në fushën e punësimit, të dyja gjinitë mbeten kryesisht të prekura.
Mjedisi financiar	Gjatë vitit 2020 ka pasur rënie të të hyrave vetanake dhe të të hyrave tatimore krahasuar me vitin paraprak, por këto më pas, sipas të dhënave të hulumtimit, kanë shënuar rritje në vitin 2021.
Infrastruktura, shërbimet bazike dhe lidhshmëria	Shërbimet e kujdesit shëndetësor, grumbullimit të mbeturinave, ujit të pijshëm dhe ato s sanitare kanë qenë në nivel të kënaqshëm, ndërsa sistemi arsimor ka funksionuar në tre skenarë në varësi të situatës së pandemisë.



Reagimi ndaj krizës dhe masat e rimëkëmbjes


Komuna e Prizrenit ka ndërmarrë një program të masave lehtësuese për t'i mbështetur bizneset që zhvillojnë aktivitetet e tyre afariste në këtë komunë, duke alokuar një fond të veçantë nga kategoria e mallrave dhe shërbimeve si dhe nga kategoria e subvencioneve për menaxhimin e COVID-19. Mjetet totale të alokuara arrijnë në rreth 350,000.00 euro nga kategoria e mallrave dhe shërbimeve si dhe rreth 1.1 milion euro për subvencione ku subvencionohen 1117 biznese dhe 65 OJQ në fushën e kulturës, 29 në fushën e rinisë dhe 42 në fushën e sportit. Për zbutjen e pasojave negative në ekonomi, Qeveria e Republikës së Kosovës ka ndërmarrë një sërë masash mbështetëse dhe ndihmëse përmes Pakos Emergjente Fiskale për ekonominë dhe qytetarët, por nuk ka informacion se si ndahet kjo pako sipas komunave dhe cilat janë përfitimet e Prizrenit nga kjo pako.

Në vend të përfundimeve



Sipas zyrtarëve komunalë, nuk ka pasur mjete të ndara posaçërisht për COVID-19, por të gjitha furnizimet janë siguruar nga buxheti i rregullt. Që nga shpërthimi i pandemisë, komuna e Prizrenit gjatë dy viteve të fundit ka pësuar një turrje ekonomike dhe si rrjedhojë është regjistruar një numër i madh i banorëve të papunë, krahasuar me trendin rënës që është shënuar në vitet e kaluara.

Komuna e Rahovecit



Profili i komunës

Në komunën e Rahovecit, që nga rasti i parë me COVID-19 më 24 prill 2020 deri në muajin dhjetor të vitit 2021, janë identifikuar 2159 raste me COVID-19, nga të cilët janë shëruar 2081 persona, ndërsa 78 kanë rezultuar me vdekje. Për t'i koordinuar dhe menaxhuar veprimet për parandalimin e përhapjes së pandemisë COVID-19, komuna ka ngritur Shtabin e Emergjencave, i cili ka marrë të gjitha masat mbrojtëse për parandalimin e përhapjes së pandemisë COVID-19 në përputhje me Vendimet e MSH-së dhe IKSHPK-së.



Ndikimet kryesore ekonomike dhe financiare

Ndikimi i pandemisë në bizneset dhe ekonomitë familjare në këtë komunë është evident dhe për rrjedhojë ka ulje të kërkesës së klientëve, pasiguri në investime, pamundësi për të planifikuar biznes, ofrimin e shërbimit ndaj klientit, mungesë punëtorësh për shkak të izolimit, ndërprerje të kontratave etj.



Mjedisi i biznesit

Sipas zyrtarëve të kësaj komune, sektorët më të prekur nga pandemia janë sektori i gastronomisë dhe hotelerisë, ndërtimtarisë dhe tregtisë së materialit ndërtimor; sektori i prodhimit; tregtia e tekstilit, duke përfshirë edhe industrinë e shitjes me pakicë; bujqësia etj. Bazuar në të dhënat e hulumtimit, pandemia kishte ndikuar në uljen e veprimtarisë ekonomike deri në -40%. Nga ana tjetër, është vlerësuar se pandemia ka ndikuar pozitivisht deri në 100% në lehtësimin e procedurave për hapjen e bizneseve të reja. Nga fillimi i pandemisë deri në muajin dhjetor të vitit 2021 në këtë komunë janë mbyllur gjithsej 77 biznese, prej të cilave 29 janë mbyllur gjatë vitit 2020 dhe në vitin 2021 janë mbyllur 48 biznese.



Aranzhimet ekonomike të qeverisë

Zyrtarët komunalë vlerësojnë se gjatë periudhës së pandemisë ka pasur informim dhe konsultim të ndërsjellë në mes të nivelit qendror-lokal, edhe pse nuk ka pasur komisione të formuara ndërmjet zyrtarëve qendrorë dhe lokalë. Sipas të dhënave të nxjerra nga hulumtimi, për periudhën 2020 - 2021 nuk ka pasur hartim të rregulloreve të reja, apo ndryshim të rregulloreve ekzistuese.



Tregu i punës

Sipas të dhënave të marra, viti 2020 në këtë komunë shënon rritje eksponenciale të numrit të të papunëve të regjistruar krahasuar me trendin rënës që është shënuar në vitet e mëparshme. Në vitin 2020 janë regjistruar 2208 persona si të papunë, një numër që paraqet një rritje nga viti 2019 ku kemi pasur 480 punëkërkuës të regjistruar, ndërsa në vitin 2021 kemi regjistruar 369 persona si të papunë. Nga numri i përgjithshëm i të papunëve, një përqindje e lartë e tyre është e personave të pakualifikuar dhe atyre me nivel të ulët arsimor, përkatësisht personat me shkollë fillore dhe të mesme. Gjatë vitit 2020 kjo komunë ka pasur 531 persona punëkërkuës aktiv, prej të cilëve 141 janë femra dhe 390 meshkuj, ndërsa gjatë vitit 2021, 345 persona kanë qenë punëkërkuës aktivë, prej të cilëve 152 kanë qenë femra dhe 193 meshkuj. Por sipas zyrtarëve komunal, ndikimi që ka pasur pandemia në kushtet e punës është vlerësuar pozitivisht si pagat dhe orari i punës që sipas zyrtarëve komunal ka një ndikim pozitiv prej rreth 30%.



Mjedisi financiar

Për komunën e Rahovecit edhe para pandemisë mungesa e buxhetit komunal ka qenë një sfidë e madhe. Sikurse në komunat tjera, edhe në këtë komunë gjatë vitit 2020 ka pasur rënie të të hyrave vetanake dhe të të hyrave tatimore krahasuar me vitin paraprak, por këto më pas, sipas të dhënave kërkimore janë rritur në vitin 2021 deri në 10%.



Infrastruktura, shërbimet bazike dhe lidhshmëria

Sa i përket shërbimeve të ujit, sipas të dhënave nga hulumtimi në komunën e Rahovecit kanë qenë në nivel të kënaqshëm, shërbim ky që nuk është prekur nga situata e pandemisë, ngjashëm me menaxhimin e mbeturinave. Zyrtarët komunalë kanë deklaruar se kanë ofruar shërbime sociale si para pandemisë, ku është ofruar ndihmë për qytetarët, veçanërisht ata me status të ulët social-ekonomik. Shërbimet sanitare janë ofruar edhe gjatë periudhës së pandemisë, ku në vazhdimësi është bërë pastrimi dhe dezinfektimi i objekteve-institucioneve publike, objekteve kolektive, hyrje/daljeve të banesave, objekteve afariste, pastrim-larja e rrugëve dhe shesheve. Të gjitha familjet dhe individët e prekur nga COVID-19, kanë pasur kujdes shëndetësor dhe social, gjithashtu janë pajisur me pako ushqimore-sanitare dhe si rrjedhojë e kësaj kujdesi shëndetësor ka qenë i përhershëm. Të gjithë qytetarët kanë pasur mundësi të marrin shërbimet bazë në institucionet arsimore përmes mësimi online. Në të gjitha vendbanimet, edhe pse në kohë pandemie, grumbullimi i mbeturinave bëhej sipas planit operativ në të gjithë komunën. Ndërkohë, sa i përket shërbimeve të transportit, zonat rurale në këtë komunë nuk kishin qasje të plotë në këtë shërbim.

Dimensionet	Gjetjet kryesore
Mjedisi i biznesit	Sektorët më të prekur nga pandemia janë sektori i gastronomisë dhe hotelerisë, ndërtimitarisë dhe tregtisë së materialit ndërtimor; sektori i prodhimit; tregtia e tekstilit, duke përfshirë edhe industrinë e shitjes me pakicë; bujqësia etj.
Aranzhimet ekonomike të qeverisë	Komuna ka bashkëpunuar ngushtë me nivelin qendror, përkatësisht me Ministrinë e Shëndetësisë, për hapat e ndërmarrë.
Tregu i punës	Në vitin 2020, 2208 persona janë regjistruar si të papunë, ndërsa në vitin 2021, 369 persona janë regjistruar si të papunë. Gjatë vitit 2020, kjo komunë ka pasur 531 persona punëkërkuar aktivë, prej të cilëve 141 janë femra dhe 390 meshkuj, ndërsa gjatë vitit 2021 punëkërkuar aktivë kanë qenë 345 persona, prej të cilëve 152 femra dhe 193 meshkuj.
Mjedisi financiar	Gjatë vitit 2020 ka pasur rënie të të hyrave vetanake dhe të të hyrave tatimore krahasuar me vitin paraprak, por këto më pas, sipas të dhënave të hulumtimit kanë shënuar rritje në vitin 2021.
Infrastruktura, shërbimet bazike dhe lidhshmëria	Shërbimet e kujdesit shëndetësor, ujit të pijshëm, grumbullimit të mbeturinave dhe ato sanitare kanë qenë në nivel të kënaqshëm në zonën urbane, ndërsa për shërbimet e transportit, disa zona rurale kanë qenë më të prekura.



Reagimi ndaj krizës dhe masat e rimëkëmbjes

Për shkak të buxhetit të vogël komunal, komuna e Rahovecit ka ndërmarrë disa masa zbutëse për t'i ndihmuar bizneset, siç janë lirimi nga tatimet komunale, lirimi nga qiraja në pronat dhe objektet komunale, lirimi i hapësirave të jashtme në pronat komunale, përmes organizatave të huaja dhe me mbështetjen financiare të ministrive të linjës për bizneset. Komuna nuk ka një strategji komunale për një rimëkëmbje gjithëpërfshirëse për të pasur qëndrueshmëri ekonomike, por kërkon që qeveria qendrore apo donatori të sigurojë një kod buxhetor për të pasur një ekonomi komunale më të qëndrueshme për t'i ndihmuar bizneset dhe qytetarët që të kemi një stabilitet më të mirë ekonomik dhe social.

Në vend të përfundimeve




Duke pasur parasysh natyrën e panjohur të virusit COVID-19 dhe paqartësitë për zhvillimet e ardhshme, zyrtarët e kësaj komune e kanë konsideruar thelbësore që komuna ta ruajë rolin e saj dinamik dhe koordinimin efektiv me nivelin qendror për të siguruar një shoqëri më të shëndetshme.





Komuna e Ranillugut



Profili i komunës

Në komunën e Ranillugut nuk kanë dhënë informacione lidhur me numrin e pacientëve të identifikuar, të shëruar dhe të vdekur nga pandemia COVID-19 gjatë viteve 2020 dhe 2021. Për t'i koordinuar dhe menaxhuar veprimet për parandalimin e përhapjes së pandemisë COVID-19, Komuna ka ngritur Shtabin Emergjent, i cili ka marrë të gjitha masat mbrojtëse për parandalimin e përhapjes së pandemisë COVID-19.



Ndikimet kryesore ekonomike dhe financiare

Komuna e Ranillugut është një komunë e vogël rurale me 5000 banorë, me fokus zhvillimor në dy sektorë kryesorë që janë hoteleria dhe gastronomia. Gjatë pandemisë më së shumti janë prekur këta dy sektorë, gjë që ka ndikuar edhe në rritjen e shkallës së papunësisë në këtë komunë. Gjithashtu, kjo komunë është përballur me probleme si kushtet e këqija në qendrat shëndetësore, investimet e pamjaftueshme në zhvillimin ekonomik lokal etj.



Mjedisi i biznesit

Të dhënat tregojnë se si në shumicën e komunave të tjera të vogla në Kosovë, edhe në këtë komunë më i prekur është sektori privat. Ndonëse zyrtarët e kësaj komune thonë se kriza e pandemisë ka ndikuar negativisht në zhvillimin e bizneseve të tjera, nuk kanë të dhëna zyrtare se sa biznese janë mbyllur gjatë kësaj periudhe. Sipas zyrtarëve komunalë, pandemia kishte ndikuar në uljen e vepërimtarisë ekonomike deri në -20%. Nga ana tjetër, është vlerësuar se pandemia ka ndikuar pozitivisht deri në 45% në lehtësimin e procedurave për hapjen e bizneseve të reja. Për shkak të pandemisë, ka pasur disa nga bizneset që janë mbyllur, më së shpeshti nga sektori i shërbimeve, me 5% krahasuar me periudhën para pandemisë.



Aranzhimet ekonomike të qeverisë

Sipas zyrtarëve të kësaj komune, të gjitha institucionet lokale përgjegjëse për zbatimin e masave kundër COVID-19 në nivel lokal kanë treguar bashkëpunim të lartë. Ky bashkëpunim ka lehtësuar punën për operatorët ekonomikë në komunë dhe zhvillimin e tyre ekonomik.



Tregu i punës

Sipas të dhënave të hulumtimit, punësimi në këtë komunë ka rënë ndjeshëm gjatë pandemisë, ndërsa sektorët më të prekur janë sektorët e gastronomisë, hotelarisë dhe industrisë së shitjes me pakicë. Ngjashëm me situatën e bizneseve, komuna nuk ka të dhëna për numrin e punëkërkuesve apo atyre që kanë humbur punën gjatë kësaj periudhe. Sipas zyrtarëve komunalë, pandemia ka ndikuar negativisht në shkallën e papunësisë deri në -30%, ndërsa ndikimin më të madh negativ, rreth -30%, e ka sidomos papunësia e grave dhe të rinjve.



Mjedisi financiar

Sipas përgjigjeve të zyrtarëve të komunës së Ranillugut, pjesa më e madhe e buxhetit të kësaj komune përbëhet nga grantet qeveritare dhe vetëm një përqindje e vogël e buxhetit komunal përbëhet nga të hyrat komunale. Gjatë vitit të parë të pandemisë ka pasur rënie të të hyrat vetanake dhe të hyrat tatimore krahasuar me vitin paraprak, por këto më pas, sipas të dhënave të hulumtimit janë rritur në vitin 2021 rreth 70% nga të hyrat vetanake dhe 30% nga të hyrat tatimore.



Infrastruktura, shërbimet bazike dhe lidhshmëria

Për sa i përket furnizimit me ujë të pijshëm gjatë viteve 2020 dhe 2021 ka qenë në nivel të kënaqshëm, shërbim ky që nuk është prekur nga situata e pandemisë, ngjashëm me këtë edhe menaxhimi i mbeturinave. Sa i përket shërbimeve të transportit, komuna nuk ka shërbim taksi apo stacion autobusi, por vetëm stacione që përdoren nga të gjithë banorët që kanë nevojë për transport. Gjithashtu gjatë kësaj periudhe ka pasur rritje të numrit të kërkesave për ofrimin e shërbimeve të nevojshme sociale të ofruara nga Sektori i Shërbimeve Sociale ndërkohë që 16,98% e familjeve në territorin e komunës janë përfituese të ndihmës sociale. Të gjithë qytetarët e kësaj komune kanë pasur mundësi t'i marrin shërbimet bazë në institucionet arsimore përmes mësimin online.

Dimensionet	Gjetjet kryesore
Mjedisi i biznesit	Më i prekur është sektori privat, dhe ka pasur disa nga bizneset që janë mbyllur, më së shpeshti nga sektori i shërbimeve, me 5% krahasuar me periudhën para pandemisë.
Aranzimet ekonomike të qeverisë	Bashkëpunim me të gjitha komunat e veriut të Kosovës, dhe me të gjitha institucionet lokale, por ka munguar komunikimi me nivelin qendror.
Tregu i punës	Të gjithë sektorët, si gastronomia, hoteleria dhe industria e shitjes me pakicë etj., janë prekur.
Mjedisi financiar	Gjatë vitit 2020 ka pasur rënie të të hyrave vetanake dhe të të hyrave tatimore krahasuar me vitin paraprak, por këto më pas, sipas të dhënave të hulumtimit kanë shënuar rritje në vitin 2021.
Infrastruktura, shërbimet bazike dhe lidhshmëria	Shërbimet e kujdesit shëndetësor, ujit të pijshëm, grumbullimit të mbeturinave dhe ato sanitare kanë qenë në nivel të kënaqshëm në zonën urbane, ndërsa sa i përket transportit disa zona rurale janë më të prekura.



Reagimi ndaj krizës dhe masat e rimëkëmbjes

Mbështetja e komunës është e përqendruar kryesisht në dhënien e ndihmës për shtresat më të cenueshme të popullatës përmes ofrimit të mjeteve dhe barnave të nevojshme mjekësore, ushqimit dhe mjeteve thelbësore të funksionimit gjatë karantinës. Janë miratuar masa dhe lehtësime të ndryshme për sektorin ekonomik për t'i stimuluar bizneset në një periudhë krize si vendimi për lirim nga tatimet dhe qiratë komunale të bizneseve për të gjitha bizneset që operojnë në këtë komunë, mirëmbajtja dhe dezinfektimi i hapësirave publike dhe objekteve që përdoren për aktivitete biznesi formale dhe joformale (si rrugët, sheshet publike, tregjet komunale, etj.).

Në vend të përfundimeve



Komuna e Ranillugut nuk ka miratuar plan për menaxhimin e krizave. Sipas zyrtarëve të kësaj komune, në kuadër të planit të rimëkëmbjes, fokusi kryesor duhet të jetë mbështetja për sektorin e gastronomisë, si sektori kryesor që operon në këtë komunë.

Komuna e Shtërpçës



Profili i komunës

Në komunën e Shtërpçës, nga rasti i parë me COVID-19 në muajin mars 2020 deri në muajin dhjetor të vitit 2021, janë identifikuar 576 raste me COVID-19, prej të cilave 547 janë shëruar, dhe 29 kanë rezultuar me vdekje. Vlen të theksohet se këto të dhëna raportohet se janë mbledhur nga 'të dyja' sistemet funksionale kosovare dhe serbe në këtë komunë. Kështu, nga Sistemi Shëndetësor i Kosovës 95 raste janë raportuar pozitivë me COVID-19, prej të cilëve 3 janë raportuar si të vdekur. Ndërsa numri i atyre që kanë kërkuar mbështetje nga sistemi shëndetësor i Serbisë është dukshëm më i lartë, kështu që këtu 481 persona kanë rezultuar pozitivë me COVID-19, prej të cilave 26 janë regjistruar me pasojë vdekjen. Për t'i koordinuar dhe menaxhuar veprimet për parandalimin e përhapjes së pandemisë COVID-19, komuna ka ngritur Shtabin e Emergjencave, i cili ka marrë të gjitha masat mbrojtëse për parandalimin e përhapjes së pandemisë COVID-19 në përputhje me vendimet e MSH-së dhe IKSHPK-së.



Ndikimet kryesore ekonomike dhe financiare

Papunësia është një nga problemet kryesore me të cilat po ballafaqohet komuna e Shtërpçës për shumë vite. Për faktin se kjo komunë ka sektorin më të zhvilluar të hotelerisë, kriza e pandemisë ka prekur më së shumti këtë sektor në të cilin janë humbur shumë vende pune.



Mjedisi i biznesit

Të dhënat tregojnë se si në shumicën e komunave të tjera të vogla në Kosovë, edhe në këtë komunë sektorët më të prekur janë hoteleria, gastronomia, turizmi, shërbimi i ushqimit (katering), aktivitetet shërbyese etj. Ndonëse zyrtarët e kësaj komune thonë se kriza pandemike ka ndikuar negativisht në zhvillimin e bizneseve të tjera, nuk kanë të dhëna zyrtare se sa biznese janë mbyllur gjatë kësaj periudhe, por sipas tyre, pandemia ka ndikuar negativisht në mbylljen e bizneseve deri në -5%.



Aranzhimet ekonomike të qeverisë

Menaxhimi i situatës, nga niveli qendror, sipas tyre është bërë ad-hoc, pa një strategji konkrete. Ndryshimi i vazhdueshëm i masave dhe keqinterpretimi i tyre nga autoritetet ka krijuar më shumë probleme në zbatimin e masave. Ka pasur një bashkëpunim me të gjitha komunat e veriut të Kosovës dhe me të gjitha institucionet lokale.



Tregu i punës

Nga të dhënat e hulumtimit, punësimi në këtë komunë ka rënë ndjeshëm gjatë pandemisë, ndërsa sektorët më të prekur janë hoteleria, gastronomia, turizmi, shërbimi i ushqimit (katering), aktivitetet e shërbyese, etj. Ngjashëm me situatën e bizneseve, komuna nuk ka të dhëna për numrin e punëkërkesve apo atyre që kanë humbur punën gjatë kësaj periudhe, por sipas zyrtarëve komunalë, pandemia ka ndikuar negativisht në shkallën e papunësisë deri në -50%, ndërsa ndikimi më i madh negativ, rreth -55%, bie sidomos tek papunësia e të rinjve.



Mjedisi financiar

Sipas përgjigjeve të zyrtarëve të komunës së Shtërpcës, pjesa më e madhe e buxhetit të kësaj komune përbëhet nga grantet qeveritare dhe vetëm një përqindje e vogël e buxhetit komunal përbëhet nga të hyrat komunale. Gjatë vitit të parë të pandemisë ka pasur rënie të të hyrave vetanake dhe të të hyrave tatimore krahasuar me vitin paraprak, por këto më pas, sipas të dhënave të hulumtimit janë rritur në vitin 2021.



Infrastruktura, shërbimet bazike dhe lidhshmëria

Sa i përket furnizimit me ujë të pijshëm, kjo komunë ka pasur problem për shkak të ndërtimit të një mini hidrocentrali. Sa i përket shërbimeve të transportit, gjatë krizës së pandemisë ky shërbim ka qenë më i reduktuar për disa fshatra të zonave rurale të komunës. Gjithashtu, gjatë kësaj periudhe ka pasur rritje të numrit të kërkesave për ofrimin e shërbimeve të nevojshme sociale të ofruara nga Sektori i Shërbimeve Sociale. Të gjithë qytetarët e kësaj komune kanë pasur mundësi t'i marrin shërbimet bazë në institucionet arsimore përmes mësimin online.

Dimensionet	Gjetjet kryesore
Mjedisi i biznesit	Sektorët më të prekur janë hoteleria, gastronomia, turizmi, shërbimi i ushqimit (katering), aktivitetet shërbyese, etj.
Aranzimet ekonomike të qeverisë	Bashkëpunim me të gjitha komunat e veriut të Kosovës, dhe me të gjitha institucionet lokale, por ka munguar komunikimi me nivelin qendror.
Tregu i punës	Sektorët më të prekur janë hoteleria, gastronomia, turizmi, shërbimi i ushqimit (katering), aktivitetet shërbyese, etj.
Mjedisi financiar	Gjatë vitit 2020 ka pasur rënie të të hyrave vetanake dhe të të hyrave tatimore krahasuar me vitin paraprak, por këto më pas, sipas të dhënave të hulumtimit kanë shënuar rritje në vitin 2021.
Infrastruktura, shërbimet bazike dhe lidhshmëria	Shërbimet e kujdesit shëndetësor, ujit të pijshëm, grumbullimit të mbeturinave dhe ato sanitare kanë qenë në nivel të kënaqshëm në zonën urbane, ndërsa sa i përket transportit disa zona rurale janë më të prekura.



Reagimi ndaj krizës dhe masat e rimëkëmbjes

Komuna ka ndihmuar sektorin e hotelerisë dhe bujqësisë përmes bashkëpunimit me sektorin joqeveritar. Mbështetja e komunës në aspektin e bizneseve është fokusuar kryesisht në vendimin për lirim nga tatimet dhe qiranë komunale të bizneseve për të gjitha bizneset që operojnë në këtë komunë, mirëmbajtjen dhe dezinfektimin e hapësirave publike dhe objekteve që përdoren për aktivitete biznesi formale dhe joformale (si p.sh. si rrugë, sheshe publike, tregje të komunës, etj.), mbështetje e synuar në formën e granteve ose asistencës teknike për t'i mbështetur inovacionet për reagimin ndaj COVID-19 dhe rimëkëmbjen, etj.

Në vend të përfundimeve



Duke qenë se edhe para pandemisë, kjo komunë përballëj me një situatë të vështirë ekonomike, kriza e pandemisë vetëm sa e ka përkeqësuar ekonominë. Sektori privat dhe bizneset e vogla janë më të prekurat.

Komuna e Shtimes



Profili i komunës

Në komunën e Shtimes, nga rasti i parë me COVID-19 në muajin mars të vitit 2020 deri në muajin dhjetor të vitit 2021, janë identifikuar 1958 raste me COVID-19, prej të cilave 1924 janë shëruar dhe 34 kanë rezultuar me vdekje. Për t'i koordinuar dhe menaxhuar veprimet për parandalimin e përhapjes së pandemisë COVID-19, komuna ka ngritur Shtabin e Emergjencave, i cili ka marrë të gjitha masat mbrojtëse për parandalimin e përhapjes së pandemisë COVID-19 në përputhje me Vendimet e MSH-së dhe IKSHPK-së.



Ndikimet kryesore ekonomike dhe financiare

Sfidë për komunën e Shtimes, para shpërthimit të pandemisë ishte gjendja e keqe ekonomike me një numër të madh të papunëve. Gjatë krizës së pandemisë, menaxhimi i projekteve dhe mbledhja e të hyrave u vështirësuan, u rrit numri i familjeve me asistencë sociale sepse familjet që ishin të varura nga sektori i ndërtimit, për shembull, kur humbën punën gjatë pandemisë, u identifikuan si familje në nevojë për ndihmë sociale.



Mjedisi i biznesit

Të dhënat tregojnë se si në shumicën e komunave tjera të vogla në Kosovë, edhe në këtë komunë sektorët më të prekur janë gastronomia, ndërtimtaria, industria e shitjes me pakicë, sallonet e bukurisë etj. Edhe pse zyrtarët e kësaj komune thonë se kriza e pandemisë ka ndikuar negativisht në zhvillimin e bizneseve tjera, nuk kanë të dhëna zyrtare se sa biznese janë mbyllur gjatë kësaj periudhe. Por sipas zyrtarëve komunalë, pandemia ka ndikuar negativisht në mbylljen e bizneseve deri në -7% dhe ka ndikuar në uljen e veprimtarisë ekonomike deri në -10%.



Aranzimet ekonomike të qeverisë

Mekanizmat e bashkëpunimit në nivel lokal dhe qendror kanë qenë informimi dhe konsultimi i ndërsjellë. Gjithashtu, sipas zyrtarëve komunalë, kjo komunë ka mbajtur takime me nivelin qendror lidhur me bashkëpunimin e nivelit lokal dhe atij qendror për masat që do të ndërmerren, për të mbështetur menaxhimin e situatës dhe ruajtjen e shëndetit publik.



Tregu i punës

Sipas të dhënave të hulumtimit, punësimi në këtë komunë ka rënë ndjeshëm gjatë pandemisë, ndërsa sektorët më të prekur janë sektorët e ndërtimit, prodhimit, industrisë së shitjes me pakicë dhe gastronomisë. Ngjashëm me situatën e bizneseve, komuna nuk ka të dhëna për numrin e punëkërkuesve apo atyre që kanë humbur punën gjatë kësaj periudhe. Por në bazë të të dhënave të marra nga zyrtarët komunalë, pandemia ka ndikuar negativisht në shkallën e papunësisë deri në -11%, ndërsa ndikimi më i madh negativ, rreth -10%, bie sidomos mbi papunësinë e grave dhe të rinjve.



Mjedisi financiar

Sipas përgjigjeve të zyrtarëve të komunës së Shtimes, si shumica e komunave të vogla, ka buxhet të vogël komunal. Gjatë vitit të parë të pandemisë ka pasur rënie të të hyrave vetanake dhe të të hyrave tatimore krahasuar me vitin paraprak, por këto më pas, sipas të dhënave të hulumtimit janë rritur në vitin 2021.



Infrastruktura, shërbimet bazike dhe lidhshmëria

Për sa i përket furnizimit me ujë të pijshëm gjatë viteve 2020 dhe 2021, ka qenë në nivel të kënaqshëm, shërbim ky që nuk është prekur nga situata e pandemisë, ngjashëm me këtë edhe menaxhimi i mbeturinave. Sa i përket shërbimeve të transportit, gjatë krizës së pandemisë ky shërbim ka qenë më i reduktuar për disa fshatra të zonave rurale të komunës. Sipas të dhënave nga zyrtarët komunalë, pandemia ka ndikuar negativisht që llogaritet të jetë rreth -10% në qasjen në transport dhe mobilitet. Gjithashtu, gjatë kësaj periudhe ka pasur rritje të numrit të kërkesave për ofrimin e shërbimeve të nevojshme sociale të ofruara nga Sektori i Shërbimeve Sociale. Të gjithë qytetarët e Shtimes kanë pasur mundësi t'i marrin shërbimet bazë në institucionet arsimore përmes mësimin online..

Dimensionet	Gjetjet kryesore
Mjedisi i biznesit	Më të prekurit janë sektori i gastronomisë, mbarështimi i kuajve, tregtia me pakicë, sallonet e bukurisë etj.
Aranzimet ekonomike të qeverisë	Komuna ka bashkëpunuar ngushtë me nivelin qendror, gjegjësisht me Ministrinë e Shëndetësisë për qeverisjen korporative.
Tregu i punës	Sektorët më të prekur janë bujqësia, prodhimi, tregtia me pakicë dhe sektori gastronomik.
Mjedisi financiar	Gjatë vitit 2020 ka pasur rënie të të ardhurave vetanake dhe të të ardhurave nga blerjet në nduo për një vit të çmendur, por të njëjtat janë edhe atëherë, sipas të dhënave të Istriženje, në vitin 2021.
Infrastruktura, shërbimet bazike dhe lidhshmëria	Kujdesi shëndetësor, uji i pijshëm, uji i grumbulluar, shërbimet sanitare janë në nivel të artë në periudhën urbane, ndërsa në fushën e transportit disa zona rurale janë më të kapura.



Reagimi ndaj krizës dhe masat e rimëkëmbjes


Mbështetja e komunës në aspektin e bizneseve është fokusuar kryesisht në vendimin për lirimin nga taksat dhe qiratë komunale të bizneseve për të gjitha bizneset që operojnë në këtë komunë, mirëmbajtjen dhe dezinfektimin e hapësirave publike dhe objekteve që përdoren për aktivitete biznesi formale dhe joformale (si p.sh. si rrugë, sheshe publike, tregje të komunës etj.), mbështetje e synuar në formën e granteve apo asistencës teknike për të mbështetur inovacionet për reagimin dhe rimëkëmbjen ndaj COVID-19 etj. Gjithashtu, shumë biznese janë ndihmuar financiarisht nga komuna, ku shumica e subvencioneve i ndahen bujqësisë (e prekur nga pandemia dhe breshri).

Në vend të përfundimeve



Roli i pushtetit lokal në komunën e Shtimes ka qenë më shumë zbatimi i vendimeve qendrore dhe mbulimi dhe menaxhimi i situatave me kapacitetet e veta njerëzore, financiare dhe logjistike. Ndërkohë, nuk ka një plan afatgjatë për rimëkëmbjen ekonomike përveç masave të marra deri më tani sipas kompetencave dhe mjeteve të veta financiare në dispozicion.

Komuna e Skenderajt



Profili i komunës

Komuna e Skenderajt nuk ka dhënë informacione lidhur me numrin e pacientëve të identifikuar, të shëruar dhe të vdekur nga pandemia COVID-19 gjatë viteve 2020 dhe 2021. Për të koordinuar dhe menaxhuar veprimet për parandalimin e përhapjes së pandemisë COVID-19, komuna ka themeluar Shtabin Emergjent, i cili ka ndërmarrë të gjitha masat mbrojtëse për parandalimin e përhapjes së pandemisë COVID-19 në përputhje me vendimet e MSH-së dhe ISHPK-së.



Ndikimet kryesore ekonomike dhe financiare

Edhe para pandemisë, Komuna e Skenderajt është përballur me një numër të madh sfidash, duke filluar nga zhvillimi i dobët ekonomik, veçanërisht në bizneset e bujqësisë, prodhimit dhe shërbimeve. Shumë biznese janë të varura nga diaspora në stinën e verës, por shfaqja e pandemisë dhe fillimi i periudhës së masave të izolimit e përkeqësuan edhe më shumë situatën.



Mjedisi i biznesit

Komuna e Skenderajt, sipas hulumtimit, para pandemisë ka pasur rreth 600 biznese aktive dhe gjatë periudhës së pandemisë nuk janë mbyllur por janë pezulluar për shkak të mos zhvillimit të aktiviteteve, të cilat tashmë janë në gjendje të rëndë përkundër subvencioneve të marra nga niveli lokal dhe qendror. Gjatë kësaj periudhe, për shkak të masave të qeverisë dhe nivelit lokal për rimëkëmbje, ka vazhduar hapja e bizneseve të reja, kryesisht bizneseve fillestare të cilat kanë marrë grante nga komuna.



Aranzhimet ekonomike të qeverisë

Sipas zyrtarëve komunal të Skenderajt, deri më tani ka pasur një bashkëpunim të mirë në nivel lokal dhe qendror, ku si lehtësues në këtë bashkëpunim vlerësohet të jetë AKK-ja. Sipas tyre, gjatë kësaj periudhe të pandemisë ka informacione dhe konsultime në baza mujore.



Tregu i punës

Sipas të dhënave të hulumtimit nga komuna e Skenderajt, pasi që ekonomia lokale dominohet nga bizneset individuale, dhe mikro-bizneset të cilat janë goditur nga gjendja e pandemisë, sektorët që janë më të prekur sa i përket shkallës së punësimit janë gastronomia, tekstili, ndërtimtaria, industria e shitjes me pakicë, rrobaqepësia, sallonet e bukurisë etj. Megjithatë, nuk ka të dhëna zyrtare për numrin e të punësuarve dhe punëkërkesve gjatë periudhës së pandemisë.



Mjedisi financiar

Ngjashëm me komunat tjera, edhe në komunën e Skenderajt gjatë vitit 2020 ka pasur rënie të të hyrave vetanake dhe të të hyrave tatimore në krahasim me vitin paraprak, por këto më pas, sipas të dhënave të hulumtimit kanë shënuar rritje në vitin 2021.



Infrastruktura, shërbimet bazike dhe lidhshmëria

Për shërbimet e kujdesit shëndetësor, zonat rurale larg objekteve shëndetësore kanë qenë më të prekura gjatë pandemisë pasi shërbimet e transportit publik kanë qenë më të kufizuara gjatë kësaj periudhe dhe në shumicën e rasteve qytetarët janë detyruar ta përdorin transportin privat. Sa i përket shërbimeve të ujit edhe para pandemisë ka pasur probleme pasi jo të gjithë banorët janë të kyçur në rrjetin e ujësjellësit të komunës. Situata ka qenë e njëjtë edhe me shërbimet sanitare dhe grumbullimin e mbeturinave, të cilat kanë qenë më problematike për banorët që jetojnë në zona të izoluar.

Dimensionet	Gjetjet kryesore
Mjedisi i biznesit	Rreth 600 biznese aktive dhe gjatë periudhës së pandemisë nuk janë mbyllur por janë pezulluar, të cilat tashmë janë në gjendje të rëndë pavarësisht subvencioneve të marra nga niveli lokal dhe qendror.
Aranzhimet ekonomike të qeverisë	Mekanizmat e bashkëpunimit në nivel lokal dhe qendror kanë qenë informimi dhe konsultimi i ndërsjellë.
Tregu i punës	Sektorët që preken më shumë sa i përket shkallës së punësimit janë gastronomia, tekstili, ndërtimtaria, industria e shitjes me pakicë, rrobaqepësia, sallonet e bukurisë etj.
Mjedisi financiar	Gjatë vitit 2020 ka pasur rënie të të hyrave vetanake dhe të të hyrave tatimore krahasuar me vitin paraprak, por këto më pas, sipas të dhënave të hulumtimit kanë shënuar rritje në vitin 2021.
Infrastruktura, shërbimet bazike dhe lidhshmëria	Shërbimet e kujdesit shëndetësor, grumbullimit të mbeturinave, ujit të pijshëm, sanitare dhe transportit kanë qenë në nivel të kënaqshëm në zonën urbane ndërsa disa nga zonat rurale janë më të prekura.



Reagimi ndaj krizës dhe masat e rimëkëmbjes

Gjatë krizës së pandemisë, Komuna e Skenderajt, brenda mundësive buxhetore, ka shfrytëzuar të gjitha kapacitetet e saja të mundshme, si për mbështetjen e bizneseve ku është bërë liri nga tatimet komunale për shfrytëzimin e objekteve të jashtme, mirëmbajtjen dhe dezinfektimin e hapësirave publike dhe objektet e përdorura për aktivitete biznesi formale dhe joformale (të tilla si rrugët, sheshet publike, tregjet e komunës, etj.), mbështetjen e synuar në formën e granteve ose asistencës teknike për t'i mbështetur inovacionet për reagimin ndaj COVID-19. Gjatë periudhës së pandemisë, u shpërndanë pako emergjente për të gjitha familjet në nevojë dhe për ata që u prek biznesi i tyre familjar, për ato familje të prekura nga COVID-19 etj.

Në vend të përfundimeve



Duke qenë se edhe para pandemisë kjo komunë përballëj me një situatë të vështirë ekonomike, pandemia vetëm sa e përkeqësoi situatën. Sektori privat dhe bizneset e vogla janë më të prekurit.

Komuna e Suharekës



Profili i komunës

Në komunën e Suharekës, nga rasti i parë me COVID-19 në muajin mars të vitit 2020 deri në muajin dhjetor të vitit 2021, janë identifikuar 3061 raste me COVID-19, prej të cilave 2962 janë shëruar, ndërsa 99 kanë rezultuar me vdekje. Për t'i koordinuar dhe menaxhuar veprimet për parandalimin e përhapjes së pandemisë COVID-19, komuna ka ngritur Shtabin e Emergjencave, i cili ka marrë të gjitha masat mbrojtëse për parandalimin e përhapjes së pandemisë COVID-19 në përputhje me Vendimet e MSH-së dhe IKSHPK-së.



Ndikimet kryesore ekonomike dhe financiare

Situata e rëndë ekonomike dhe sociale dhe niveli i lartë i papunësisë janë theksuar si dy nga problemet kryesore me të cilat ballafaqohet komuna e Suharekës edhe para fillimit të krizës së pandemisë. Gjithashtu, kjo komunë është përballur në vazhdimësi me përmytje që kanë shkaktuar dëme të mëdha për bizneset, kryesisht në sektorin e bujqësisë.



Mjedisi i biznesit

Sipas zyrtarëve të kësaj komune, gjatë pandemisë në komunën e Suharekës janë prekur pothuajse të gjithë sektorët e fushës së biznesit, si gastronomia, tekstili, ndërtimtaria, rrobaqepësia, sallonet e bukurisë etj. Bazuar në të dhënat e hulumtimit, pandemia ka ndikuar negativisht në mbylljen e bizneseve deri në -7% dhe ka ndikuar në uljen e veprimtarisë ekonomike deri në -16%. Në kohën e pandemisë, përkatësisht dy vitet e fundit, sipas të dhënave në këtë komunë janë mbyllur 65 biznese, të cilat janë kryesisht biznese të sektorëve si ndërtimtaria, gastronomia, sallonet e bukurisë etj. Ndërsa nga numri i përgjithshëm i i bizneseve të mbyllura, shtatë prej tyre janë drejtuar nga gra, kryesisht biznese sallonesh bukurie.



Aranzhimet ekonomike të qeverisë

Sipas zyrtarëve komunalë të Suharekës, deri më tani ka pasur një bashkëpunim të mirë në nivel lokal dhe qendror, ku si lehtësues në këtë bashkëpunim vlerësohet të jetë AKK-ja. Sipas tyre, gjatë kësaj periudhe të pandemisë ka informacione dhe konsultime në baza mujore.



Tregu i punës

Bazuar në të dhënat e hulumtimit, në këtë komunë gastronomia ka qenë një nga sektorët kryesorë që është prekur më së shumti nga masat kundër COVID-19, e cila ka rritur edhe nivelin e papunësisë duke pasur parasysh faktin se një numër i madh i të rinjve në këtë komunë janë të punësuar në këtë sektor. Sipas zyrtarëve komunalë, pandemia ka ndikuar negativisht në shkallën e papunësisë deri në -19%, ndërsa ndikimin më të madh negativ, rreth -55%, e ka sidomos papunësia e të rinjve. Megjithatë, shkalla e lartë e papunësisë në këtë periudhë të pandemisë ka prekur edhe gratë, kryesisht ato që merren me biznese të vogla, si sallone bukurie apo rrobaqepëse.



Mjedisi financiar

Ngjashëm me komunat tjera, edhe në komunën e Suharekës gjatë vitit 2020 ka pasur rënie të të hyrave vetanake dhe të të hyrave tatimore në krahasim me vitin paraprak, por këto më pas, sipas të dhënave të hulumtimit kanë shënuar rritje në vitin 2021.



Infrastruktura, shërbimet bazike dhe lidhshmëria

Për shërbimet e kujdesit shëndetësor, zonat rurale larg objekteve shëndetësore kanë qenë më të prekura gjatë pandemisë pasi shërbimet e transportit publik kanë qenë më të kufizuara gjatë kësaj periudhe dhe në shumicën e rasteve qytetarët janë detyruar ta përdorin transportin privat. Sipas të dhënave nga zyrtarët komunalë, pandemia ka ndikuar negativisht, që vlerësohet të jetë rreth -40% në qasjen në transport dhe mobilitet. Shërbimet e ujit gjatë periudhës së pandemisë janë ofruar për të gjithë banorët, por në disa pjesë kryesisht zonat rurale kanë pasur shërbime më të reduktuara. Situata ka qenë e njëjtë edhe me shërbimet sanitare ishte edhe grumbullimi i mbeturinave që kanë qenë më problematike për banorët që jetojnë në zona të izoluar.

Dimensionet	Gjetjet kryesore
Mjedisi i biznesit	U prekën thuajse të gjithë sektorët e fushës së biznesit, si gastronomia, tekstili, ndërtimtaria, rrobaqepësia, sallonet e bukurisë, etj. Ndërsa u mbyllën 65 biznese, të cilat janë kryesisht biznese të sektorëve, si ndërtimtaria, gastronomia, sallonet e bukurisë, etj.
Aranzimet ekonomike të qeverisë	Komuna ka bashkëpunuar ngushtë me nivelin qendror, përkatësisht me Ministrinë e Shëndetësisë për hapat e ndërmarrë.
Tregu i punës	Shkalla e lartë e papunësisë në këtë periudhë të pandemisë ka prekur më së shumti gratë, kryesisht ato që merren me biznese të vogla si sallone bukurie apo rrobaqepëse.
Mjedisi financiar	Gjatë vitit 2020 ka pasur rënie të të hyrave vetanake dhe të të hyrave tatimore në krahasim me vitin paraprak, por këto më pas, sipas të dhënave të hulumtimit kanë shënuar rritje në vitin 2021.
Infrastruktura, shërbimet bazike dhe lidhshmëria	Shërbimet e kujdesit shëndetësor, ujit të pijshëm, grumbullimit të mbeturinave, shërbimet sanitare dhe të transportit kanë qenë në nivel të kënaqshëm në zonat urbane, ndërsa disa zona rurale kanë qenë më të prekura.



Reagimi ndaj krizës dhe masat e rimëkëmbjes


Gjatë krizës së pandemisë, Komuna e Suharekës, brenda mundësive të saj buxhetore, ka shfrytëzuar të gjitha kapacitetet e saj të mundshme, të tilla si mbështetja e bizneseve ku është bërë lirimi nga tatimet komunale për shfrytëzimin e objekteve të jashtme, rregulloret për lehtësimin e regjistrimit dhe licencimit të biznesit, mirëmbajtja dhe dezinfektimi i hapësirave dhe objekteve publike që përdoren për aktivitete biznesi formale dhe joformale (si rrugë, sheshe publike, tregje të komunës, etj.) subvencione ushqimore për familjet në nevojë dhe rastet e COVID-19, etj. Për shkak të buxhetit të kufizuar, kjo komunë nuk është duke hartuar një plan afatgjatë rimëkëmbjeje.

Në vend të përfundimeve



Duke qenë se edhe para pandemisë, kjo komunë ballafaqohej me një situatë të vështirë ekonomike, kriza e pandemisë e ka përkeqësuar situatën ekonomike. Sektori privat dhe bizneset e vogla janë më të prekurat.

Komuna e Vitisë



Profili i komunës

Në komunën e Vitisë nuk kanë dhënë informacione lidhur me numrin e pacientëve të identifikuar, të shëruar dhe të vdekur nga pandemia COVID-19 gjatë viteve 2020 dhe 2021. Për t'i koordinuar dhe menaxhuar veprimet për parandalimin e përhapjes së pandemisë COVID-19, Komuna ka themeluar Shtabin Emergjent, i cili ka ndërmarrë të gjitha masat mbrojtëse për parandalimin e përhapjes së pandemisë COVID-19 në përputhje me vendimet e MSH-së dhe IKSHPK-së.



Ndikimet kryesore ekonomike dhe financiare

Ndikimet kryesore ekonomike dhe financiare Komuna e Vitisë edhe para pandemisë është përballur me një numër të madh sfidash, duke filluar nga mungesa e investimeve të mjaftueshme kapitale në projekte jetike për qytetarët nga niveli qendror, mungesa e mbështetjes për bizneset e reja dhe buxheti i pamjaftueshëm në nivel komunal.



Mjedisi i biznesit

Sipas zyrtarëve të kësaj komune, gjatë pandemisë në komunën e Vitisë janë prekur pothuajse të gjithë sektorët e fushës së biznesit, si gastronomia, tekstili, ndërtimtaria, rrobaqepësia, sallonet e bukurisë etj. Ndërsa janë tre biznese që janë mbyllur si pasojë e pandemisë, të cilat janë udhëhequr nga gratë në sektorin e salloneve të bukurisë dhe industrisë së shitjes me pakicë edhe pse sipas zyrtarëve komunalë numri i bizneseve të mbyllura mund të jetë edhe më i madh, por nuk kanë të dhëna zyrtare. Nga ana tjetër, është vlerësuar se pandemia ka ndikuar pozitivisht deri në 100% në lehtësimin e procedurave për hapjen e bizneseve të reja.



Aranzhimet ekonomike të qeverisë

Sipas zyrtarëve komunalë të Vitisë, deri më tani ka pasur një bashkëpunim të mirë në nivel lokal dhe qendror, ku si lehtësues në këtë bashkëpunim vlerësohet të jetë AKK-ja. Sipas tyre, gjatë kësaj periudhe të pandemisë ka informacione dhe konsultime në baza mujore.



Tregu i punës

Sipas të dhënave të hulumtimit nga komuna e Vitisë, pasi që ekonomia lokale dominohet nga bizneset individuale, dhe mikro-bizneset të cilat janë goditur nga situata pandemike, sektorët që janë më të prekur në shkallë të punësimit janë gastronomia, tekstili, ndërtimtaria, industria e shitjes me pakicë, rrobaqepësia, sallonet e bukurisë etj. Megjithatë, nuk ka të dhëna zyrtare për numrin e të punësuarve dhe punëkërkuessve gjatë periudhës së pandemisë.



Mjedisi financiar

Ngjashëm me komunat tjera, edhe në komunën e Vitisë gjatë vitit 2020 ka pasur rënie të të hyrave vetanake dhe të hyrave tatimore në krahasim me vitin paraprak, por këto më pas, sipas të dhënave të hulumtimit janë rritur në vitin 2021. Mirëpo, sipas zyrtarëve të kësaj komune, pjesa më e madhe e buxhetit përbëhet nga grantet qeveritare.



Infrastruktura, shërbimet bazike dhe lidhshmëria

Për shërbimet e kujdesit shëndetësor, zonat rurale larg objekteve shëndetësore kanë qenë më të prekura gjatë pandemisë pasi shërbimet e transportit publik kanë qenë më të kufizuara gjatë kësaj periudhe dhe në shumicën e rasteve qytetarët janë detyruar ta përdorin transportin privat. Shërbimet e ujit gjatë periudhës së pandemisë janë ofruar për të gjithë banorët, por disa pjesë, kryesisht zonat rurale, kanë pasur shërbime më të reduktuara. Situata ka qenë e njëjtë edhe me shërbimet sanitare dhe grumbullimin e mbeturinave të cilat kanë qenë më problematike për banorët që jetojnë në zona të izoluar.

Dimensionet	Gjetjet kryesore
Mjedisi i biznesit	Janë prekur pothuajse të gjithë sektorët e fushës së biznesit, si gastronomia, tekstili, ndërtimtaria, rrobaqepësia, sallonet e bukurisë, etj. Ndërsa në vitin 2021 janë mbyllur 3 biznese të drejtuara nga gratë.
Aranzhimet ekonomike të qeverisë	Komuna ka bashkëpunuar ngushtë me nivelin qendror, përkatësisht me Ministrinë e Shëndetësisë për hapat e ndërmarrë.
Tregu i punës	Sektorët që janë prekur më shumë sa i përket shkallës së punësimit janë gastronomia, tekstili, ndërtimtaria, industria e shitjes me pakicë, rrobaqepësia, sallonet e bukurisë etj.
Mjedisi financiar	Gjatë vitit 2020 ka pasur rënie të të hyrave vetanake dhe të të hyrave tatimore krahasuar me vitin paraprak, por këto më pas, sipas të dhënave të hulumtimit kanë shënuar rritje në vitin 2021.
Infrastruktura, shërbimet bazike dhe lidhshmëria	Shërbimet e kujdesit shëndetësor, ujit të pijshëm, grumbullimit të mbeturinave, sanitare dhe të transportit kanë qenë në nivel të kënaqshëm në zonën urbane, ndërsa disa zona rurale janë prekur më së shumti.



Reagimi ndaj krizës dhe masat e rimëkëmbjes


Gjatë krizës së pandemisë, Komuna e Vitisë në kuadër të mundësive të saj buxhetore ka shfrytëzuar të gjitha kapacitetet e saj të mundshme, si për mbështetjen e bizneseve ku është bërë lirimi nga tatimet komunale për shfrytëzimin e objekteve të jashtme, mirëmbajtjen dhe dezinfektimin e hapësirave dhe objekteve publike të përdorura për aktivitete afariste formale dhe joformale (të tilla si rrugët, sheshet publike, tregjet komunale, etj.), mbështetjen e synuar në formën e granteve ose asistencës teknike për t'i mbështetur inovacionet për reagimin ndaj COVID-19 dhe rimëkëmbjen dhe subvencionet ushqimore për familjet në nevojë dhe rastet me COVID -19 etj. Për shkak të buxhetit të kufizuar, kjo komunë nuk është duke hartuar një plan afatgjatë për rimëkëmbje.

Në vend të përfundimeve



Duke qenë se edhe para pandemisë, kjo komunë përballëj me një situatë të vështirë ekonomike, kriza e pandemisë vetëm sa e ka përkeqësuar situatën ekonomike. Sektori privat dhe bizneset e vogla janë më të prekurat, ndërsa kapaciteti financiar i komunës është shumë i kufizuar për t'i ndihmuar bizneset të rimëkëmben.

Komuna e Vushtrrisë



Profili i komunës

Në komunën e Vushtrrisë, nga rasti i parë me COVID-19 në muajin mars 2020 deri në muajin dhjetor 2021, janë identifikuar 4961 raste me COVID-19, prej të cilave 4820 janë shëruar, ndërsa 141 kanë rezultuar me vdekje. Për të koordinuar dhe menaxhuar veprimet për parandalimin e përhapjes së pandemisë COVID-19, Komuna ka ngritur Shtabin e Emergjencës, i cili ka marrë të gjitha masat mbrojtëse për parandalimin e përhapjes së pandemisë COVID-19 në përputhje me Vendimet e MSH-së dhe IKSHPK-së.



Ndikimet kryesore ekonomike dhe financiare

Sfidë për komunën e Vushtrrisë, para shpërthimit të pandemisë, ishte gjendja e keqe ekonomike me një numër të madh të të papunëve, kapaciteti i pamjaftueshëm për ta përballuar krizën që kishte prekur rajonin dhe më gjerë. Ndërsa me fillimin e rasteve të para dhe shtimit të numrit të të infektuarve me COVID-19, sfida kryesore ishte rëndimi i situatës ekonomike dhe sociale si pasojë e mbylljes së shumicës së bizneseve, veçanërisht në sektorët e gastronomisë dhe ndërtimitarisë.



Mjedisi i biznesit

Të dhënat tregojnë se si në shumicën e komunave të tjera të vogla në Kosovë, edhe në këtë komunë sektorët më të prekur janë gastronomia, sektori i ndërtimitarisë, industria e përpunimit, industria e shitjes me pakicë etj. Sipas statistikave të ofruara nga kjo komunë, numri i bizneseve të mbyllura në vitin 2020 - 2021 ishte 112. Nëse shikojmë për nga ndarja gjinore e bizneseve të drejtuara nga gratë, janë gjithsej 24 biznese të mbyllura për periudhën 2020-2021. Sipas zyrtarëve komunalë, në këtë komunë ka objekte gjatë hapjes së bizneseve dhe ato janë pa pagesë. Ndërkohë që vlerësohet se ekonomia joformale është pjesë e jetës afariste por është në parametra më të ulët.



Aranzimet ekonomike të qeverisë

Mekanizmat e bashkëpunimit në nivel lokal dhe qendror kanë qenë informimi dhe konsultimi i ndërsjellë. Gjithashtu, sipas zyrtarëve komunalë, kjo komunë ka mbajtur takime me nivelin qendror në lidhje me bashkëpunimin e nivelit lokal dhe atij qendror për masat që do të ndërmerren, për ta mbështetur menaxhimin e situatës dhe ruajtjen e shëndetit publik.



Tregu i punës

Sipas të dhënave nga hulumtimet, punësimi në këtë komunë ka rënë ndjeshëm gjatë pandemisë, ndërsa sektorët më të prekur janë sektorët e ndërtimit, përpunimit, industria e shitjes me pakicë dhe sektori i gastronomisë. Sipas të dhënave të Agjencisë së Statistikave të Kosovës tregohet një rritje e shpejtë e papunësisë. Më saktësisht, nga muaji mars i vitit 2020, numri i punëkërkuësve është rritur me 3126 ose rreth 40%. Punëkërkuës të regjistruar aktualisht janë 7869 persona nga të cilët 4179 meshkuj dhe 3690 femra. Nëse i referohemi Zyrës Komunale të Punësimimit, numri i përgjithshëm i të papunëve është 624 persona, nga të cilët 317 janë femra dhe 307 meshkuj.

Sa i përket punësimimit joformal në baza gjinore në Komunën e Vushtrrisë sipas vlerësimit të ndikimit socio-ekonomik të pandemisë COVID-19, aktualisht 39% e meshkujve janë të punësuar në mënyrë joformale ndërsa femrat 12%.



Mjedisi financiar

Sipas përgjigjeve të zyrtarëve të komunës së Vushtrrisë gjatë vitit të parë të pandemisë ka pasur rënie të të hyrave vetanake dhe të të hyrave tatimore krahasuar me vitin paraprak, por këto më pas, sipas të dhënave të hulumtimit kanë shënuar rritje në vitin 2021.



Infrastruktura, shërbimet bazike dhe lidhshmëria

Për sa i përket furnizimit me ujë të pijshëm gjatë viteve 2020 dhe 2021 ka qenë në nivel të kënaqshëm, shërbim ky që nuk është prekur nga situata e pandemisë, ngjashëm me këtë edhe menaxhimi i mbeturinave. Gjatë kohës së pandemisë, ata kanë pasur një ulje të ndjeshme të kohës së udhëtimit, në periudha të tjera nuk ka ndikuar në transportin dhe mobilitetin, e për pasojë nuk ka pasur zona të prekura. Gjithashtu, gjatë kësaj periudhe ka pasur rritje të numrit të kërkesave për ofrimin e shërbimeve të nevojshme sociale të ofruara nga Sektori për Shërbime Sociale. Të gjithë qytetarët e Vushtrrisë kanë pasur mundësi që t'i marrin shërbimet bazë në institucionet arsimore përmes mësimimit online.

Dimensionet	Gjetjet kryesore
Mjedisi i biznesit	Sektorët më të prekur janë gastronomia, sektori i ndërtimitarisë, industria e përpunimit, industria e shitjes me pakicë, etj. Numri i bizneseve të mbyllura në 2020 - 2021 ishte 112, nga të cilat 24 biznese të drejtuara nga gratë.
Aranzhimet ekonomike të qeverisë	Mekanizmat e bashkëpunimit në nivel lokal dhe qendror kanë qenë informimi dhe konsultimi i ndërsjellë.
Tregu i punës	Nga muaji mars i vitit 2020 numri i punëkërkuësve është rritur me 3126 ose rreth 40%. Punëkërkuës të regjistruar aktualisht janë 7869 persona, nga të cilët 4179 meshkuj dhe 3690 femra.
Mjedisi financiar	Gjatë vitit 2020 ka pasur rënie të të hyrave vetanake dhe të të hyrave tatimore krahasuar me vitin paraprak, por këto më pas, sipas të dhënave të hulumtimit, kanë shënuar rritje në vitin 2021.
Infrastruktura, shërbimet bazike dhe lidhshmëria	Shërbimet e kujdesit shëndetësor, grumbullimit të mbeturinave, ujit të pijshëm dhe ato sanitare kanë qenë në nivel të kënaqshëm ndërsa sa i përket shërbimeve të transportit, disa nga zonat rurale kanë qenë më të prekura.



Reagimi ndaj krizës dhe masat e rimëkëmbjes

Mbështetja e komunës në aspektin e bizneseve është fokusuar kryesisht në vendimin për lirimin nga tatimet dhe qiraja komunale të bizneseve për të gjitha bizneset që operojnë në këtë komunë, lirimin nga pagesa e tarifave për qëndrimin e fëmijëve në kopshtin publik, - lirimin nga pagesa të familjeve me asistencë sociale për taksën e grumbullimit të mbeturinave. Gjithashtu, shumë biznese janë ndihmuar financiarisht nga komuna, ndërsa disa prej tyre kanë aplikuar edhe për ndihmë (subvencione) në qeveri për numrin e të punësuarve dhe humbjet e shkaktuara gjatë sezonit të pandemisë.

Në vend të përfundimeve



Komuna e Vushtrrisë ka hartuar një plan për rimëkëmbjen ekonomike, por nuk ka mjete të mjaftueshme për zbatim pa ndihmën e qeverisë qendrore. Sipas zyrtarëve të kësaj komune, në kuadër të planit të rimëkëmbjes synohet që të luftohet sa më shumë informaliteti në ekonomi.

Komuna e Zubin Potokut



Profili i komunës

Komuna e Zubin Potokut nuk ka dhënë informacione lidhur me numrin e pacientëve të identifikuar, të shëruar dhe të vdekur nga pandemia COVID-19 gjatë viteve 2020 dhe 2021. Për t'i koordinuar dhe menaxhuar veprimet për parandalimin e përhapjes së pandemisë COVID-19, Komuna ka ngritur Shtabin e Emergjencës, i cili ka marrë të gjitha masat mbrojtëse për parandalimin e përhapjes së pandemisë COVID-19.



Ndikimet kryesore ekonomike dhe financiare

Komuna e Zubin Potokut, si komunë e vogël, sikurse komuna e Leposaviqit, para fillimit të pandemisë është përballur me sfida dhe probleme të shumta, si fatkeqësitë natyrore (përmytjet, rrëshqitjet e dheut, zjarret), kushtet e këqija në qendrat shëndetësore, investimet e pamjaftueshme në zhvillimin ekonomik lokal etj.



Mjedisi i biznesit

Të dhënat tregojnë se si në shumicën e komunave të tjera të vogla në Kosovë, edhe në këtë komunë më i prekur është sektori privat. Ndonëse zyrtarët e kësaj komune thonë se kriza e pandemisë ka ndikuar negativisht në zhvillimin e bizneseve të tjera, nuk kanë të dhëna zyrtare se sa biznese janë mbyllur gjatë kësaj periudhe.



Aranzhimet ekonomike të qeverisë

Sipas zyrtarëve të kësaj komune, ata kanë pasur bashkëpunim me të gjitha komunat në veri të Kosovës dhe të gjitha institucionet lokale përgjegjëse për zbatimin e masave kundër COVID-19 në nivel lokal kanë treguar nivel të lartë bashkëpunimi. Ky bashkëpunim ka lehtësuar punën për operatorët ekonomikë në komunë dhe zhvillimin e tyre ekonomik.



Tregu i punës

Sipas të dhënave të hulumtimit, punësimi në këtë komunë ka rënë ndjeshëm gjatë pandemisë, ndërsa sektorët më të prekur janë sektorët e gastronomisë, salloneve të bukurisë, industrisë së shitjes me pakicë. Ngjashëm me situatën e bizneseve, komuna nuk ka të dhëna për numrin e punëkërkuesve apo atyre që kanë humbur punën gjatë kësaj periudhe.



Mjedisi financiar

Sipas përgjigjeve të zyrtarëve të komunës së Zubin Potokut, pjesa më e madhe e buxhetit të kësaj komune përbëhet nga grantet qeveritare dhe vetëm një përqindje e vogël e buxhetit komunal përbëhet nga të hyrat komunale.



Infrastruktura, shërbimet bazike dhe lidhshmëria

Për sa i përket furnizimit me ujë të pijshëm, gjatë krizës së pandemisë ka qenë në nivel të kënaqshëm, shërbim ky që nuk është prekur nga situata e pandemisë, ngjashëm me këtë edhe menaxhimi i mbeturinave. Gjithashtu, gjatë kësaj periudhe ka pasur një rritje të numrit të kërkesave për ofrimin e shërbimeve të nevojshme sociale të ofruara nga Sektori për Shërbime Sociale. Të gjithë qytetarët e kësaj komune kanë pasur mundësi t'i marrin shërbimet bazë në institucionet arsimore përmes mësimin online.

Dimensionet	Gjetjet kryesore
Mjedisi i biznesit	Më i prekuri është sektori privat, por nuk ka të dhëna zyrtare se sa biznese janë mbyllur gjatë kësaj krize të pandemisë.
Aranzhimet ekonomike të qeverisë	Bashkëpunim me të gjitha komunat e veriut të Kosovës, dhe me të gjitha institucionet lokale, por ka munguar komunikimi me nivelin qendror.
Tregu i punës	Sektorët më të prekur janë sektorët e gastronomisë, sal-loneve të bukurisë, industrisë së shitjes me pakicë.
Mjedisi financiar	Gjatë vitit 2020 ka pasur rënie të të hyrave vetanake dhe të të hyrave tatimore krahasuar me vitin paraprak, por këto më pas, sipas të dhënave të hulumtimit kanë shënuar rritje në vitin 2021. cc
Infrastruktura, shërbimet bazike dhe lidhshmëria	Shërbimet e kujdesit shëndetësor, ujit të pijshëm, grumbullimit të mbeturinave dhe ato sanitare kanë qenë në nivel të kënaqshëm.



Reagimi ndaj krizës dhe masat e rimëkëmbjes

Mbështetja e komunës është e përqendruar kryesisht në dhënien e ndihmës për shtresat më të cenueshme të popullatës përmes ofrimit të mjeteve dhe barnave të nevojshme mjekësore, ushqimit dhe mjeteve esenciale të funksionimit gjatë karantinës. Në këtë kuptim, komuna u përpoq që t'i ofrojë mbështetje maksimale sistemit shëndetësor, si në aspektin financiar ashtu edhe në sigurimin e materialeve dhe pajisjeve të nevojshme mjekësore, e gjitha kjo në mënyrë që të sigurojë mbrojtje adekuate shëndetësore për banorët e komunës. Janë miratuar masa dhe lehtësime të ndryshme për sektorin ekonomik për ta stimuluar biznesin e tij në një periudhë krize si vendimi për lirim nga tatimet dhe qiratë komunale të bizneseve për të gjitha bizneset që operojnë në këtë komunë, mirëmbajtja dhe dezinfektimi i objekteve dhe hapësirave publike që përdoren për aktivitete afariste formale dhe joformale (si rrugët, sheshet publike, tregjet komunale, etj.).

Në vend të përfundimeve



Komuna e Zubin Potokut nuk ka miratuar plan për menaxhimin e krizave, por sipas zyrtarëve të kësaj komune, për një rimëkëmbje të qëndrueshme duhet të zhvillojnë plane veprimi në situata krize. Ata theksuan gjithashtu nevojën e thellimit të bashkëpunimit të ndërsjellë të të gjithë akterëve në kohën e duhur për t'i mbrojtur dhe adresuar sfidat e paraqitura nga COVID-19.

Komuna e Zveçanit



Profili i komunës

Në komunën e Zveçanit, nga rasti i parë me COVID-19 në vitin 2020 deri në muajin dhjetor të vitit 2021, janë identifikuar 2155 raste me COVID-19, prej të cilave 2426 janë shëruar, dhe 29 (18 burra dhe 11 gra) kanë rezultuar me vdekje. Për t'i koordinuar dhe menaxhuar veprimet për parandalimin e përhapjes së pandemisë COVID-19, Komuna ka ngritur Shtabin Emergjent, i cili ka marrë të gjitha masat mbrojtëse për parandalimin e përhapjes së pandemisë COVID-19.



Ndikimet kryesore ekonomike dhe financiare

Bazuar në të dhënat e marra, sfida më e madhe me të cilën ballafaqohet Komuna e Zveçanit para pandemisë (por edhe gjatë krizës së pandemisë është buxheti joad-ekuat i qeverisë për komunat në veri të Kosovës, i cili nuk është i mjaftueshëm për nevojat më elementare për funksionimin normal të institucionit. Kjo komunë ballafaqohet edhe me probleme tjera, si zhvillimi i dobët ekonomik dhe niveli i lartë i papunësisë.



Mjedisi i biznesit

Të dhënat tregojnë se si në shumicën e komunave të tjera të vogla në Kosovë, edhe në këtë komunë më i prekur është sektori privat. Duke qenë se në këtë komunë sektori më i zhvilluar është ai i bujqësisë, për shkak të kufizimeve buxhetore për subvencione është prekur më së shumti gjatë kësaj periudhe por edhe sektorët tjerë si sektori i shërbimit të ushqimit (kateringut), hotelarisë, shërbimit, etj. Edhe pse zyrtarët e kësaj komune thonë se kriza e pandemisë ka ndikuar negativisht në zhvillimin e bizneseve, nuk kanë të dhëna zyrtare se sa biznese janë mbyllur gjatë kësaj periudhe.



Aranzimet ekonomike të qeverisë

Sipas zyrtarëve të kësaj komune, të gjitha institucionet lokale përgjegjëse për zbatimin e masave kundër COVID-19 në nivel lokal kanë treguar një nivel të lartë bashkëpunimi por ka munguar komunikimi me nivelin qendror. Ky bashkëpunim ka lehtësuar punën për operatorët ekonomikë në komunë dhe zhvillimin ekonomik të tyre.



Tregu i punës

Sipas të dhënave të hulumtimit, punësimi në këtë komunë ka rënë ndjeshëm gjatë pandemisë, ndërsa sektorët më të prekur janë sektorët e shërbimit të ushqimit (kateringut), hotelerisë dhe shërbimit. Ngjashëm me situatën e bizneseve, komuna nuk ka të dhëna për numrin e punëkërkuessve apo atyre që kanë humbur punën gjatë kësaj periudhe.



Mjedisi financiar

Sipas përgjigjeve të zyrtarëve të komunës së Zveçanit, pjesa më e madhe e buxhetit të kësaj komune përbëhet nga grantet qeveritare dhe vetëm një përqindje e vogël e buxhetit komunal përbëhet nga të hyrat komunale.



Infrastruktura, shërbimet bazike dhe lidhshmëria

Infrastruktura, shërbimet bazike dhe lidhshmëria Shërbimet e ujit gjatë periudhës së pandemisë janë ofruar për të gjithë banorët, por në disa pjesë kryesisht zonat rurale, ka pasur shërbime më të reduktuara. E njëjta vlen edhe për shërbimet sanitare, shëndetësinë, transportin dhe grumbullimin e mbeturinave, të cilat kanë qenë më problematike për banorët që jetojnë në zona të izoluara. Ndërsa, të gjithë qytetarët e kësaj komune kanë pasur mundësi të marrin shërbimet bazë në institucionet arsimore përmes mësimi online.

Dimensionet	Gjetjet kryesore
Mjedisi i biznesit	Sektorët më të prekur janë bujqësia, sektori i shërbimit të ushqimit (kateringut), hotelerisë, shërbimit etj.
Aranzimet ekonomike të qeverisë	Bashkëpunim me të gjitha komunat e veriut të Kosovës, dhe me të gjitha institucionet lokale, por ka munguar komunikimi me nivelin qendror.
Tregu i punës	Sektorët më të prekur janë sektorët e shërbimit të ushqimit (kateringut), hotelerisë dhe shërbimit.
Mjedisi financiar	Gjatë vitit 2020 ka pasur rënie të të hyrave vetanake dhe të të hyrave tatimore krahasuar me vitin paraprak, por këto më pas, sipas të dhënave të hulumtimit kanë shënuar rritje në vitin 2021.
Infrastruktura, shërbimet bazike dhe lidhshmëria	Shërbimet e kujdesit shëndetësor, ujit të pijshëm, grumbullimit të mbeturinave dhe ato sanitare kanë qenë në nivel të kënaqshëm në zonën urbane, ndërsa sa i përket transportit, disa zona rurale janë më të prekura.



Reagimi ndaj krizës dhe masat e rimëkëmbjes

Mbështetja e komunës është e përqendruar kryesisht në dhënien e ndihmës për shtresat më të cenueshme të popullatës përmes ofrimit të mjeteve dhe barnave të nevojshme mjekësore, ushqimit dhe mjeteve esenciale të funksionimit gjatë karantinës. Në bashkëpunim me Komunën, organizatat e shoqërisë civile dhe OJQ-të lokale kanë zhvilluar një sërë zgjidhjesh që synojnë reagimin ekonomik ndaj krizës. Përveç shërbimeve këshillimore, ata ofruan ndihmë për popullatën në formën e shpërndarjes së mjeteve mbrojtëse, donacioneve të teknologjisë për monitorimin e pandërprerë të mësimdhënies online etj.

Në vend të përfundimeve



Komuna e Zveçanit nuk ka miratuar plan për menaxhimin e krizave. Sipas zyrtarëve të kësaj komune, në kuadër të planit të rimëkëmbjes, fokusi kryesor duhet të jetë mbështetja për sektorin e bujqësisë, si sektori kryesor që operon në këtë komunë.





5

KONKLuzionet DHE REKOMANDIMET

Anketat dhe punëtoritë regionale të realizuara për qëllimet e këtij studimi tregojnë përvojat e komunave gjatë krizës së COVID-19 dhe ndihmojnë në identifikimin e mësimave në formën e praktikave të dobishme.

Efektet socio-ekonomike të situatës së pandemisë COVID-19, ishin të shumta dhe të ndryshme. Si rezultat, bashkëpunimet e rregullta ndërmjet pushtetit qendror dhe atij lokal ishin praktika që të gjitha komunat i përdornin. Me qëllim të adresimit të çështjeve të tyre në mënyrë të shpejtë, Qeveria e Kosovës dhe komunat gjithashtu prezantuan mjete të ndryshme ndërveprimi, si e-platformat, rrjetet sociale, etj., për t'i mbajtur të informuar bizneset lokale dhe qytetarët. Ndikimi ekonomik dhe financiar i pandemisë ka ndikuar negativisht në të hyrat komunale – të hyrat vetanake, transferet ndërqeveritare, të hyrat tatimore dhe fondet komunale të transferuara nga buxheti i shtetit.

Megjithëse qeveria ndau fonde emergjente për komunat për t'u përballur me pandeminë, atyre iu bë presion që t'i rrisin shpenzimet publike për t'i zbutur pasojat më të këqija të krizës dhe për të siguruar ofrimin e vazhdueshëm të mallrave dhe shërbimeve publike esenciale, duke rritur gjithashtu mbështetjen për popullatat e cënueshme. Kjo nuk mund të bëhej pa riprioritizimin dhe riprogramimin e buxhetit dhe kjo nevojë preku më së shumti programet e investimeve kapitale.

Komunat ofruan një gamë të gjerë shërbimesh ekonomike dhe joekonomike, të cilat janë thelbësore për ekonominë e çdo qyteti. Periudha e pandemisë rriti nevojën për shërbime publike. Nevojiteshin objekte shëndetësore, u shumëfishuan shërbimet e pastrimit dhe dezinfektimit në objektet dhe hapësirat publike të përdorura për të kryer biznes. Vëllimi i mbështetjes socio-ekonomike për grupet e cënueshme si dhe mbështetja financiare dhe jofinanciare për bizneset ka prekur komunat. Për shkak të reduktimit të veprimtarive ekonomike, shumë njerëz humbën vendet e punës. Në situatën më të vështirë ishin veçanërisht ata jashtë punësimit në sektorin publik, apo ata që ishin të punësuar nga ndërmarrjet e vogla dhe të mesme. Gjetjet tregojnë se situata e pandemisë COVID-19 paraqiti një sfidë të paprecedentë ekonomike. Qeveria dhe komunat janë të gatshme të ndërmarrin masat e rimëkëmbjes. Por duhen ndërhyrje dhe menaxhim i duhur për ta zgjidhur këtë situatë.

Ky raport ofron një mundësi për udhëheqësit institucionalë qendrorë dhe lokalë - si dhe akterët e tjerë - të reflektojnë mbi menaxhimin e tyre, t'i identifikojnë lëshimet dhe të përmirësojnë zbatimin e masave efektive të rimëkëmbjes pas pandemisë. Tregohet se pandemia COVID-19 gjeneroi ndryshime të rëndësishme në qeverisjen lokale, sferën e biznesit dhe mënyrën e jetesës së qytetarëve të Kosovës. Kështu, mund të arrihet në përfundim se pandemia COVID-19 preku drejtpërdrejt ose tërthorazi të gjitha fushat e shoqërisë, e cila po përballlet me krizë shëndetësore dhe socio-ekonomike, si dhe me reagime të ndryshme të zbatuara nga qeverisja(-et) lokale dhe qendrore.

Sektori privat dhe bizneset e vogla janë prekur më shumë nga kriza e pandemisë. Shumë biznese janë mbyllur, si rezultat, shkalla e papunësisë është rritur, ka ndodhur kriza financiare dhe ka pasur implikime të mëdha, veçanërisht për grupet e cënueshme të popullsisë dhe familjet, disa prej të cilave tashmë janë në kufi me varfërinë.

Sa i përket masave të rimëkëmbjes, asnjë nga komunat nuk ka pasur një masë afatgjate të rimëkëmbjes nga ndikimi i pandemisë COVID-19, dhe kjo është theksuar si sfidë për të gjitha komunat. Vetëm dy komuna raportuan se kishin hartuar plane për rimëkëmbjen ekonomike. Komuna e Prishtinës ka hartuar një plan afatmesëm për rimëkëmbjen e bizneseve të vogla dhe transportit publik, ndërsa Komuna e Vushtrrisë ka hartuar një plan për rimëkëmbjen ekonomike, me qëllim, ndër të tjera, luftimin e informalitetit në ekonomi, edhe pse nuk ka fonde të mjaftueshme për zbatimin e tij. Komunat e tjera nuk po punojnë as në hartimin e planeve për masat afatgjate të rimëkëmbjes.

Gjetjet tregojnë se komunat e Kosovës nuk kishin buxhet të dedikuar për t'i adresuar problemet dhe krizën e shkaktuar nga pandemia, andaj të gjitha furnizimet ishin siguruar nga buxheti i rregullt. Subvencionet ishin më të larta në komunën e Prishtinës, kryesisht për shkak të mundësive më të mëdha se komunat tjera, por në të njëjtën kohë edhe barrës më të madhe se komunat tjera për shkak të shërbimeve dhe numrit më të madh të banorëve.

Sektori i gastronomisë është identifikuar si esencial për ekonomitë komunale, veçanërisht në ato që janë më të vogla. Prandaj, zyrtarët komunalë deklaruan se në kuadër të planit të rimëkëmbjes, fokusi kryesor duhet të jetë mbështetja për sektorin e gastronomisë. Megjithatë, dy përjashtime ishin komunat e vogla të Parteshit dhe Zveçanit që varen kryesisht nga bujqësia, mbështetja e të cilëve konsiderohej jetike për ekonomitë e tyre.

Përfaqësuesi i Shoqatës së Gastronomisë së Kosovës në Prishtinë ka identifikuar disa sfida që kanë të bëjnë me masat e rimëkëmbjes. Thuhet se 65% e bizneseve nuk kanë përfituar nga masat e pakos [emergjente] për shkak të mosregjistrimit të tyre.

Shoqata përgatiti një raport për Ministrin e Financave, Punës dhe Transfereve, por udhëzimet e përfshira në raport nuk u morën parasysh dhe qeveria nuk iu përgjigj. Si problem u identifikua edhe mungesa e inspektorëve të punës; së bashku me qeverinë që nuk mbikëqyr si duhet pagesat e destinuar për bizneset. Gjithashtu raportohet se policia ka bërë diskriminim mes bizneseve gjatë zbatimit të kufizimeve të pandemisë. Vlen të theksohet se bizneset e grave u rritën artificialisht, pasi gratë regjistronin biznese të reja vetëm për të marrë grante. Megjithatë, duke qenë se këto biznese të sapo hapura bazohen vetëm në projekte afatshkurtra që synojnë përfitimin nga subvencionet, shumica e mbështetjes prej 2000-3000 euro është e pamjaftueshme për t'i mbajtur bizneset aktive dhe për të krijuar ekonomi të qëndrueshme lokale. Në shumë raste, zyrtarët komunalë raportuan se komunat, veçanërisht ato më të voglat, nuk kanë kapacitet për rimëkëmbje afatgjatë, gjë që ata e shohin si përgjegjësi të qeverisë qendrore. Prandaj, koordinimi me qeverinë qendrore konsiderohet thelbësor. Fokusi i komunave është në zbatimin e masave të miratuara nga qeveria qendrore, si dhe në menaxhimin e situatave me burimet e tyre njerëzore dhe financiare dhe aftësitë logjistike.

Komunat me shumicë serbe të Kosovës, përkatësisht Graçanica, Leposaviqi, Mitrovica e Veriut, Novobërda, Ranillugu, Zubin Potoku, Zveçani, janë në një pozicion të pafavorshëm për t'i trajtuar sfidat e paraqitura nga pandemia. Për shkak të kapaciteteve të kufizuara, përfaqësuesit e komunave të lartpërmendura deklaruan se nuk kanë plane për menaxhimin e krizave.

Gjetjet, pikat e forta, sfidat dhe mësimet e nxjerra përbëjnë bazën për disa rekomandime. Për t'i adresuar sfidat kryesore dhe për ta forcuar perspektivën e rimëkëmbjes pas pandemisë, ofrohen rekomandimet e mëposhtme të përgjithshme:

- / Është e një rëndësie thelbësore që udhëheqja e MAPL-së dhe Komunave t'i marrin në konsideratë gjetjet e këtij raporti dhe të hartojnë plane efektive, gjithëpërfshirëse dhe pjesëmarrëse për mobilizimin e burimeve shtesë financiare dhe jofinanciare për masat e rimëkëmbjes.
- / Qeveria duhet ta rrisë buxhetin për grante dhe subvencione për masat e rimëkëmbjes. Duhet të ofrojë mbështetje shtesë financiare për komunat e prekura duke i dhënë përparësi fondeve të reja për agjendat e gjelbra, digjitalizimin, zhvillimin e qëndrueshëm si dhe mobilitetin dhe transportin e qëndrueshëm urban.
- / Qeveria duhet të iniciojë një bashkëpunim ndërinstucional për t'i mbështetur ndërlidhjet e arsimit, politikave sociale, zhvillimit socio-ekonomik dhe arsimor për komunat.
- / Qeveria duhet ta mbështesë një mjedis adekuat biznesi, t'i ruajë tregjet funksionale të punës, të krijojë kushte të përshtatshme financiare dhe të vendosë marrëveshje efektive të qeverisjes ekonomike.
- / Përvojat e komunave gjatë pandemisë COVID-19, janë një dëshmi e gjallë e rëndësisë së planeve të rimëkëmbjes emergjente. Këto plane duhet të kenë matrica të detajuara mbi veprimet, afatet kohore, treguesit, objektivat, kostot e mundshme dhe donatorët ose shpjegimet 'kush, kur, si'.
- / Qeveria duhet të fokusohet në dixhitalizimin e proceseve, pra ta përditësojë listën e bizneseve ekzistuese, sektorëve dhe skemave sociale të prekura, duke hequr ato që nuk kualifikohen për mbështetje dhe të kursejë fonde që mund të përdoren për zhvillim të qëndrueshëm.
- / Qeveria, d.m.th ministritë përgjegjëse si dhe komunat duhet të krijojnë zyra konsulence për informimin dhe mbështetjen e bizneseve që aplikojnë për grante, të cilat duhet të zhvillohen me kërkesa me kritere që sigurojnë mbështetje për gratë në biznes, veçanërisht ato në zonat rurale.
- / Mbështetja për komunat duhet të menaxhohet në atë mënyrë që ta përjashtojë mundësinë e favorizimit të bizneseve të afërta me zyrtarët komunalë, për shembull duke krijuar një praktikë të reklamimit të granteve 'vetëm' në faqet e internetit të komunave, etj.
- / Komunat duhet ta konsiderojnë dixhitalizimin e hapësirave publike përmes GIS dhe t'i identifikojnë vendndodhjet për investime kapitale në hapësira të gjelbra shtesë (parqe publike, etj.)
- / Qeveria dhe komunat duhet t'i stimulojnë dhe mbështesin bizneset për përdorimin e materialeve të ricikluara
- / Skemat mbështetëse të MAPL-së duhet t'i përfshijnë këto prioritetet.

6

BIBLIOGRAFIA

AKK, SDC, “Studim mbi nevojat emergjente dhe ndikimin socio-ekonomik të Covid-19 në pushtetin lokal në Kosovë”, korrik 2020. Në dispozicion në: <https://covid-congress-hub.org/en/partner/16-association-of-kosovo-municipalities.html>

Instituti Shqiptar i Statistikave (INSTAT), “Ndikimi i Covid-19 në Ballkanin Perëndimor”. Prill 2021. Në dispozicion në: <https://statswiki.unece.org>

Komunat e pakicave shqiptare, <https://www.ecmikosovo.org/uploads/Albanian.pdf>

EULEX, “Raport special për ndikimin e Covid-19 në sundimin e ligjit në Kosovë”. Mars 2020-Mars 2021. Në dispozicion në: https://www.eulex-kosovo.eu/eul/repository/docs/Covid%20Report_EN.pdf

Raporti i Fondacionit për Liri Friedrich Naumann me titull “Ndikimi i Covid-19 në ekonominë e Kosovës”. Dhjetor 2020. Në dispozicion në: https://www.freiheit.org/sites/default/files/2021-05/broshura_eng.pdf

Instituti Kosovar për Qeverisje Lokale (KLGJ), “Ndikimi i Covid-19 në ekonominë e Kosovës”. 2020. Në dispozicion në: <http://library.fes.de/pdf-files/bueros/kosovo/17758.pdf>

Regjistrimi i Popullsisë së Kosovës (2011), <https://ask.rks-gov.net/media/2129/estimation-of-kosovo-population-2011.pdf>

OECD, “Kriza Covid-19 në Kosovë”. 31 janar 2021. Në dispozicion në: <https://www.oecd.org/south-east-europe/COVID-19-Crisis-in-Kosovo.pdf>

OECD, “Kriza Covid-19 në Kosovë”. 31 janar 2021. Në dispozicion në: <https://www.oecd.org/south-east-europe/COVID-19-Crisis-in-Kosovo.pdf>

Raporti i FMN-së për vendin nr. 21/41, Ndikimi i Covid-19. Shkurt 2021. Në dispozicion në: <https://www.elibrary.imf.org/view/journals/002/2021/041/article-A000-en.xml>

Ekipi i OKB-së në Kosovë, “Vlerësimi i shpejtë i ndikimit socio-ekonomik të Covid-19 në Kosovë”. Maj 2021. Në dispozicion në: <https://kosovoteam.un.org/sites/default/files/2021-06/SEIA%203.pdf>

OKB, Agjenda e Re Urbane: Angazhimet kryesore, 20 tetor 2016, <https://www.un.org/sustainabledevelopment/blog/2016/10/newurbanagenda/>

UN-Habitat, Rreth nesh, <http://unhabitat.org/about-us/goals-and-strategies-of-un-habitat/>

UN-Habitat, Kosova, Puna Jonë, <https://unhabitat-kosovo.org/about-us/un-habitat-kosovo/>

UN-Habitat, Plani Strategjik 2020-2023, https://unhabitat.org/sites/default/files/documents/2019-09/strategic_plan_2020-2023.pdf

Raporti i UN-Habitat, PASOJAT E COVID-19 NË SEKTORIN E PLANIFIKIMIT HAPËSINOR/URBAN, NDËRTIMIT, LEGALIZIMIT DHE BANESAVE, I disponueshëm në: [https://unhabitat-kosovo.org/wp-content/uploads/2021/10/The-Consequences-of-COVID-19...7057_compressed_compressed.pdf\(qasja_e_fundit_më_09/09/2022\)](https://unhabitat-kosovo.org/wp-content/uploads/2021/10/The-Consequences-of-COVID-19...7057_compressed_compressed.pdf(qasja_e_fundit_më_09/09/2022))

Vendbanimet e Komunave të Kosoves, <https://ask.rks-gov.net/media/1613/popullsia-sipas-gjinis%C3%AB-etnicitetit-dhe-vendbanimit.pdf>

Paneli i OBSH Coronavirus (COVID-19). Në dispozicion në: [https://covid19.who.int/\(qasja_e_fundit_më_21/04/2022\)](https://covid19.who.int/(qasja_e_fundit_më_21/04/2022)).



Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal në partneritet
me Programin për Zhvillim Gjithëpërfshirës
Implementuar nga **UN-Habitat Kosovë**

dhe financuar nga:  **Sweden**
Sverige